

Nëntor 2014
Numri: 80
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

ETIKA



IMAM RABBANI
OSMAN NURI TOPBASH



NEXHAT IBRAHIMI
ZHVILLIMI I 'MILITANIZMIT'
NË HISTORINË ISLAME



NESLIHAN NUR TURK
BESIM, DASHURI, DËSHMI



DR. MUSTAFA MAHMUD
ALARM, LIDHNI RRIPAT
E SIGURIMIT



RAPORTET BRENDA FAMILJES
MA. ZYMER RAMADANI



EDISON ÇERAJ
SHPIRTI DHE JETA




**NËSE PËRÇAHENI
DO T'JU KAPLOJNË**

TRAZIRAT

ISSN 2227-3611
9 772227 361004 1 1

Arsyeja dhe Filozofia

IRI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË
RËNË



Nëntor 2014

VITI: VIII
NUMRI: 80

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Albert Halili
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 607 8484

E-MAIL
rev.etika@gmail.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar
Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Kaha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrove të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

"Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t'ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit." (Enfal, 46)

Në qendër të bindjes, duhet vendosur Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.). Ndërsa bindja ndaj të gjitha fuqive të tjera (përfshi edhe ata që Kurani i ka cilësuar si "ulu'l emr"), duhet të realizohet brenda kornizave të bindjes ndaj Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Nëse ka "kundërshtime" në lidhje me një çështje, kjo duhet të zgjidhet me kriteret që ka bërë të ditura Allahu dhe i Dërguari i Tij. Dhe menjëherë pas bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s), vjen thirrja hyjnore "për të mos u grindur, për të mos u përçarë dhe për të mos u ndarë me zemër, edhe nëse ndarja në lidhje me detyrat dhe shërbimet është e paevitueshme".

"Mos u ndani në grupe!", thotë Allahu i Madhëruar për ata që kanë veshë të dëgjojnë. Më pas, përkujton rrezikun shpirtëror, mendor dhe psikologjik që sjell ndarja në grupe. "Ju hyn frika, ju dobësohet zemra dhe ju shuhet vullneti." Më vonë, do të përballeni me një çmim që duhet ta paguani edhe si individë edhe si shoqëri.

Në Kuran përdoret fjala "rih", kuptimi i së cilës është "erë". Pra, një krijesë, e cila ka fuqi ndikuese. Mirëpo komentuesit e Kuranit, e kanë kuptuar si "kapitullim i forcës dhe i shtetit". Dhe ja ku na shfaqet tabloja e "realitetit të botës islame".

Ky ajet na bën të ditur se besimtarët janë forca, fuqia dhe era e njëri-tjetrit. Dhe, nëse përçahen, kjo forcë nuk do t'i ushqejë më besimtarët me njëri-tjetrin, por do të kthehet në një forcë që i dobëson ata. Ndërsa çmimi i kësaj, mund të jetë edhe "humbja e shtetit". Nëse "humbjen e shtetit" e interpretojmë duke parë gjendjen aktuale të botës islame, mund ta kuptojmë fare qartë se shtetet që janë formuar në shoqëritë islame, janë të zbrazura nga brenda dhe se aftësia e tyre për të krijuar shtet pothuajse nuk ekziston.

"O besimtarë! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkoni gjurmëve të djallit, se ai është armiku juaj i përbetuar." (Bekare, 208)

Ose do të mblidheni të gjithë së bashku nën atmosferën e "paqes-Islamit-marrëveshjes", ose do të ndiqni hapat e shejtanit, i cili është "armiku juaj i hapët". Cilën do të zgjidhni? Cila është gjendja juaj aktuale, "jeni të gjithë së bashku në paqe" apo po ndiqni gjurmët e shejtanit? Ju lutem, në vend që të paragjykojmë të tjerë, gjithsecili le të shohë pozicionin në të cilin gjendet dhe të bëjë pyetjen: "Ku ndodhet shejtani në gjithë këtë kaos?"

"Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut ndaj jush, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë." (Al' Imran, 103)

Nëse të gjithë së bashku do të ishim kapur fort pas litarit të Allahut, atëherë kush do ta bënte këtë përçarje? Nëse Allahu i ka bashkuar zemrat tona, si u ndamë? Nëse Allahu na ka shpëtuar prej greminës së zjarrit, atëherë ç'janë këto gremina zjarri që po ia gërmojmë njëri-tjetrit si popuj myslimanë? Cila është pjesa ime në gërmimin e kësaj greminë dhe si do të jap llogari para Allahut për këtë?

Përmbajtja



Zhvillimi i 'Militantizmit'
në historinë islame
Nexhat Ibrahim

9



Imam Rabbani
Osman Nuri Topbash

34



12



Raportet brenda familjes,
problem i kohës
Zymer Ramadani

26

5 Nëse përçaheni
do t'ju kaplojnë trazirat
Ahmet Tashgetiren

12 Ruajtja e unitetit
pavarësisht dallimeve
Dr. Adem Ergyl

14 Lamtumirë njerëzimit!
M. Ali Eshmeli

20 Paragjykimi është gjykimi më i keq
Ali Riza Temel

23 Alarm, lidhni rripat e sigurimit
Dr. Mustafa Mahmud

24 Superioriteti i sahabëve
Doç. dr. Sulejman Derin

29 Mosanimi nga tiranët
M. Sami Ramazanogllu



20

Të qëndrosh në këmbë çfarëdo që të ndodhë 30

Bynjamin Sagman

Një Ajet - Një Hadith 32

Konturet e Islamit 39

Ali Byjyqçapar

Shpërdorimi më i keq 40

Xhafer Durmush

Bindja dhe kryengritja 42

Durak Puzmaz

Naile binti Ferafisa 48

Mustafa Erish

Sprova e të moshuarve, sprova e të rinjve 51

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

Përse jemi në këtë gjendje? 52

Sami Byjykkajnak

Pasojat e grindjes 54

Prof. dr. M. Jashar Kandemir

Zot na ruaj nga përçarja 58

Ferid Piku



Shpirti ose jeta
Edison Çeraj

44

Po kërkoj njeri!
Dr. Halis Ç. Demirxhan

57



NËSE PËRÇAHENI DO T'JU KAPLOJNË TRAZIRAT

Ahmet Tashgetiren

Me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe me rënien e socializmit nga aktualiteti si një ideologji, bota kapitaliste shpalli fitoren me tezën "Njeriu i fundit – Fundi i historisë". Pas kësaj, në aktualitetin perëndimor, brenda kuadrit të "armikut të ri", u shfaq "Rreziku jeshil":

- Pas kësaj, procesi i luftës do të zhvillohej në formën e "luftës midis myslimanve".

Për ta kuptuar mirë këtë, duhet të kuptojmë mirë zhvillimin e mendimit të botës perëndimore, e cila mendon:

- Ne e shohim si një problem botën islame, ku ndodhen një pjesë e madhe e interesave tona. Problemi është se si do ta mbajmë këtë botë nën statusin e kolonializmit, haptas apo fshehtas.

- Vetëdijësimi islam ka fituar cilësinë e diskutimit të statusit të kolonializmit. Ne këtë e quajmë "politizim të Islamit". Përkufizimet si fundamentalizmi islam, Islami radikal apo integralizmi islam, janë përkufizime të cilat i kemi nxjerrë ne, në kuadrin e fenomenit të "islamit politik".

- Vetëdijësimi i këtij islami që diskuton, është një fenomen i cili vihet re pothuajse në të gjitha vendet islame.

- Kjo gjë duhet parandaluar.

- Mënyra e kësaj është parandalimi i ardhjes në pushtet të këtyre organizimeve dhe, nëse kanë ardhur, të largohen. Dhe për të realizuar këtë, duhen përdorur grupet e interesit politik, ushtarak, gjyqësor dhe mediatic që ndodhen në vend.

- Një mënyrë tjetër për ta arritur këtë, është copëtimi i strukturës shoqërore që përgatit themelet e këtij zhvillimi islam. E thënë më qartë, përplasja e myslimanëve me njëri-tjetrin. Dhe për këtë, të përdoret çdo lloj ndarjeje në besim, fikh, medh'heb, grup, etni dhe individ. Sa më shumë të luftojnë myslimanët me njëri-tjetrin, aq më shumë do të dobësohet "fuqia e Islamit" dhe aq më shumë do të jenë të predispozuar të kolonizohen, të sundohen dhe të përdoren.

Bota islame dhe ne si myslimanë jemi përballë një strategjie të tillë, që nga fundi i shekullit të 20-të e deri më sot në fillim të shekullit të 21-të.

Ky është vetëm "përditësimi" i strategjive të forcave kolonizatore, të cilat i kanë planifikuar për të kolonizuar botën islame para njëqind vjetësh, pra në periudhën pas Luftës së Parë Botërore.

Ndërkohë që një forcë -ose forca- kolonizatore thur plane të tilla, bën edhe analizën e vendeve që do të kolonizojë, si në aspektin gjeografik, ashtu edhe në aspektin sociologjik. Ata analizojnë anët e tyre të dobëta dhe të forta. Pastaj përpiqen të shtojnë anët e dobëta dhe të pakësojnë anët e forta. Gjithashtu, ata synojnë organizimin e një strukture kolonizuese për një periudhë të gjatë.

Ata analizojnë hollësisht karakteret e drejtuesve, strukturat e sistemeve shoqërore, cilësitë etnike të shoqërive, dallimet medh'heboe dhe ndjesitë ndaj kufijve. Madje, nëse është e mundur i planifikojnë vetë ato.

Bota islame e kaloi njëqindvjeçarin e fundit nën kthetrat e një projekti të tillë. Ne nuk mundëm ta kapërcenim dot në kuptimin e vërtetë të fjalës statusin e kolonizimit të hapur apo të fshehtë. Ne e kemi një damar të ndjeshëm, jo se s'e kemi. Por kolonizatorët arrijnë ta vazhdojnë këtë status duke e rinovuar dhe përditësuar atë vazhdimisht.

Dhe ja ku jemi më në fund përballë kurthit strategjik, ku mbase gjithmonë është e mundur të bien shoqëritë njerëzore:

- Lufta ndërmjet myslimanëve.

Kur bëhet fjalë për Islamit dhe myslimanët, mbase kjo është gjendja që mund të paramendohet më pak, sepse Islami, si për nga aspekti i urdhrave të Allahut, të cilat janë në qendër të besimit dhe si për nga aspekti i

fjalëve dhe zbatimeve të të Dërguarit të Tij (a.s.), parashikon ndërtimin e një shoqërie ku pothuajse nuk bëhet fjalë për gjë tjetër përveçse "vëllazërisë".

Në një anë, qëndron ligji i Allahut, "**Besimtarët janë vëllezër**" dhe në anën tjetër një strategji që parasheh "luftën ndërmjet myslimanëve"...

Ky është një plan i qartë për shkatërrimin e identitetit të myslimanit dhe nxjerrjen e tij jashtë "ligjeve të Allahut". Nëse e shohim Kuranin, do të vëmë re se ky është "plani i shejtanit". Mirëpo, në Kuran, në "Udhëzuesin" që ka dërguar Fuqia që ka krijuar botët, Allahu i Madhëruar, jemi paralajmëruar edhe për rreziqet me të cilat mund të përballemi në këtë fushë.

Çështja është që t'ia hapim zemrën Fjalës së Allahut, Kuranit, me sinqeritet të plotë. Po, "me sinqeritet të plotë". Pra, jo duke bërë gjoja sikur dëgjojmë, jo duke mos pranuar kritika, jo duke u sjellë sikur nuk po na drejtohet neve, por dikujt tjetër dhe jo duke i bërë "egot" tona individuale, grupore, etnike dhe medh'heboe, mure përballë Kuranit.

Medh'heb, që do të thotë "rrugë që ndiqet", është kërkimi i rrugës që të çon tek Allahu; Tarikat, që edhe kjo do të thotë "rrugë", është kërkimi i takimit me Allahun; Po ashtu edhe sheriat, që do të thotë "rrugë që ndiqet", synon një rrugë që të nxjerr tek Allahu. Pra, të gjitha këto rrugë synojnë takimin me Allahun...

A mund të gjejë kohë një njeri që është duke u drejtuar për tek Allahu, të merret me dikë tjetër që është po në të njëjtin drejtim, por në një korsi tjetër të rrugës; a nuk e mendon ai se pengimi i atij nga rruga që ka marrë, ka një kuptim negativ për vetë udhëtimin e tij; a mund të mos e marrë parasysh vlerën që ka tek Allahu pengimi i rrugës që të çon tek Ai; dhe ç'është më e rëndësishmja, a mund të mendojë ai se Fuqia që sheh dhe di gjithçka të këtij udhëtimi nuk do t'i shohë sjelljet e tij prej banditi?

Allahu i Madhëruar, në sajë të Kuranit, vë përpara nesh në mënyrë të qartë si një film apo një fotografi, çdo gjë që do të na ndodhë në këtë udhëtim. E gjithë çështja është ta lexosh Kuranin në mënyrë të saktë dhe me gjithë zemër...

Për shembull, në Kuran urdhërohet, se "**Ai (Allahu), është që i bashkoi zemrat e tyre...**"¹ Si mendoni? Unë them se, nëse ia japim zemrat tona Allahut, ato do të



1. - Enfal, 63.

arrijnë pjekurinë e duhur për t'u bashkuar.

Në Kuran, në lidhje **"...me ata që e përçajnë fenë e tyre dhe shndërrohen në sekte..."**, thuhet se **"...puna e tyre është në dorë të Allahut..."** e më pas vjen edhe kërcënimi për ta se **"...Ai do t'u tregojë çfarë patën punuar..."**.²

Unë them se kur të lexojmë këto lloj ajetesh, t'i lemë mënjatë paragjykimet ndaj të tjerëve, duke thënë "filani e copëtoi fenë" dhe t'i bëjmë vetes pyetjen: "Vallë po unë, a po bëj ndonjë gjë që e copëton fenë e të bëhem pjesë e atyre që kërcënon Zoti im?"

Nëse do të ishte e mundur ta lexonim në mënyrë të veçantë këtë ajet, të mendonim rreth tij, të ndërtonim botën tonë të ndjenjave e mendimeve sipas tij dhe të përcaktonim gjendjen dhe sjelljet tona si umet në bazë të tij, ne mund t'i përmbysim të gjitha "strategjitë e kaosit".

Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t'ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit." (Enfal, 46)

Në qendër të bindjes, duhet vendosur Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.). Ndërsa bindja ndaj të gjitha fuqive të tjera (përfshi edhe ata që Kurani i ka cilësuar si "ulu'l emr"), duhet të realizohet brenda kornizave të bindjes ndaj Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Nëse ka "kundërshtime" në lidhje me një çështje, kjo duhet të zgjidhet me kriteret që ka bërë të ditura Allahu dhe i Dërguari i Tij.³ Dhe menjëherë pas bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), vjen thirrja hyjnore "për të mos u grindur, për të mos u përçarë dhe për të mos u ndarë me zemër, edhe nëse ndarja në lidhje me detyrat dhe shërbimet është e paevitueshme".

"Mos u ndani në grupe!", thotë Allahu i Madhëruar për ata që kanë veshë të dëgjojnë. Më pas, përkujton rrezikun shpirtëror, mendor dhe psikologjik që sjell ndarja në grupe. "Ju hyn frika, ju dobësohet zemra dhe ju shuhet vullneti." Më vonë, do të përballeni me një çmim që duhet ta paguani edhe si individë edhe si shoqëri.

Në Kuran përdoret fjala "rih", kuptimi i së cilës është "erë". Pra, një krijesë, e cila ka fuqi ndikuese. Mirëpo komentuesit e Kuranit, e kanë kuptuar si "kapitullim i forcës dhe i shtetit". Dhe ja ku na shfaqet tabloja e "realitetit të botës islame".

Ky ajet na bën të ditur se besimtarët janë forca, fuqia dhe era e njëri-tjetrit. Dhe, nëse përçahen, kjo forcë nuk do t'i ushqejë më besimtarët me njëri-tjetrin, por do të kthehet në një forcë që i dobëson ata. Ndërsa çmi-

2. - shih. En'am, 159.

3. - shih. Nisa, 59.

mi i kësaj, mund të jetë edhe "humbja e shtetit". Nëse "humbjen e shtetit" e interpretojmë duke parë gjendjen aktuale të botës islame, mund ta kuptojmë fare qartë se shtetet që janë formuar në shoqëritë islame, janë të zbrazura nga brenda dhe se aftësia e tyre për të krijuar shtet pothuajse nuk ekziston.

Ky ajet urdhëron:

"O besimtarë! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkoni gjurmëve të djallit, se ai është armiku juaj i përbetuar." (Bekare, 208)

Ose do të mblidheni të gjithë së bashku nën atmosferën e "paqes-Islamit-marrëveshjes", ose do të ndiqni hapat e shejtanit, i cili është "armiku juaj i hapët". Cilën do të zgjidhni? Cila është gjendja juaj aktuale, "jeni të gjithë së bashku në paqe" apo po ndiqni gjurmët e shejtanit? Ju lutem, në vend që të paragjykojmë të tjerë, gjithsecili le të shohë pozicionin në të cilin gjendet dhe të bëjë pyetjen: "Ku ndodhet shejtani në gjithë këtë kaos?"

Ky ajet urdhëron:

"Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut ndaj jush, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë." (Al' Imran, 103)

Nëse të gjithë së bashku do të ishim kapur fort pas litarit të Allahut, atëherë kush po e bën këtë përçarje? Nëse Allahu i ka bashkuar zemrat tona, si u ndamë? Nëse Allahu na ka shpëtuar prej greminës së zjarrit, atëherë ç'janë këto gremina zjarri që po ia gërmojmë njëri-tjetrit si popuj myslimanë? Cila është pjesa ime në gërmimin e kësaj greminë dhe si do të jap llogari para Allahut për këtë?

Ky ajet urdhëron:

"Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këta do të ketë dënim të madh." (Al' Imran, 105)

A nuk na kanë ardhur të gjithëve prova të qarta? A nuk jemi duke i lexuar ato ditë e natë? Kujt po ia lexojmë? Përse ato nuk i arrijnë zemrat tona? Si duhet të ndikojnë në qëndrimin tonë si umet këto fjalë të Kuranit? Vallë, kush janë "këta që do të kenë dënim të madh"? Po sikur të na prekë neve ai dënim i madh? Po sikur gjithë këto dhimbje që po përjeton sot bota islame të jenë pjesë të këtij dënimi?..

Ky ajet urdhëron:

"Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht

me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ta dhe këshillohu me ta për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.” (Al’ Imran, 159)

Allahu i Madhëruar ia thotë këto të Dërguarit të Tij fisnik, që: **“Në sajë të mëshirës së Allahut, u soll butësisht me ta.”** Pra edhe atë mëshirë, Allahu ta ka dhënë... Ti nuk u solle me ashpërsi dhe vrazhdësi... Nëse nuk do të ishe sjellë ashtu, njerëzit do të largoheshin prej teje... Allahu këshillon faljen. Madje, kërkon që të bëhet dua për faljen e tyre. Le të pyesim veten tonë, a jemi sjellë me mëshirë ndaj besimtarëve të tjerë? A i jemi përgjyruar Allahut për këtë? A i kemi kujtuar besimtarët e tjerë në lutjet tona, duke zgjedhur rrugën e faljes? A jemi lutur: **“O Zot! Mos lejo që në zemrat tona të ketë urrejtje ndaj besimtarëve!..”**⁴

Ky ajet urdhëron:

“O besimtarë! Kur të shkoni në luftë, në rrugë të Allahut, shqyrtoni gjithçka me kujdes! Atij që ju përshëndet me selam, mos i thoni: ‘Nuk je besimtar’, duke synuar përfitime të kësaj jete, ndërkohë që tek Allahu ka fitime të shumta. Të tillë keni qenë edhe ju më parë e Allahu ju dha mirësi; prandaj gjithmonë sqarojini mirë të gjitha punët! Se Allahu është Njohës i veprave tuaja.” (Nisa, 94)

Me anë të këtij ajeti, Allahu i Madhëruar sikur na shfaq një mundësi dhe një kornizë për të analizuar të gjitha dobësitë e njeriut. Ai urdhëron që të dëgjojmë dhe t’i kuptojmë mirë shkaqet e një lufte. Pjesa e ajetit: **“Atij që ju përshëndet me selam, mos i thoni: ‘Nuk je besimtar’, duke synuar përfitime të kësaj jete”** duhet lexuar mijëra herë. Po ashtu, duhet të rishikojmë mijëra herë edhe vlerësimet që bëjmë, kur marrim parasysh “përfitimet e kësaj bote” në marrëdhëniet me njerëzit, shoqëritë, medh’hebet e ndryshme, xhematet, tarikatet ose me grupet e besimeve të tjera. Pra, çdo sjellje duhet ta kalojmë prej sitës së këtyre kritereve.

Këtu, Allahu i Madhëruar kërkon prej nesh të rishikojmë qëllimet tona. Për shembull, siç thotë edhe i Dërguari i Allahut (a.s.): **“Për kë po emigroni? Për Allahun dhe**

të Dërguarin e Tij apo për ndonjë grua që e dëshironi?” Me një fjalë, shikoni përse po e ngrini shpatën kundër atij që keni përballë? Për të marrë më shumë pjesë prej plaçkës së luftës apo për shkak se nuk doni ortakë me të cilët do të ndani mallin-pronën-pushtetin? A ju ka vajtur nëpër mend se një ditë do të dilni para Allahut, ku do të jepni llogari edhe për qëllimet tuaja? Nëse nuk ia keni hapur zemrën për të shikuar çka brenda, si mund ta ngrini shpatën për t’i rënë qafës së tij?

Ky ajet urdhëron:

“O ju që keni besuar! Mënjaroni dyshimet e shumta, se vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pra-nues i pendimit dhe Mëshirëplotë.” (Huxhurat, 12)

Dhe ky ajet:

“Vërtet, Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij, të radhitur si të ishin një ndërtesë solide.” (Saff, 4)

Dhe shumë ajete të tillë...

Allahu ka përcaktuar krite-re për të ndërtuar një shoqëri besimtare. Ndërsa Rasulullahu (a.s.), është përpjekur me mish e me shpirt për të ndërtuar një “umet” sipas këyre kritereve. Mirëpo tani, kundër umetit është futur “strategjia e luftës ndër-mjet myslimanëve”. Po, kjo është një strategji satanike.

Kjo është edhe sprova jonë si umet.

A do t’i drejtojmë veshët nga Zoti ynë, Krijuesi ynë, fjala e Tij, Kurani dhe zëri i të Dërguarit të Tij (a.s.)? A do ta kapim peygamberin për dore e të ndjekim hapat e tij, të mblidhemi e të kapemi fort pas tij apo do t’i nënshtrohemi strategjisë së shejtanit dhe ndihmësve të tij, që na thërrasin për të goditur njëri-tjetrin?

Kjo e dyta do të na kolonizojë edhe për njëqind vjet të tjera e do të jemi ende skllëvër.

Islami është “liri”. Ndërsa të kolonizohesh, do të thotë të jesh në statusin e skllavit, qoftë i hapur apo i fshehtë. Islami nuk duhet jetuar brenda një kornize të përcaktuar nga tregtarët e skllavërisë. Sot, për të jetuar Islamin në kuptimin e vërtetë të fjalës, duhet të kuptojmë mirë “vëllazërinë”. Përndryshe, “na kapitullon shteti dhe fuqia, bëhemi të parëndësishëm, gufohemi dhe na merr malli për pak atmosferë paqeje”. Çdo popull që “humbet shtetin”, poshtërohet.



4. -shih. Hashr, 10.



ZHVILLIMI I 'MILITANTIZMIT' NË HISTORINË ISLAME

Nexhat Ibrahimli

SHQYRTIME PARAPRAKE

Katër-pesë dekadat e fundit kanë qenë në shenjë të terrorizmit majtist, sikurse *Fraksioni i Armatës së Kuqe* në Gjermani (gjer.: *Rote Armee Fraktion*; RAF, angl.: *The Red Army*) apo *Brigadat e Kuqe* (ital.: *Brigate Rosse*, angl.: *The Red Brigades*) në Itali. Edhe pse këto grupe apo të ngjashme veprojnë edhe sot me intensitet më të ulët, megjithatë, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, këtë rol disi e morën grupet me parashenjë *islamiste* apo në shenjë të militantizmit mysliman. Këto grupe lidhen me dhunën, intolerancën ndaj tjetrit dhe të ndryshmit, luftërat me fqinjët, sulmet vetëvrasëse, etj.

Edhe pse askush nuk i ka gjykuar gjermanët për shkak të veprimit të *Armatës së Kuqe*, apo italianët për shkak të *Brigadës së Kuqe*, kjo nuk po ndodh me Islamin dhe myslimanët, të cilët për shkak të veprimit të disa grupeve të skajshme (së paku në dukje të skajshme) akuzohen rëndë. Islami si fe dhe myslimanët si praktikues të fesë islame akuzohen në mënyrën më të ashpër. Edhe dy-tre viteve të fundit, me të ashtuquajturën *Pranverën arabe*, Islami dhe myslimanët sërish janë në qendër të interesimit të opinionit publik, por në pikëpamje agresive, jotolerante, luftarake.

FILLIMET E MILITANTIZMIT NË HISTORINË ISLAME

Islami është feja më e re nga trugu ibrahimian në shekullin VII. Pejgamberi i kësaj feje ishte Muhamedi, i biri i Abdullahut, nga fisi Kurejsh, në Mekë, i fundit në vargun pejgamberik. Ai njëkohësisht ishte edhe shtetar, edhe komandant lufte, por edhe shpjegues e mësues i Kuranit.

Edhe pse Muhamedi (a.s.) dhe myslimanët ikën në Medinë, duke braktisur çdo gjë që kishin në Mekë, kjo nuk mjaftoi për bashkëvendësit e tyre. Mekasit edhe në Medinë filluan t'i rrezikojnë myslimanët dhe shtetin e tyre të porsaformuar, që e detyruan Muhamedin (a.s.), të mendojë për mekanizma mbrojtës e ndër këto është edhe lufta e armatosur. Duke përdorur shkathtësi politike dhe aftësi ushtarake, në vitin 630 Muhamedi (a.s.), u kthye në Mekë si fitues (Çlirimi i Mekës), pa vrasje, pa shkatërrim, pa hakmarrje, që i detyroi shumë ish-armiq të pranojnë Islamin dhe të bëhen ushtarë të denjë të Islamit. Fushatat ushtarake të myslimanëve, edhe pse herë-herë interpretohen si të dhunshme, megjithatë nga historianët objektivë shpjegohen si luftëra për zgjerimin e shtetit islam, por jo edhe të fesë islame, sepse sipas Kuranit, dhuna në përhapjen e fesë është e ndaluar: **"Nuk ka dhunë në fe."** (Bekare, 256) Rezultat të kësaj gjendjeje kemi praninë e bashkësive hebraike dhe kristiane në të gjitha shtetet dhe qytetet myslimane deri në ditët e sotme.

Mirëpo, me vdekjen e Muhamedit (a.s.), më 632 dhe në mungesë të një trashëgimtari të përcaktuar nga ai, përkundër zhvillimit të hovshëm dhe rritjes së shtetit mysliman, filluan të paraqiten edhe pakënaqësitë e para të brendshme. Gjendja u përkeqësua sidomos pas vrasjes së halifit të tretë Osmanit (r.a.) dhe ardhjes në sundim të Aliut (r.a.). Përkrahësit e Aliut (r.a.), mendonin se ai ka të drejtë në halifat, duke arsyetuar se ai ishte mënjeluar edhe në tre rastet e para. Në anën tjetër, Muaviu, mëkëmbësi i Shamit, gjithashtu mendonte se kishte të drejtë në halifat dhe kishte përkrahjen e një numri të madh njerëzish. Kjo gjendje solli edhe deri te konflikti i përgjakshëm i njohur si Beteja e Sifinit, me

ç'rast arbitrazhi (tahkimi) ishte në favor të Muaviut dhe ai u bë halifi i pestë në radhë dhe me këtë filloi sundimi shumëvjeçar i dinastisë emevite.

Edhe pse përkrahësit e Aliut (r.a.), nuk u pajtuan me Muaviun dhe pastaj me Jezidin, të birin e Muaviut, kjo nuk e ndryshoi gjendjen për të mirë, përkundrazi, i thelloi armiqësitë. Kështu, së pari, më 17 ramazan të vitit 40 hixhri, u vra Aliu (r.a.), nga një harixhit e pastaj, më 680 Husein ibn Aliu u përball në Kerbela me njësitë e Jezidit, me ç'rast vdiq bashkë me shumë përcjellës të tij. Kjo datë edhe sot shënohet në mesin e shi'itëve pothuajse me të njëjtin ritëm. Në këtë rrëmujë, më së shumti për skajshmëri u shquan harixhitët, fillimisht përkrahës të Aliut (r.a.) e më vonë kundërshtarë të tij të përbetuar. Ky grup, një kombinim i ideologjisë egalitare dhe dhunës së skajshme u shkaktoi probleme të mëdha sunduesve myslimanë. Myslimanët që nuk pajtoheshin me bindjet e tyre, konsideroheshin të pafe dhe mund të sulmoheshin nga ata si detyrim fetar.

ISLAMIZMI, IDEOLOGJI MODERNE E MILITANTIZMIT MYSLIMAN

Nëse me *Islam* nënkuptojmë fenë islame të shpallur burimisht nga Allahu, me *islamizëm* nënkuptojmë aspektin praktik të Islamit, aspektin historik të tij. Vetvetiu ky term nuk nënkupton ndonjë të keqe, por nga kundërshtarët interpretohet si ideologji moderne politike, që synon islamizimin, përkatësisht futjen e sheriatit në të gjitha segmentet e jetës, në politikë, ekonomi, kulturë, arsim, etj.

Intelektuali boshnjak, Tarik Kullenoviq, konsideron se fillet e mendimit politik modern islam duhen kërkuar në veprat e autorëve myslimanë të shekullit 19, siç janë Xhemaludin Afganiu, Muhammed Abduhu, etj. Kjo lëvizje do të intensifikohet faktikisht vetëm me Hasan Benën (1906–1949), i cili me bashkëmendimtarë, në vitin 1929 e formoi grupin me emrin *Ihvan'ul-muslimin* (Vëllezëria Myslimane). Për dallim nga vëhabizmi, kjo lëvizje nuk e refuzoi sufizmin, kurse ndër angazhimet kryesore të saj ishte arsimimi, duke mos e lënë anash edhe aspektin militant varësisht rrethanave shoqërore që imponohen. Për shkak të rrezikimit të rendit shtetëror të asaj kohe, shteti ndërmoi masa represive dhe e ndaloi këtë grup, kurse Hasan Benën e likuidoi në vitin 1949. Më vonë do të ekzekutohet edhe njëri prej personaliteteve më të mëdha, Sejjid Kutubi (1906–1966), lider i Ihvanëve pas vrasjes së Hasan Benës.

Edhe pse në fillim *Vëllazëria Myslimane* ishte në krah të *Lëvizjes së Oficerëve të Lirë* (Free Officers Movement) në përmbysjen e Mbretit Faruk në Egjipt, në krye me Xhemal Abdunaserin (1918–1970), madje edhe në ndihmë direkte të tyre, në vitin 1954 kjo lëvizje sërish u ndalua nga Ofrecët e Rinj, kurse anëtarët e saj u përdoqën, torturuan, burgosën, vranë etj. Anëtarët

e tjerë të shquar të shpëtuar, u shkapërderdhën nëpër vende të ndryshme e sidomos u strehuan në Arabinë e Saudëve, e cila atë kohë kishte nevojë për fuqi punëtore intelektuale.

Lëvizja tjetër, që meriton kujdes intelektual dhe shoqëror është sektu radikal militant vëhabist, i shfaqur në gadishullin arab në shekullin 18. Këtë lëvizje e themeloi Muhammed ibn Abdulvehhabi, i lindur në Ujejne, në krahinën Nexhd, në Arabinë e tanishme në vitin 1703. Pas bredhjeve andej-këndeje, Abdulvehhabi shpalli doktrinën e tij, e cila theksin kryesor e vendosi në eliminimin e shtresimeve kohore (bid'a) në besim, të cilat nuk ekzistonin në kohën e Muhamedit (a.s.) dhe shokëve të tij dhe në këtë mënyrë u bënë politeistë (mushrikë). Sidomos ky grup e ashpërsoi veprimin ndaj sufijnve dhe shiijnve. Mësimet e tij morën krahë kur gjeti përkrahës, jo në vendlindjen e tij, jo në familjen e tij, por në Der'ijeh, vend ku sundonte Muhammed ibn Saudi, dhe me të cilin lidhi aleancë në vitin 1744, e cila aleancë është në fuqi deri sot. Gjatë historisë së tyre shpesh kanë organizuar kryengritje kundër halifatit islam të osmanëve, kanë masakruar popullatën vendase dhe në fqinjësi, duke shkaktuar vrasje të mëdha të të gjithë atyre që nuk pajtoheshin me mësimet e tyre ekstreme. Këto ide pajtoheshin edhe me planet e fuqive të jashtme, kështu që me ndihmën politike, por edhe ushtarake të anglezëve pushtuan gadishullin arab në vitet e njëzeta të shekullit 20. Këtë dinasti e fuqizoi edhe bashkëpunimi me amerikanët, të cilët bënë zbulimin e naftës dhe nxjerrjen e saj deri në ditët e sotme. Rrymat e ndryshme të kësaj lëvizjeje sot paraqesin militantizmin e skajshëm në përmasa rajonale dhe globale.

Një lëvizje tjetër *militantiste* e kemi në nënkontinentin e Indisë, të cilën e themeloi Ebu'l-'Ala Mewdudi (1903–1979). I mbërthyer nga rrethanat e vështira fetare, politike e ekonomike, ai e theksoi angazhimin e tij militant dhe përfaqësonte idenë e një revolucioni global. Për këtë qëllim, ai e formoi partinë e tij *Xhemaat-e-islami*. Ai synonte që nëpërmjet xhihadit të formojë shtetin islam dhe jetën personale dhe shoqërore ta rregullojë sipas sheriatit. Në këtë aspekt, pati pjesërisht edhe ndihmën e kryetarit të Pakistanit Ziaul-Hak. Mewdudi ka ndikuar te një numër i madh dijetarësh të tjerë e ndër ta edhe te Sejjid Kutubi.

Edhe pse ka pasur përpjekje që edhe disa dijetarë myslimanë në ish-Jugosllavi të etiketoheshin si militantistë myslimanë, si Husein Gjozo, Alija Izetbegoviq, mendoj se hedhja e këtyre paralelizmave është e paqëndrueshme.

LËVIZJET MILITANTISTE NDËRKOMBËTARE TË PROVENIENCËS MYSLIMANE

Bashkimi Sovjetik i dikurshëm e pushtoi Afganista-

nin për qëllimet e tij kryesisht politike e ekonomike. Mirëpo, së shpejti filloi revolta e shtresave të vetë-dijësuar. Ata u përkrahën nga SHBA, Pakistani dhe Arabia Saudite, secila për qëllimet e veta. Në krah të tyre i kemi edhe vullnetarët nga vendet e ndryshme të botës. Ideatori i të ashtuquajturve arabë afganistanezë ishte Abdullah Jusuf Azzami (1941–1989), palestinez dhe anëtar i Vëllazërisë Myslimane, luftëtar kundër Izraelit, me doktoratë të Ez'herit dhe ligjërues në Xhidë të Arabisë. Ishte i ndikuar nga Kutubi dhe Mewdudi, por edhe nga vehabizmi. Ndër muxhahidinët e huaj në Afganistan veprimtaria e tij synonte një xhihad global ("Jihad and the rifle alone: no negotiations, no conferences and no dialogues", që domethënë: "Xhihadi dhe vetëm pushka: nuk ka negociata, nuk ka konferenca dhe nuk ka dialogje."). Me këtë veprim të tij dhe bashkëmendimtarëve, filloi të instalohej një drejtim i ri, ultramilitar në islamizëm nën ndikimin e vehabizmit, të cilin bota do ta quajë me emërtime të ndryshme si *xhihadizëm*, *selefizëm*, *neoharixhizëm*, *vehabizëm* etj. Në bindjet e kësaj rryme të re në skenën politiko-fetare selefistët ishin ata që të vetmit e kuptojnë Islamin dhe të vetmit ata mund ta interpretojnë. Burimi i tyre shpirtëror ishte shkolla hanbelite e interpretimit tejmijist-vehabist.

Azzamit iu bashkua edhe studenti i tij nga Xhida Usama bin Ladeni (1957–2011), pjesëtar i një rës nga familjet më të pasura mbretërore. Ky milioner i ndihmoi muxhahidinët edhe ideologjikisht edhe materialisht, por edhe si luftëtar në fushëbetë. Pas tërheqjes së Bashkimit Sovjetik nga Afganistani, një pjesë e luftëtarëve u kthye në vendet e veta, kurse një pjesë u zhvendos në disa vende ku ekzistonte problemi i pazgjidhur i Islamit. Ndër këto vende ishte Algjeria. Aty në vitin 1991 zgjedhjet e lira i fitoi *Fronti për Shpëtimin Islam* (The Islamic Salvation Front & *al-Jabhah al-Islāmiyah lil-Inqādh*), mirëpo, partia në pushtet i anuloi zgjedhjet dhe vendosi pushtetin e grushtit. Kësaj gjendjeje iu kundërvu Grupi i Armatosur Islam (Armed Islamic Group - AIG), grup me ideologji xhihadiste-selefiste, përkatësisht me bindje neoharixhite. Disa grupe të vogla të tyre kanë marrë pjesë edhe në Bosnjë, Somali, Indonezi, Jemen e vende tjera dhe kudo ku shkuan erdhën në konflikt me ulemanë vendore për shkak të bindjeve të tyre vehabiste.

Mirëpo, pas sulmeve në SHBA më 11 shtator 2001, SHBA-ja i shpalli luftë Osama Bin Ladenit dhe talibanëve, me arsyetim të luftimit të terrorizmit botëror. Por, edhe pas luftës disavjeçare të SHBA dhe aleatëve të saj, Perëndimi nuk pati sukses. Madje sukses nuk pati as me vrasjen e Osama bin Ladenit më 2011.

TALIBANËT

Në kohën kur u vra Abdullah Jusuf Azzami, më 1989, në rrethana të pasqaruara, Bashkimi Sovjetik u tërhoq

nga Afganistani, kurse muxhahidinët vazhduan luftën kundër qeverisë komuniste të Naxhibullahut. Në këtë mënyrë filloi një luftë e përgjakshme qytetare mes sekteve e fiseve të shumta.

Për shkak të dhunës së vazhdueshme të muxhahidinëve lokalë, u paraqit një lëvizje me emrin *Talibanët*, e cila shumë shpejt u bë forca kryesore e rebelimit. U formua në vitin 1994 afër Kandaharit me nismën e Muhamed Omarit. Pakistani dhe Arabia i kanë ndihmuar grupet e caktuara të muxhahidinëve, sidomos *Hizb-i islami* të Gulbedin Hikmetjarit dhe *Ittehad al-Islami* të Abdurresul Sajafi, një vehabist aktiv. Ndihma e Arabisë ndikoi edhe në aspektin ideologjik, duke marrë ato rite e praktika vehabiste. Ky grup kishte edhe rivalët e vet në Afganistanin verior,

Ideologjia e talibanëve nuk ishte as lëvizja xhihadiste-selefiste, as vehabiste, por një degë e skajshme e lëvizjes reformiste të lëvizjes së medresesë së Deobandit, e cila lindi në Indi në shekullin e 19-të si reaksion ndaj pushtuesit anglez.

MILITANTIZMI SHI'IT

Është mendim i pranuar se brenda prejardhjes shi'ite, militantizmin në kohën moderne e ka zhvilluar Ali Sheriati (1933-1977). Për shkak të dallimeve të caktuara në çështje të besimit dhe ritualeve, shi'izmi ndoqi një rrugë tjetër, në pritje të Mehdiut të pritur edhe në pikëpamje organizative, edhe në pikëpamje hierarkike. Ndoshta Ali Sheriati ndiqte një politikë të majtë në kundërvënien të kolonializmit. Ky ndikoi edhe te Imam Homeini, protagonist i madh politik shi'it në shekullin 20, i cili më 1979 e përmbysi Reza Pahlavin dhe e vendosi Republikën Islame në Iran. Ardhja e tij në pushtet i trembi mbretëritë fqinje, të cilët për të mbetur në sundim angazhuan forca perëndimore dhe u armatosën nga perëndimorët. Ndikimi i rrymave të përmendura ka qenë edhe ndër palestinezë, pastaj në Liban etj.

Ç'MUND TË THUHET PËR FUND

As Islami si fe, as islamizmi si ideologji (historike) nuk është sinonim i dhunës, forcës, vrasjes, terrorizmit, por i veshur në petkun e vehabizmit apo të ndonjë grupi tjetër ekstrem, islamizmi herë-herë kalon kufijtë e lejuar. Përkundër këtij fakti, skajshmëria e grupeve islamiste nuk ishte e drejtuar kundër evro-perëndimit, por kundër regjimeve e pushteteve të caktuara arabe-myslimane.

Kjo ideologji xhihadiste-vehabiste-selefiste, është e pranishme në shumë vende të botës dhe lufta kundër tyre nuk duhet të bazohet në aeroplanë bombardues *stealth* apo në fluturake pa pilot, por në mësimin, arsimimin dhe informimin aktiv të popullatës e sidomos rinisë.



Ruajtja e unitetit pavarësisht dallimeve

Dr. Adem Ergyl

Historia ka qenë dëshmitare e shumë e shumë luftërave, përplasjeve dhe kundërshtimeve. Jemi krijuar të ndryshëm. Gjuhët, ngjyrat, dëshirat dhe në shumicën e rasteve edhe gjërat që i pëlqejmë apo nuk i pëlqejmë janë të ndryshme nga njëra-tjetra.

Krijuesi i Madhërishtëm nuk ka krijuar asnjë të ngjashëm me tjetrin në këtë botë. Edhe nëse flasim të njëjtën gjuhë, toni i zërit ndryshon. Edhe nëse ngajmë në formë, në thelb jemi të ndryshëm. Kështu është gatuar brumi i ekzistencës sonë. Jemi krijuar një nga një dhe të veçantë.

Kjo e vërtetë madhështore është vetëm një nga argumentet e panumërta, që tregojnë fuqinë dhe madhësinë e Tij. Dhe pavarësisht se jemi të ndryshëm, Ai ka kërkuar diçka prej nesh; ruajtjen e paqes. Të bëhemi njerëz që miqësojnë dhe miqësohen. Të socializohemi, madje të vëllazërohemi. Të mos bëhemi prej atyre që derdhin gjak, krijojnë ngatërresa, ndarës e përcarës, që grinden me njëri-tjetrin e ndahen në grupe, por të bëhemi një popull me dinjitet që bashkon dhe pajton.

Mirë, po përse njerëzit e derdhin gjakun e njëri-tjetrit? Përse nuk janë miq, por bëhen armiq? Në vend

që ta kthejnë në xhenet botën ku jetojnë, përse e kthejnë në xhehenem?

Zoti ynë na i tregon një nga një të gjitha shkaqet e këtyre. Ai na njuh me smirën e njeriut, ambicien, dëshirat e tij të pakufishme, egërsinë e tij kur posedon fuqi, prirjen për t'u ndjerë zot, arrogancën, egoizmin, logjikën e tij për të skllavëruar të tjerët, intolerancën ndaj dallimeve, pëlqimin e vetvetes, garën e tij për më shumë, ndjenjën e tij për t'u lavdëruar dhe shumë e shumë sëmundje të tjera të ngjashme.

Ndonjëherë, këto të vërteta i tregon me anë të tregimeve, duke na bërë të kuptojmë se shkakun e armiqësisë ndërmjet bijve të babait tonë Ademit (a.s.), Kabilit dhe Habilit, ishte smira e Kabilit. Po ashtu edhe mosmarrëveshjen midis Jusufit (a.s.) dhe vëllazërve të tij e lidh me zilinë. Ai na tërheq vëmendjen tek arroganca e Karunit, i cili ishte mjaft i pasur e i pushtetshëm; thekson tiraninë e Faraonit dhe dëshirën e tij për të qenë zot, i cili mori fuqi në sajë të pushtetit. Tregon për ndjenjën e humbjes së pushtetit dhe smirën e armiqve të pejgamberëve, të cilët u kumtonin njerëzve fenë e vërtetë.

Për sa kohë të ekzistojnë njerëzit e paformuar, të

cilët nuk janë pjekur në zjarrin e shpalljes hyjnore, ndjenjat e të cilëve nuk janë hijeshuar, që janë të paedukuar dhe të trashë, edhe këto armiqtë do të vazhdojnë të ekzistojnë deri në Ditën e Kiametit.

Atëherë, a është e mundur që të gjithë njerëzit njëherësh të pajtohen, të bëjnë paqe, të përmirësohen e pastrohen? Nëse do Zoti ynë, po! Mirëpo, Ai nuk e dëshiron që kjo gjë të ndodhë në mënyrë të detyrueshme dhe me forcë. Ai ka dëshiruar që ata të cilët e kanë kuptuar dhe përvetësuar të vërtetën, të bashkohen dhe të vendosin drejtësinë mbi tokë.

Por si do të mund të realizohet kjo? E shprehur ndryshe, a është e mundur të gjesh unitetin/bashkimin në vorbullën e prirjeve të ndryshme? Si do të përcaktohen kriteret e saj? Kush do ta marrë përsipër formimin e një xhemati/shteti/kombi/umeti të tillë? Kjo është çështja më e rëndësishme! Ky është ideali më i madh: Përgjegjësia e ndërtimit të sundimit të së drejtës dhe të vërtetës mbi tokë.

Po, nuk është e mundur t'i miqësosh, t'i bashkosh e t'i vëllazërosh njerëzit, duke eliminuar dallimet në formën dhe përmbajtjen e tyre. Po ashtu, nuk është e mundur as që dëshirat të bëhen një e vetme. Atëherë, nuk mund të bëhet fjalë për një zgjidhje tjetër, përveçse të mbledhemi përreth disa vlerave të përbashkëta dhe të formojmë një "shoqëri vlerash" ose, e thënë ndryshe, "një shoqëri virtytesh".

A mundet që njerëzimi i kapluar nga shumë dobësi, të formojë vetë një shoqëri të tillë virtytesh? Mbase në ndërgjegjen e një natyre të paprishur mund të formohet një sistem i tillë vlerash. Mirëpo, t'i mbledhësh ndërgjegjet e tilla në një vend dhe të shpallësh zërin e ndërgjegjeve në formën e një sistemi parimesh pa u ndikuar nga asgjë, me qëllim që këto të jenë mbizotëruese, është pothuajse e pamundur. Në fakt, në ditët tona këto lloj grupesh janë formuar (kombet e bashkuara e të ngjashme). Por për shkak të dyfytërisë dhe qëndrimit të tyre në anën e të fortit dhe interesave, tashmë është bërë e qartë para të gjithë botës se një mendim i tillë nuk është gjë tjetër përveçse disa rreshtave mbi letër.

Atëherë, çfarë duhet të bëhet?

Pikësëpari, të theksojmë se të vërtetat që kanë sjellë të gjithë pejgamberët janë parimet hyjnore të qytetërimit të virtyteve, i cili do të vendosë paqen dhe qetësinë mbi tokë. Natyrisht se këto parime nuk do të pranohen një për një nga të gjithë njerëzit. Mirëpo, nëse formohet një umet/popull i fortë, i mbërthyer me njëritjetrin rreth këtyre parimeve dhe bëhet mbizotërues në tokë, atëherë do të mund të flasim për drejtësinë dhe paqen e vërtetë. Formimi i një umeti të tillë është përgjegjësia më e madhe e familjes njerëzore. Ndërsa

çdo lloj grindjeje, mosmarrëveshjeje dhe kundërshtie, që e copëton këtë unitet, është një nga gjynahet më të mëdha.

Ne kemi në dorë Kuranin Fisnik, që është edhe sistemi i fundit i vlerave që na ka ardhur prej Zotit tonë. Ata që e zotërojnë këtë libër, nuk duhet të ekzistojnë vetëm për veten e tyre, por për të gjithë njerëzimin, sepse Zoti ynë, i Cili është pronari i këtij libri, ka urdhëruar: **"Ju jeni populli më i mirë, i dalë për njerëzimin..."** dhe për ta çuar në vend këtë përgjegjësi: **"ju do të urdhëroni të bëhen vepra të mira, e do të ndaloni të këqijat"**. Prandaj, **"ju nuk do të përçaheni, vëllazëria jua nuk do të cenohet dhe do të jeni të fuqishëm"**. Çelësi kryesor i të qenit një dhe të bashkuar, është libri i Allahut. Për këtë arsye, ne duhet të kapemi fort pas sistemit të vlerave që ka shpallur Ai.

Të ndahesh në grupe, të prishësh unitetin, të copëtosh fenë dhe në vend që t'i konsiderosh pasuri, t'i shndërrosh në shkaqe copëtimi medh'hebet, mendimet, metodat dhe xhematet që kanë dalë në emër të fesë, duke u zhytur në sëmundjen e fanatizmit, është një krim shumë i rëndë, në radhë të parë ndaj umetit Islam dhe pastaj ndaj gjithë njerëzimit. Ata që veprojnë kështu, marrin pjesën e tyre të fajit prej çdo krimi dhe padrejtësie që ndodh mbi tokë. Dhe dënimin e kësaj do ta shijojnë në mënyrën më të hidhur, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Allahu i Madhëruar, në lidhje me këtë fund të hidhur, urdhëron:

"Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këta do të ketë dënim të madh." (Al' Imran, 105)

"Me të vërtetë, ti s'ke të bësh fare me ata që e përçajnë fenë e tyre dhe shndërrohen në sekte. Te Allahu është puna e tyre e pastaj Ai do t'u tregojë çfarë patën punuar." (En'am, 159)

Nëse atyre, që ndahen në grupe në emër të fesë dhe e dobësojnë umetin, do t'u priten lidhjet me Pejgamberin (a.s.), duhet menduar se çfarë do të pësojë ai njeri apo ata njerëz që e shkatërrojnë unitetin midis besimtarëve për hir të kësaj bote, të interesave apo pushtetit.

Uniteti kërkon durim, sakrificë, solidarizim, falje, mirëkuptim, altruizëm dhe dorëzim ndaj Zotit dhe të vërtetës. Armiku më i madh i unitetit është smira dhe egoizmi. Kur individët dhe grupet që pretendojnë se i takojnë umetit, të shpëtojnë prej këtyre sëmundjeve, do të arrijnë mëshirën e Zotit dhe fitues do të dalë i gjithë njerëzimi. Ata që jetojnë vetëm për veten, janë njerëz shpirtngushtë. Ndërsa besimi është një dritë hyjnore që i zgjeron shpirtat. Kush është shpirtngushtë, ka edhe besimin e dobët.

1. -shih. Al' Imran, 110.

LAMTUMIRË NJERËZIMIT!..

M. Ali Eshmell

Historia përsëritet. Luftë ndërmjet injorancës dhe udhëzimit. Udhëzimi po përpëlitet, që në çdo moment t'japë njerëzimit drejtësinë, mëshirën, dhembshurinë dhe qetësinë e të dy botëve. Ndërsa injoranca, në çdo moment e zvarrit njerëzimin drejt padrejtësisë, armiqësisë, errësirës, shkatërrimit dhe humbjes në të dy botët. Në rrjedhën e historisë, si pasojë e faktorëve lëvizës dhe ndryshimit të stinës së forcave, kjo luftë e ka shfaqur veten e saj në çdo kohë. Në njërin anë mizorët e pafytyrë, të pashpirt e të pandërgjegjshëm, ndërsa në anën tjetër të dobëtit, të pafajshmit, të dhunuarit dhe klithmat... Sigurisht se më në fund sundon shfaqja absolute e drejtësisë hyjnore. Në ecurinë e ngjarjeve, nga njëri aspekt, historia e njerëzimit është historia e sprovimit të njerëzimit. Pyetjet dhe përgjigjet janë ashikare, por injorantët gjithmonë janë të hutuar nga iluzioni i shkaqeve. Ata përherë janë të lidhur me keqkuptimet, mashtrimet, gabimet, teprimet në thyerjen e rregullave, poshtërsitë, kryengritjet, tragjeditë, padrejtësitë dhe fatkeqësitë. Prandaj, bota e tyre është e huaj për udhëzimin. Edhe nëse mposhten nga e vërteta, nuk kanë vizion për t'u drejtuar Zotit (xh.xh.). Ata gjithmonë preferojnë padrejtësinë. Veçanërisht, nëse e kanë në dorë fuqinë materiale, fletët e tyre të sprovimit mbushen me humbjet më të mëdha shpirtërore. Faktikisht, gjatë globalizimit botëror zhvillimi industrial i hekurit u pandeh si aftësi unike dhe avancimi i lartë i sendeve u quajt peshore e vlerave të njerëzimit. Zhvillimi material i quajtur teknikë, u pranua si më i vlefshëm dhe më i dobishëm se shpirti dhe virtyti i njeriut. Mbi të gjitha, ky u quajt civilizim. Injorantët e duartrokitën, e mbështetën, e inkurajuan dhe e bënë kurorë në kokat e tyre. Por kur të shihen nga dritarja e udhëzimit gjërat që u përjetuan dhe pikat që u arritën, tabloja e quajtur

civilizim që i ishte shfaqur njerëzimit, gjithmonë u bë barbarizëm, tmerr dhe egërsi.

Ngjarjet tragjike që vazhdojnë të përjetohej që prej dy shekujsh në botën islame, prandaj po ndodhin. Ato që u përjetuan dje në Bosnje, prandaj ndodhën. Ato që akoma vazhdojnë të përjetohej në Palestinë, Afganistan dhe Irak, prandaj po ndodhin. Gjërat e shëmtuara, krimet kundër njerëzimit dhe derdhjet e gjakut që po përjetohej në Siri me mënyrat më të tmerrshme, prandaj po ndodhin. Krimet që ta copëtojnë zemrën në Egjipt, prandaj po ndodhin, sepse civilizimi i injorancës është larg udhëzimit, larg mëshirës, larg dhembshurisë, larg ndërgjegjes dhe së fundi, larg humanizmit. Ai e bëri kurban shpirtin e njeriut për gjërat materiale. Truri i tij ngriu në ngjyrën e ftohtë të hekurit. Ndërsa zemrën e bëri një qendër ndjenjash për robotin e pashpirt që kënaqet nga zjarri i bombave, sepse ai është një civilizim që ushqehet vetëm nga padrejtësia. Prandaj, çdo zgjidhje që ai u jep të dhunuarve, është një lloj padrejtësie tjetër e re e ambalazhuar që duket si ilaç. Nisur nga kjo, në të gjithë botën po përjetohej një kohë injorance e dytë. Njerëzit po bombardohen vetëm për t'u argëtuar tiranët. Klima shpirtërore po shkatërrohet te të gjithë, që nga fëmijët e deri te të moshuarit. Përshpirtshmëria e njerëzimit po lëkundet, po grihet, po shtypet, po copëtohet dhe po shkatërrohet nga një dorë helmuese që adhuron idhujt. Dje njeriu ishte robi primitiv i njeriut. Sot, përsëri njeriu është robi i njeriut, por duket si diçka normale, ngaqë punët administrohen në mënyra moderne. Faktikisht, nuk ka asnjë ndryshim ndërmjet kohës së injorancës para më shumë se 1400 vitesh dhe asaj të sotme nga aspekti i përmbajtjes. Ndryshon vetëm garderoba. Botëkuptimi i kohës së mëparshme për robërit ishte primitiv, ndërsa i kohës

së sotme është modern. Çfarë ndryshimi ka? Që të dy janë robër, apo jo? Mbi të gjitha, robëria moderne është shumë më zullumqare dhe shumë më agresive se robëria primitive, ngaqë është e pajisur me më shumë dije dhe mundësi padrejtësie. Sa keq që kjo, në shumicën e rasteve quhet liri! Por bukuria e këtij emri është e mrekullueshme vetëm në pjesën e vitrinës së sistemeve të ndryshme ideologjike dhe e modeleve administruese gjoja humaniste. Nëse kalojmë në pjesën e kuzhinës, klithmat e zëshme dhe të heshtura na i plasën veshët. Krimet, ligësitë dhe vrasjet barbare i trembin shpirtrat. Mizoritë i copëtojnë zemrat, sepse në pjesën e kuzhinës, civilizimi i injorancës heq dorë nga çdo lloj virtutyti. Ai heq dorë nga çdo lloj joshjeje që e ka nxjerrë në plan të parë e që e ka zbukuruar dhe vepron vetëm sipas urdhrat të virusit që ka brenda. Veçanërisht, nëse formohet një pozicion që mund të ketë dobi për myslimanët, ky civilizim heq dorë edhe nga demokracia që ka injektuar vetë, heq dorë nga të drejtat e njeriut dhe nga të drejtat e fëmijëve. Domethënë, nuk lë virtutyti pa hequr dorë, nuk lë moral pa hequr dorë dhe nuk lë të vërtetë apo humanizëm pa hequr dorë. Ja, për këtë arsye zgjidhja e vetme e njerëzisë është udhëzimi. Domethënë, civilizimi i mëshirës, i cili është i njëjtë në fjalë e në vepra, i buzëqeshur në fytyrë dhe ilaç për njerëzimin.

Ky civilizim është civilizimi i dhembshurisë dhe i një ndërjegjeje të vërtetë, me një shprehje tjetër, civilizimi islam. Civilizimi i virtutyteve, që është përjetuar në kohën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), në formën më të përsosur dhe më madhështore të tij. Ky civilizim është dermani e receta e vetme e shpëtimit dhe e lumturisë së njerëzimit. Ja pra, bota ka nevojë gjithmonë për të. Zgjidhja e myslimanëve për të marrë frymë të qetë në Egjipt, Siri, Irak, Palestinë dhe në të gjitha vendet e tjera islame, është civilizimi i udhëzimit. Zgjidhjet cinike në vitrinën e civilizimit të injorancës që e ka kuzhinën plot barbari, kurrë nuk janë ilaç për shërimin e sëmundjeve, sepse këto zgërdhima janë si sjelljet e pavërteta të kasapit që ledhaton delen të cilën do të therë. Nga njëra anë edhe ato janë një lloj tjetër i padrejtësisë. Ose më saktë, janë një kurth padrejtësie i mbuluar me shkëlqime marramendëse. Shikoni në ato kurthe se në çfarë gjendjeje është njerëzimi? Në çfarë gjendjeje janë ndërjegjet? Në çfarë gjendjeje janë nënat? Në çfarë gjendjeje janë ndërtesat, bibliotekat, faltoret, shtëpitë dhe rrugët? Në çfarë gjendjeje janë kafshët dhe insektet? Në çfarë

gjendjeje janë sytë? Në çfarë gjendjeje janë buzëqeshjet? Së fundi, i gjithë marifeti i civilizimit të injorancës në çdo vend të botës është lamtumirë njerëzimit... Padrejtësi e pandalshme... Prapë vetëm padrejtësi... Një padrejtësi tjetër për zgjidhjen e padrejtësisë së mëparshme... Sepse civilizimi i injorancës gjithmonë është kërkuesi dhe i dashuruari i padrejtësisë. Nëse bie në sy, ndryshon ambalazhin dhe përsëri simpatizon padrejtësinë.

Njerëzit e civilizuar të injorancës jetojnë në të njëjtën mani, menefregizëm dhe injorancë. Për fat të keq, ka edhe prej myslimanëve që bien në të njëjtin kurth. Por paralajmërimi i Allahut të Madhëruar është shumë i qartë dhe kuptimplotë: **"A mos kërkojnë ata gjykimin (me ligjin) e (kohës së) injorancës (paganizmit para-islamik)? Kush është gjykatës më i mirë se Allahu për njerëzit që besojnë bindshëm? O ju që keni besuar!**

Mos i bëni miq e mbrojtës hebrejtë dhe të krishterët! Ata janë mbrojtës të njëri-tjetrit.

Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit. Ti i sheh ata me zemra të sëmura,

sesi vrapojnë për t'u lidhur me ata (hebrejtë) duke thënë: 'Druam se mos po na godet ndonjë fatkeqësi!'

Mbase Allahu do të sjellë fitore ose diçka tjetër nga ana e Tij, kështu që ata do të pendohen për atë që kanë fshehur në veten e tyre." (Maide, 50-52) Prandaj, Allahu Teala i shpreh shpeshherë në Kuranin Fisnik gjendjet e dhimbshme të të padrejtëve, në mënyrë që njeriu të pendohet në kohën e duhur dhe të shpëtojë nga ndëshkimi i përhershëm: **"Dhe thuaj: 'E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë.' Ne kemi përgatitur për mohuesit keqbërës një zjarr, që do t'i rrethojë nga të gjitha anët (si çadra). Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t'u jepet një ujë si xehja e shkrirë, që do t'ua përcëllojë fytyrat. Sa pije e tmerrshme është ajo e sa strehim i keq është ai (zjarri)!"** (Kehf, 29)

E gjithë çështja është t'i perceptojmë, t'i shikojmë dhe të vetëdijësohemi për ato ditë që nga ditët e sotme. Përndryshe, njeriu e sheh si civilizim dhe si të drejtë personale edhe padrejtësinë më të rëndë. Pra, mashtrohet ndaj gjelbërimeve rreth e rrotull xhehenemit dhe i konsideron si mirësi. Ndërsa vështirësitë rreth e rrotull xhenetit i pandeh si ndëshkim. Kështu, zvarritet drejt injorancës në mënyrë të pavetëdijshme. Por: **"Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta,**

gjendjeje janë sytë? Në çfarë gjendjeje janë buzëqeshjet? Së fundi, i gjithë marifeti i civilizimit të injorancës në çdo vend të botës është lamtumirë njerëzimit... Padrejtësi e pandalshme... Prapë vetëm padrejtësi... Një padrejtësi tjetër për zgjidhjen e padrejtësisë së mëparshme... Sepse civilizimi i injorancës gjithmonë është kërkuesi dhe i dashuruari i padrejtësisë. Nëse bie në sy, ndryshon ambalazhin dhe përsëri simpatizon padrejtësinë.

Mos i bëni miq e mbrojtës hebrejtë dhe të krishterët! Ata janë mbrojtës të njëri-tjetrit. Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit. Ti i sheh ata me zemra të sëmura, sesi vrapojnë për t'u lidhur me ata (hebrejtë) duke thënë: 'Druam se mos po na godet ndonjë fatkeqësi!'

Ai e bëri kurban shpirtin e njeriut për gjërat materiale. Truri i tij ngriu në ngjyrën e ftohtë të hekurit. Ndërsa zemrën e bëri një qendër ndjenjash për robotin e pashpirt që kënaqet nga zjarri i bombave, sepse ai është një civilizim që ushqehet vetëm nga padrejtësia.

duke thënë: 'Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur! Në të vërtetë, djalli e braktis gjithmonë njeriun në çastin e nevojës.'" (Furkan, 27-29)

"A e ke parë ti atë që epushin e vet e ka marrë për zot? A do t'i bëhesh mbrojtës atij? A mendon se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë." (Furkan, 43-44)

Pra, gjendja në të cilën do të bien ata që i nënshtrohen vetes dhe bëjnë padrejtësi, është mjaft e qartë. Por të mos harrojmë se është Allahu i Lartësuar Ai që u del në mbrojtje të dhunuarve dhe të pafajshmëve. Qëllimi hyjnor në këtë çështje është i mbushur plot me urtësi. Çdo e vërtetë, në fund rrjedh gjithmonë sipas vullnetit dhe sundimit të Allahut Teala. Rezultati më i fundit ka qenë gjithmonë poshtërim për të padrejtin dhe mëshirë për të dhunuarin. I Fuqishmi Absolut kërkon nga gjithë të dhunuarit, të dobëtit dhe të pafuqishmit që ta kuptojnë të vërtetën, ndërsa nga të padrejtët, që të pendohen dhe të pastrohen. Në ajetin e mëposhtëm thotë: **"Mos mendo kurrësi që Allahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen (nga tmerret që do të shohin) dhe duke vrapuar me kokë lart, nuk do mund t'i lëvizin sytë, ndërsa zemrat e tyre do të jenë të zbrazëta (prej tmerrit)." (Ibrahim, 42-43) "Prandaj, shiko si kanë përfunduar keqbërësit!" (Junus, 39) "Popullin e Nuhut, kur i quajti gënjeshtarë të dërguarit, Ne e fundosëm dhe e bëmë mësim për njerëzit. Për keqbërësit kemi përgatitur një dënim të dhembshëm. Ne i dënuam fiset Ad dhe Themud, popullin e Ras-sit, si dhe shumë popujt të tjerë ndërmjet tyre. Të gjithëve u sollëm shembuj dhe më pas, të gjithë i shkatërruam krejtësisht. Ata me kohë kanë kaluar pranë vendbanimit që e shkatërroi shiu i tmerrshëm, vallë, a nuk e kanë parë atë? Jo, ata nuk prisnin të ringjalleshin." (Furkan, 37-40) "Ne të kemi shpallur Librin, i cili është përkujtesë për ju. Vallë, a nuk po kuptoni? Sa e sa vendbanime, banorët e të cilëve kanë qenë mohues, i kemi shkatërruar e pas tyre kemi ngritur popujt të tjerë! Kur e ndjenin dënimin Tonë, ata iknin me të shpejtë. Mos ikni! Kthehuni atje, në luksin tuaj dhe në pallatet tuaja, se ju do të pyeteni." Ata do të thonë: 'Mjerë për ne, me të vërtetë, kemi qenë keqbërës!' Këto rënkime të tyre nuk pushuan, derisa Ne i palosëm si drithë i korrur." (Enbija, 10-15) "Ata që nuk besojnë, thonë: 'Ne nuk do të besojmë kurrësi në këtë Kuran, as në ato që janë zbritur para tij'. Eh, sikur t'i shihje keqbërësit duke dalë para Zotit të tyre dhe duke shkëmbyer akuza me njëri-tjetrin. Të dobëtit do t'u thonë atyre që madhështoheshin: 'Sikur të mos ishit**

ju, ne do të ishim besimtarë." (Sebe, 31) **"Atë Ditë ata nuk do mund t'i bëjnë as dobi, as dëm njëri-tjetrit. Ne do t'u themi keqbërësve: 'Shijoni dënimin e zjarrit, të cilin e keni mohuar!'" (Sebe, 42)**

Përgjatë gjithë historisë njerëzit kanë bërë padrejtësi:

"Prandaj ata i goditi dënimi i të këqijave që kishin punuar. Por edhe keqbërësve prej këtyre do t'u bjerë dënimi për të këqijat që kanë bërë dhe nuk do të mund t'i ikin atij." (Zumer, 51) **"Atë Ditë ti do t'i shohësh keqbërësit se si tmerrohen për atë që kanë fituar, ndërkohë që ndëshkimi Ynë do t'i godasë me siguri..."** (Shura, 22) **"Për atë që Allahu e shpie në humbje, nuk ka mbrojtës tjetër përveç Tij. Ti do të shohësh se si keqbërësit, kur ta shohin dënimin, do të thonë: 'A ka ndonjë rrugë për t'u kthyer?' Ti do t'i shohësh se si do të përballen me zjarrin të përulur nga poshtërimi dhe duke parë tinëzsisht me bisht të syrit. Ata që kanë besuar do të thonë: 'Me të vërtetë që humbësit janë ata që kanë humbur vetveten dhe familjen e tyre në Ditën e Kiametit'. Me të vërtetë, keqbërësit do të vuajnë një dënim të përhershëm! Ata nuk do të kenë asnjë mbrojtës që do t'i ndihmojë, në vend të Allahut. Për atë që Allahu e shpie në humbje, s'ka kurrfarë rruge (shpëtimi)." (Shura, 44-46)**

Allahu i Madhëruar kërkon që të perceptohet me plot kuptimin e tij ndëshkimi i përhershëm që do t'u jepet keqbërësve. Në këtë mënyrë, duke iu drejtuar të Dërguarit të Allahut (a.s.), urdhëron që njeriu të qëndrojë larg çdo lloj padrejtësie: **"Paralajmëroji ata për Ditën e afërt të Gjykimit, kur zemrat do t'u vijnë deri në fyt prej pikëllimit. Për njerëzit e këqinj nuk ka asnjë mik të afërt dhe as ndërmjetësues të pranueshëm."** (Gafir, 18) **"Atë Ditë, keqbërësve nuk do t'u bëjë dobi shfaqësi i tyre. Ata i pret mallkimi dhe një vendbanim i shëmtuar."** (Gafir, 52)

Ndëshkimi për të padrejtin nuk është vetëm në ahiret. Edhe në këtë botë janë përjetuar shumë shfaqje të ndëshkimit hyjnor. Allahu Teala shprehet se kjo është një çështje shumë e lehtë për Të: **"Pas (vdekjes së) tij, Ne nuk i dërguam kurrfarë ushtrie nga qielli (si dënim) popullit të tij dhe as që kishte nevojë për të dërguar. (Mjaftoi për t'i dënuar ata) vetëm një zë i tmerrshëm, pas të cilit u shuan përnjëherësh."** (Ja Sin, 28-29) Domethënë, asnjë padrejtësi dhe ligësi, qoftë në tokë apo në qiell, nuk do ngelet pa u ndëshkuar. Këto nuk janë gjë tjetër, përveçse sprova. Pastaj? Të gjitha rezultatet ashiqare të çdo lloj padrejtësie e zullumi e kanë një fund. O keqbërës! Pse nuk shikoni? Ku është Faraoni? Ku është Nemrudi? Ku është Hulagu? Ku është Ebu Xhehli? A nuk na e vërteton këtë edhe ky ajet që na është mësuar si lutje: **"O Zoti Ynë, cilindo që Ti e fut në zjarr, Ti e ke poshtëruar atë. Dhe për mohuesit nuk do të ketë kurrfarë ndihmuesi."** (Al' Imran, 192) Nisur

nga kjo, drejtësinë nuk duhet ta lëmë në asnjë aspekt. Po ashtu, edhe mëshirën dhe dhembshurinë. Duhet të formojmë qytetërimin e udhëzimit. Duhet të pozicionohemi kundër keqberësit dhe në krah të të dhunuarit. Duhet të pozicionohemi kundër barbarëve dhe në krah të të pafajshmëve. Përndryshe, shumë i qartë është edhe ky paralajmërim hyjnor: **“Për dëshmitarin dhe për atë që dëshmohet! Mallkuar qofshin njerëzit e Hendekut, zjarrit (të ushqyer) me lëndë djegëse, kur rrinin ulur rreth tij duke dëshmuar atë që po i bënin besimtarëve!”** (Buruxh, 3-7)

Në hadithet fisnike, thuhet: *“Nëse njerëzit i shohin të këqijat dhe nuk përpiqen t’i ndalojnë, pa kaluar shumë kohë, Allahu Teala u jep një fatkeqësi të përgjithshme.”* (Ibn Maxhe, Fiten, 20.)

“Betohem në Allahun, në dorën e të cilit është shpirti im se, nëse nuk do urdhëroni të mirën dhe nuk ndaloni të keqen, Allahu do t’ju dërgojë në një kohë të afërt një ndëshkim. Pastaj do t’i luteni e do t’i përgjërohni Allahut, por lutjet tua-ja nuk do pranohen.” (Tirmidhi, Fiten, 9/2169.)

“Allahu Teala nuk i ndëshkon të pafajshmit për mëkatet që bëjnë të tjerët, përveç nëse shikon se ndërmjet tyre bëhen mëkate dhe nuk përpiqen t’i ndalojnë kur kanë mundësi.” (Ahmed, V, 192.)

Detyra që na takon ne si umeti i Muhamedit (a.s.), është të qenët si shi i begatshëm në çdo kohë, në çdo çështje dhe në çdo vend. Të ringjallim njerëzinë me shirat e udhëzimit, mëshirës, drejtësisë dhe dhembshurisë. Të pastrojmë baltën e padrejtësisë nga balli i njerëzve me ujë të pastër. T’u japim ujë zemzemi apo keutheri plot ndihmë të dhunuarve të etur. Vetëm atëherë do ta arrijmë mirësinë në kuptimin që e ka lavdëruar i Dërguari i Allahut (a.s.). Pejgamberi, alejhi’s-selam, thotë: *“Umeti im i ngjan një shiu (të begatshëm). Nuk dihet nëse fillimi apo fundi i tij është më i mirë.”* (Tirmidhi, Edeb, 81.)

Të parët, që ishin të mirë, i morën përgëzimet e tyre: Të jesh sahab / shok i të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ndërsa përgëzimi i atyre që mund të bëhen të mirë në fund, domethënë, në këtë kohën e fundit, është: Të jesh vëlla i të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ebu Hurejra, (r.a.), transmeton se një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), shkoi në varreza bashkë me shokët e Tij dhe tha: *“Paqja e Allahut qoftë mbi ju, o banorët e vendeve të besimtarëve! Inshallah një ditë edhe ne do bashkohemi me ju. Kam shumë dëshirë t’i shikoj vëllezërit e mi. Ah sa më ka*

marrë malli për ta!” Sahabët e nderuar i thanë: *“A nuk jemi ne vëllezërit e Tu, o i Dërguari i Allahut?”* I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha: *“Ju jeni shokët e mi, ndërsa vëllezërit e mi janë ata që nuk kanë ardhur akoma.”* Sahabët e nderuar i thanë: *“Si do t’i njohësh ata që s’kanë ardhur akoma nga umeti Yt, o i Dërguari i Allahut?”* Pejgamberi, (a.s.), i pyeti: *“Mendonin një burrë që ka një kalë me ballë dhe me këmbë të bardha. A nuk mund ta gjejë ky burrë kalin e tij ndërmjet një kopeje me kuaj të zinj?”* Sahabët u përgjigjën: *“Po, e gjen, o i Dërguari i Allahut!”* Pastaj i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha: *“Ja, edhe ata do të vijnë me fytyra të ndritura dhe duar e këmbë që shkëlqejnë për shkak të abdestit. Unë do të shkoj para dhe do t’i pres në krye të burimit për t’u dhënë ujë. Kini kujdes! Disa prej njerëzve do të përzihen nga burimi im siç përzihet deveja e huaj nga kopeja. Unë do t’u thërras atyre: ‘Ejani këtu!’ Mua do më thuhet: ‘Ata e kanë ndryshuar gjendjen pas Teje (nuk e kanë ndjekur sunetin Tënd, kanë devijuar në rrugë të tjera dhe kanë bërë mëkate të mëdha).’ Unë do të them: ‘Le të përzihen, le të përzihen!’”* (Muslim, Taharet, 39.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), në hadithin fisnik thotë se të dashurit e Tij do vazhdojnë të vijnë deri në Kiamet: *“Një pjesë prej atyre që më duan më shumë Mua nga umeti im, do të dalin ndërmjet atyre që do vijnë pas Meje. Ata sakrifkajnë pasurinë dhe familjen e tyre për të më parë Mua.”* (Muslim, Xhenet, 12; Hakim, IV, 95/6991.)

Zemrat fitojnë ndihmën hyjnore aq sa jetojnë nën dritën e këtyre masave. Së fundi, do të shfaqet kjo e vërtetë: Një ditë, Allahu Teala do t’i bëjë keqberësit të thonë: **“Tallahi lekad aserakallahu alejna / Betohemi për Allahun, vërtet që Allahu të ka ngritur ty mbi ne dhe ne paskemi qenë vërtet të gabuar”.** (Jusuf, 91) Esenca e të gjitha kushteve për këtë epërsi dhe fitore është shndërrimi i lamtumirës ndaj njerëzimit në një sjellje të mreku llueshme. Shndërrimi i lamtumirës ndaj mëshirës dhe dhembshurisë, në një sjellje madhështore. Shndërrimin e lamtumirës ndaj ndërgjegjes dhe moralit, në një sjellje të nderuar. Shndërrimi i lamtumirës ndaj besimit dhe Islamit, në një sjellje të bekuar. Me një thënie tjetër, duhet t’i japim lamtumirën civilizimit të injorancës dhe të sjellim civilizimin e udhëzimit. Atëherë, edhe gjembat më të mprehta të padrejtësisë do të shndërrohen në trëndafla të xhenetit... Allahu na dhëntë mirësi!..

Amin!..



BESIM, DASHURI, DËSHMI

Neslhan Nur Turk

Nëse ke thënë: “Dëgjova dhe besova!”, çohu!

Nëse po lodhesh për të dëshmuar besimin, mundohu!

Me të vërtetë, kush kërkon gjën. Çdo të eturi që kërkon ujë, i djegur, i përmalluar e i tharë, i jepet ujë. Çështja është të arrish të falënderosh siç duhet pasi ke arritur tek uji. Dhe falënderimi nuk tregohet duke përsëritur thjesht fjalën “faleminderit”, por duke u përpjekur të kesh frikë Allahun ashtu siç duhet. (shih. Al' Imran, 123.)

Meqenëse falënderimi i vërtetë është i mundur vetëm me bindjen ndaj urdhrave të Allahut dhe ruajtjen nga ndalesat e Tij, atëherë duhet hequr dorë nga sjellja sipas qejfit dhe duhet besuar pa kushte.

Njeriu i beson më tepër atij që do. Ndërsa ndaj atij që nuk do, mban distancë dhe është i kujdesshëm. Shprehjet, si vallë, por, pse, apo vështirësia dhe ngurrimi në të besuar janë shenja të dyshimeve. Ndërsa besimi i vërtetë nuk bart asnjë ngurrim.

Besim do të thotë të pranosh në mënyrë të prerë vërtetësinë e dikujt, ta konsiderosh atë një qenie të lartë, pas të cilit mund të lidhesh dhe t'i drejtohesh atij me një respekt të palëkundshëm. Për çfarë nevojitet një besim kaq i fortë? Për të arritur përsosmërinë në zemër dhe për rrjedhojë edhe në sjellje dhe fjalë. Me çfarë mund të arrihet ky synim? Natyrisht që me dashurinë e një besimtari të përkryer...

Dikush që nuk të do aq sa të mund të thotë “dëgjova dhe besova”, nuk mund as të të imitojë. Përngjasimi i atij që dashuron me atë që dashurohet, është për shkak se ai e pranon atë si qenien më ideale. Kur besojmë se tek dikush janë mbledhur të gjitha virtytet e larta, dëshirojmë t'i ngajmë atij. E ndjekim, mundohemi të jetojmë si jeton ai dhe të jemi pranë tij sa herë që të kemi mundësi. Kur e duam dikë aq sa bëhet ideali ynë, ne marrim shembull mënyrën e jetesës së tij dhe për vetësojmë parimet e tij. Dashuria e vërtetë nuk është një fjalë e cila përsëritet vetëm me gjuhë, por ajo që bëhet shkak i një ndryshimi që shihet me sy dhe ndihet me zemër.

Në këtë pikë, po tregojmë një histori:



Në një fshat jetonte një djalë i ri, i cili donte një vajzë nga fshati, e cila quhej Aishe. Ai i shkonte poshtë shtëpisë së saj, i këndonte serenata, e lëvdonte me poezi dhe gjithmonë i shprehte dashurinë.

Kjo vazhdoi për një kohë të gjatë. Aq sa Aisheja filloi të mendonte: "Vallë, kur do vijë në shtëpi e të më kërkojë dorën?" Ndërkohë që ajo ishte zhytur në këto mendime, djali ia beh përsëri. Aisheja po priste t'i thoshte ndonjë gjë të tipit: "Sot do vijmë nga ju për një sebeb", kurse djali i thotë:

- Aishe të dua shumë! Por do të martohem me Fatimen. Të pres në dasmë. Do vish apo jo?

-???

Kur njeriut nuk i përputhen fjalët me veprat, do të dalë në pah një tablo e tillë. Duhet të pyesim veten: "Vallë, po ne, kështu si ky djali sillemi kundrejt atyre që themi se i vlerësojmë dhe i duam?" Si është gjendja jonë kur bëhet fjalë për besnikëri, bindje apo veprim; kur duhet të sakrifikojmë dhe të dëshmojmë?

Në fakt, fjalët e dashurisë, që nuk janë dëshmuar me vepra dhe nuk kanë kaluar përtej fjalëve, nuk kanë asnjë vlerë. Por më e rëndësishme është të pyesim veten: "Vallë, po ne, të njëjtën gjë bëjmë kundrejt njeriut me moralin më të bukur, Pejgamberit tonë të dashur, (a.s.)"

Sa i kemi ngjarë atij në mendime, fjalë apo punë? A mundëm të bëhemi sa thoi i tij në sakrificë? Sa e morëm shembull atë në lidhje me përjetimin me moslëkundje, dashuri dhe vendosmëri në atë që beson? Sa i ndoqëm gjurmët e të dashurve të Allahut, që janë edhe trashëgimtarët e tij? Kur themi, "e dual", të bëjmë kujdes se me çfarë e kemi lidhur zemrën tonë, me të vërtetën apo me të kotën?

Nëse një mysliman thotë, "besova!", pastaj ndihmon jahuditë, të krishterët ose idhujtarët me paratë e veta, këtu ka një kontradiktë serioze. Një besimtar, në dukje dëshiron të marrë dije; por, nëse ai e shpenzon kohën, vëmendjen dhe pasionin e tij në gjëra të padobishme, kjo është shumë e çuditshme. Një nënë, e cila thotë se dëshiron që fëmijën e saj ta edukojë si vajzën e Pejgamberit (a.s.), por shkon dhe e edukon vetëm për gjëra të kësaj bote, edhe këtu del në pah një çudi. Nëse dikush agjëron gjithë ditën dhe në mbrëmje bën iftar me ushqim haram ose, nëse i fal pesë kohët e namazit, duke qëndruar përpara Allahut, pastaj lë mënjanë fenë në kohën më të nevojshme dhe thotë "jam rob i robit", kjo është me të vërtetë e pakuptimtë. E njëjta gjë është edhe me atë që, pasi thotë se është i mahnitur me karakterin e Omerit (r.a.), shkon e blen edhe një veshje tjetër pa pasur nevojë, duke shpërdoruar pasurinë.

Mirëpo edhe gjella që është duke zier edhe trëndafil

që është duke çelur, madje edhe kufoma që është duke u kalbur, e kanë erën e tyre të veçantë. Prej çdo zjarri përhapet tym, nxehtësi dhe erë. Zjarri i vërtetë lëshon shkëndija. Zjarri i vërtetë të djeg e të pjek. Atëherë, të hedhësh slogane dashurie artificiale, si "U dogja nga malli për ty, o Rasullah!" dhe të mos ketë asnjë shenjë tymi, zjarri apo shkëndije, është diçka shumë e çuditshme.

Po ashtu edhe femrat besimtare, që pasi thonë "besova", shpenzojnë një mal me para për të blerë veshje ekstremisht të ngushta, duke u futur kështu në kategorinë e "të veshurve lakuriq" (shih. Muslim, Xhenet 52.), janë shumë të çuditshme. E njëjta gjë ndodh edhe me meshkujt besimtarë që, megjithëse sytë i kanë të krijuar me kapakë, vazhdojnë me këmbëngulje të shohin haramin. (shih. Nur, 30.) Çudi është edhe me ata, që pasi thonë "jam mysliman elhamdulillah", vazhdojnë të hanë kamatën, të mashtrojnë njerëzit dhe të tradhetojnë amanetin; apo edhe me ata që thonë, "jemi prej umetit të Muhamedit" dhe e konsiderojnë veten të drejtë e të pafajshëm pas çdo lloj gjynahu, madje përpiqen edhe ta shfaqësojnë veten.

Ndërkohë që duhet të merremi me verifikim, ne kemi probleme edhe në imitim; nëse themi "besova" dhe na ikin namazet, këtu ka diçka që s'shkon. Sa e çuditshme është që tashmë edhe vetë myslimanët nuk e respektojnë edukatën e Ramazanit, por hanë në mes të ditës në sy të të gjithëve.

Ndërkohë që mirësitë duhet t'i bëjmë vetëm për hir të Allahut, është e pakuptimtë që t'i bëjmë ato për hir të humanizmit me logjikën e pëlqimit nga të gjithë. Sa e trishtueshme është gjendja e egove tona që prodhon arsytetime pas arsytimesh. Sa e hidhur është gjendja e njeriut, që e humbet mirësinë e namazit me xhemat, ndërkohë që dera e shtëpisë së tij është përballë derës së xhamisë.

Ejani, pa u bërë ende vonë, të kthehemi me gjithë qenien tonë në gjurmët e njeriut me moralin më të bukur, në gjurmët e të Dashurit të Allahut (a.s.). Sa herë që themi "shehadetin", deklarojmë me gjuhë se Allahu është Një i Vetëm dhe se Muhamedi (a.s.), është i Dërguari i Tij. Tashmë, këtej e tutje, le ta vendosim Kuranin dhe Sunetin në qendër të jetës sonë. Çështjet e çuditshme le të ndërrojnë vend në sajë të faljes e të bëhen mëshirë.

O Allah! Çështjet dhe zemrat tona merri në anën e kënaqësisë Tënde. Bëj që të kuptuarit, të mësuarit dhe besimi ynë të jenë të fortë. Na pajis me dashurinë dashuron Ti dhe na fut në radhët e fatlumëve, që i ngjajnë të Dashurit Tënd dhe takohen në xhenet me atë të cilit i ngjajnë!

Amin!



PARAGJYKIMI

është gjykim më i keq

All Riza Temel

Abdullah ibn Mes'udi, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Asnjë prej shokëve të mi, të mos më tregojë ndonjë gjë për ndonjë tjetër, sepse unë dëshiroj të dal para jush pa mbajtur anën e dikujt dhe me zemër të qetë."* (Ebu Davud, Edeb. Hadithi nr: 4860.)

Kjo shprehje e të Dërguarit të Allahut (a.s.), është rregull më themelor dhe më i saktë i drejtësisë dhe i marrëdhënieve ndërmjet njerëzve. Sipas një parimi të jurisprudencës islame: "Pafajësia është themelore". Ky është parimi që tregon se njeriu është i pafajshëm, përderisa të mos ketë ndonjë argument kundër tij. Siç është themelor lejimi te gjërat, edhe te njeriu pafajësia është themelore. Sipas Islamit, njerëzit lindin të pafajshëm. Askush nuk është përgjegjës për mëkatet e dikujt tjetër. Allahu i madhëruar thotë:

"Kushdo që bën diçka, punon për vete dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit." (En'am, 164)

Vendi, krahina, ngjyra, gjuha dhe feja e njeriut, nuk duhet të bëhen shkak për një gjykim të menjëhershëm të tij. Njerëzit kanë vlera jo sipas ngjyrës, prejardhjes, pasurisë apo pozitës, por sipas moralit, punës dhe sinqeritetit të tyre.

Ata që gjenden në krye të punëve administrative dhe ligjore, duhet të kenë shumë kujdes ndaj parimit profetik që transmetuam më sipër. Vlerësimi i njerëzve sipas syve, fjalëve dhe veshëve të të tjerëve, është gabim shumë i madh, sepse njerëzit nuk sillen shumë objektivë, për shkak se kanë smirë, armiqësi dhe rivalitet me njëri-tjetrin.

Sigurisht se mund të merren informacione për të tje-

rët nga njerëz të besueshëm, por vendimi përfundimtar duhet të jetë vendimi objektiv i vetë njeriut, pasi të ketë bërë vëzhgimet dhe provat personale sipas mundësisë që t'i jepet. Para se të jepet vendimi, së pari bëhet një studim me detaje, bëhen konsultimet dhe pastaj bëhen fotot objektive të çështjes. Në dritën e vëzhgimeve dhe informacioneve të sakta, jepet vendimi i drejtë. Allahu (xh.xh.), në Kuranin fisnik, thotë:

“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishte i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ta për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.” (Al' Imran, 159)

Çështja për të cilën bëhet fjalë në hadith, është fakti që të mos u jepet shans servilëve, të cilët duan të afrohen te autoritari apo të dalin në plan të parë duke folur keq për të tjerët, edhe pse nuk pyeten. Në përgjithësi, njerëzit autoritarë rrethohen prej servilëve. Në këtë mënyrë, servilët mundohen të hapin vend për vete, duke dhënë informacione të gabuara dhe duke thënë fjalë të këqija për të tjerët.

Të gjithë nuk mund t'i vlerësojnë njerëzit. Një fjalë e urtë thotë: “Vlerën e floririt e di vetëm argjendari”. Ai ka disa kriterë që përcaktojnë vlerën e tij. Peshorja duhet të jetë e saktë. Nëse ajo nuk është e tillë, përsëri nuk ka dobi, edhe nëse njeriu që mat është i drejtë.

Shumë prijës, që i kanë vlerësuar ngjarjet dhe njerëzit me fjalët dhe sytë e të tjerëve, janë bërë vegël e shumë padrejtësive, krimeve dhe tragjedi. Shumë herë edhe ata vetë kanë pasur një fund tragjik.

Ne duhet të jemi shumë të ndjeshëm kur vlerësojmë njerëzit dhe asnjë person nuk duhet ta prekim në nder, sepse nderi i njerëzve është më i rëndësishëm se çdo gjë. Thuhet se është më mirë të vdesësh se sa të rrosh pa nder. Edhe pse në fenë tonë është e ndaluar vetëvrasja, disa njerëz tentojnë të vetëvriten kur u preket nderi. Për këtë arsye, përgojimi, spiunimi dhe shpifja, të cilat janë sjellje që prekin nderin e njeriut, në Islam konsiderohen mëkate të mëdha.

Mashtrimi i prijësve dhe i popullit, më parë përgjithësisht ishte në planin individual. Ndërsa sot, puna e mashtrimit është institucionalizuar me anë të medias. Në këtë mënyrë, media e përdorur për keq, pothuajse

është bërë një mjet që i devijon ngjarjet. Veçanërisht prijësit, duhet të kenë shumë kujdes ndaj medias, e cila i përdor njerëzit si armë acarimi. Ata nuk duhet t'i marrin në konsideratë lajmet që nuk mbështeten në të dhëna kategorike. Arma e medias shpesh kthehet edhe kundër zotëruesit të saj. Në këtë mënyrë, i shkatërron të gjithë.

Kurani fisnik na paralajmëron kështu, në lidhje me lajmin e vërtetë:

“O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pander-shëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt pa dashje e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë.” (Huxhurat, 6)

“Mos shko pas diçkaje, për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi.” (Isra, 36)

“O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.” (Huxhurat, 12)

Siç nuk mund ta mbrojtë veten një njeri i vdekur, po ashtu, nuk mund ta mbrojtë edhe ai i cili përgojohet në një vend ku nuk ndodhet. Për shkak se përgojimi në përgjithësi ka lidhje me interesa personale, kjo gjë do të thotë të shesësh nderin e vëllait dhe ta bësh këtë burim fitimi. Nisur nga ky aspekt, përngjasimi i Kuranit fisnik është i mrekullueshëm.

Gjykimet e menjëhershme apo siç i quajmë sot, paragjykimet, janë armiku më i madh i sigurisë, mbrojtjes dhe përparimit të vëllazërisë në fe. Në një mjedis ku të gjithë dyshojnë te njëri-tjetri, nuk mund të ketë miqësi, qetësi dhe përparim, sepse dyshimi, paragjykimi dhe thashethemet nuk mund të përbëjnë bazën e asnjë pune serioze. E ardhmja e fortë ndërtohet mbi të dhëna të sakta, miqësi dhe besim të fortë.

Paragjykimi është një gjykim i pa mbështetur në kërkim (hulumtim). Për këtë arsye, nuk ka bazë. Veprimet dhe tentativat e pabaza nuk mund të kenë fryte të dobishme. Të gabuarit përgjatë kërkimit, ka më shumë vlerë se gjetja e rastësishme, sepse njeriu nuk mund të marrë rrugën duke u mbështetur te rastësia. Ndërsa kërkimi nxjerr në pah shkaqet e gabimit dhe të së drejtës.

Në një aspekt, paragjykimi është dembelizëm. Ata





që përtojnë të kërkojnë, më së fundi detyrohen të përballojnë vështirësi më të mëdha. Po ashtu, është shumë gabim që njerëzit t'i vlerësojmë sipas disa gabimeve të vogla të tyre apo sipas veshjes. Faktikisht, nuk ka njeri pa gabime. Forma dhe veshja janë të përkohshme. Ato nuk nxjerrin në pah karakterin e vërtetë të njeriut, madje nganjëherë edhe mund të na mashtrojnë.

Hipokritët, që në aparencë janë tërheqës dhe përbrenda të kalbur, përshkruhen kështu në Kuranin fisnik:

“Kur i shihni ata, pamja e tyre e bukur ju mahnit. Nëse flasin, ju i dëgjoni fjalët e tyre. Megjithatë, ata janë si trungje të mbështetura. Ata kujtojnë se çdo thirrje që dëgjojnë është kundër tyre. Ata janë armiqtë e vërtetë, andaj ruajuni prej tyre! Allahu i vraftë! Sa shumë që janë larguar (nga e vërteta)?” (Munafikun, 4)

Ka prej atyre njerëzve që shërbejnë dhe sakrifikojnë aq shumë në rrugë të së vërtetës, sa që këto shërbime dhe sakrificat bëhen shkak për faljen e shumë mëkateve të tyre. Disa njerëz përjashtohen përgjithmonë, për shkak të disa gabimeve të vogla dhe hidhen jashtë shoqërisë sikur të ishin me lebrozë. Ndoshta ata që i poshtërojnë kanë më shumë gabime. Sikur mëkatet të shfaqeshin në fytyrë si njolla, askush nuk do të mund të shikonte fytyrën e tjetrit. Sikur mëkatet të dehnin si alkooli, ndoshta rrallë do të gjendej njeri që do të mund të qëndronte në këmbë.

Punët vlerësohen sipas rezultateve të tyre. Askush nuk e di se si do të jetë fundi dhe se në çfarë forme do ta lërë këtë botë. Shumë njerëz, që njiheshin për të mirë, kanë përfunduar keq. Po ashtu, shumë njerëz që njiheshin për të këqinj, kanë përfunduar mirë.

Për të gjithë duhet të dëshirojmë udhëzim dhe mirësi. Nëse në një anije gjendet një njeri i mirë ndërmjet njëqind të këqinjve, për hir të tij nuk mund të dëshirojmë mbytjen e anijes. Kështu, duhet të konsiderojmë mirësinë e një sevapi, krahas nëntëdhjetë e nëntë mëkateve. Gjithmonë duhet të mendojmë mirë për njerëzit, për shkak se dera e pendimit është e hapur deri në frymën e fundit.

Ata që kanë parë gjendjen e Umerit, (r.a.), para se të bëhej mysliman, nuk mund ta imagjinojnë dot gjendjen e tij pasi pranoi Islamin. I keqi i keq dhe i miri i mirë nuk qëndrojnë gjithmonë. Në lidhje me këtë, ka shumë shembuj në të kaluarën dhe në kohën e sotme.

Të gjithë duhet ta mbajnë mend hadithin që kemi transmetuar në fillim, të mos paragjykojmë njerëzit dhe ngjarjet e personat t'i vlerësojmë sipas parametrave të duhur. Cilësia jonë dalluese duhet të jetë drejtësia dhe jo nxitimi.

ALARM

lidhni rripat e sigurimit

Lidhni rripat e sigurimit!

Kjo është fraza që shfaqet me dritë të kuqe në çdo avion, sa herë që lëshohet apo ulet, duke lajmëruar se një ndryshim i rrezikshëm po ndodh. Ndjej tani se një frazë e ngjashme po shfaqet në makinën e qytetërimit, në të cilën kemi hipur të gjithë ne raca njerëzore në këtë kohë, duke na lajmëruar për në nivelet më të ulëta.

E dëgjojmë këtë alarm, sepse ne duhet të lidhim rripat e sigurimit, jo se po ngjitemi, por po biem, po ulemi, po zbresim e po rrokullisemi.

Në Lindje dhe Perëndim egërsirat njerëzore nxjerrin dhëmbët dhe kthetrat e tyre. Nuk kanë më turp dhe as nuk turpërohen. Nuk kthehen më tek metodat e sjellshme diplomatike, të cilat flasin për lirinë, demokracinë dhe çlirimin e popujve nga shfrytëzimi dhe skllavërimi.

Nuk ngrihet më flamuri i paqes, ka vetëm slogane teorike verbuese dhe mendimi i saktë nuk mund të udhëheqë...

Nga kampi komunist dolën dy gjigandë, që shkëmbejnë me njëri-tjetrin armiqësi më të madhe se sa shkëmbejnë me armikun e tyre, kapitalizmin. Kontradiktorë me vetë logjikën e komunizmit, sikur ai të kishte qenë bojë mbi letër. Historinë nuk e bën më lufta e klasave, sepse këtu kemi dy kampe të mëdha, proletariatin dhe proletariatin; dhe të dy janë në konflikt.

Kapitalizmi me rolin e tij ka filluar të praktikojë hapur krimet më makabre në histori mbi tokën vietnameze, sionizmi zbuloi fytyrën e tij në Liban dhe komunizmi në Afganistan.

Flotat detare kanë armatosur detet për të shfaqur muskujt e tyre.

Avionët i janë lëshuar qiellit me zhurmat e tyre dhe garojnë në përhapjen e frikës.

Satelitë artificialë konkurojnë në spiunazh.

Raketat... çdo raketë i thotë tjetrës: "Unë kam rreze më të gjatë veprimi!"

Fuqia... fuqia... fuqia...

Qytetërimi materialist ka finalizuar nënshtrimin e shkencës për prodhimin e forcës, për shpikjen e mënyrave të vdekjes, urinë dhe mungesën e ushqimit. Varfëria po

gllabëron kontinentet dhe miliona presin të armatosen. Prodhimi i tepërt i grurit hidhet në det për të rritur çmimin e tij.

Qytetërimi materialist ka falimentuar. Makina e qytetërimit po na hedh poshtë, më poshtë e më poshtë.

Ne duhet të lidhim rripat e sigurimit, si përgatitje për rrezikun që na pret. Ne duhet ta përballim veten tonë me realitetin, të ndalemi nga promovimi i gënjeshtreve dhe nga llafollogjia e lirive që fare nuk ekzistojnë.

Dhe është kthyer koha e mercenarëve dhe e xhandarëve.

Ka me mijëra që marrin pagat e tyre, sepse ata luftojnë nën hijen e çdo flamuri.

Spiunimi është shndërruar në art (si të bëhesh spiun i dyfishtë). Të spiunosh për popullin tënd dhe kundër tij. Të punosh me dy mbrojtje dhe për llogari të atij që paguan më shumë.

Medh'hebet janë shndërruar në krahë të pushtetit, konsum gazetash. Pafajësia e të fortëve sundon të dobëtit. Zullumi i të fortëve ndaj të dobëtve dhe shfarosja e të dobëtve prej të fortëve.

Ky është alarm për falimentim të vërtetë.

Filozofia materialiste ka qenë e paaftë të ndërtojë njeriun, edhe pse ka mundur të ndërtojë bombën. Ne vazhdojmë të ecim drejt rënies së pashmangshme, nëse nuk nxitojmë të ndryshojmë drejtimin e anijes së mbarë qytetërimit në kahun tjetër. Këtë herë jo drejt filozofisë materialiste, por filozofisë që e pranon njeriun me shpirt dhe qenie, që e krijoi Allahu të lirë të vlefshëm për përjetësi.

Kthimi nga filozofia shpirtërore, që merr nga shkencë (dituria) gjithçka që i jep dhe i shton asaj prodhimtarinë e vet.

E nga do të dalë kjo filozofi, përveçse në Lindje!!

A do të kthehet frymëzimi e të burojë edhe një herë? A do të lindë dielli i ri dhe të sundojë paqja dhe Islami apo ne do të biem në humnerën e gremenës?.

*Përktheu nga arabishtja:
Lavdrim Hamja*

Doç. Dr. Sulejman Derin

Superioriteti I SAHABËVE



Sahabët janë të parët e kësaj feje, ndërsa myslimanët që erdhën pas tyre, janë fryt i punës së tyre. Ata që kanë ardhur më vonë, përfitojnë nga drita dhe begatia e të parëve të tyre.




Sipas botëkuptimit të ehli sunetit, sahabët, shokët e nderuar të Pejgamberit tonë (a.s.), ishin shembuj të papërsëritshëm dhe myslimanët që do të vijnë pas tyre, nuk mund ta arrijnë kurrë gradën e tyre. Por megjithatë, herë pas here disa prej sufive kanë pretenduar se kanë arritur gradën e tyre, madje edhe të pejgamberëve.

Imam Rabani, në një letër që i dërgoi njërit prej nxënësve të tij, i jep atij informacione të detajuara në lidhje me këtë temë dhe i shpjegon kështu shkaqet e gabimeve të disa prej sufive:

I shtrenjti vëllai im! Ndonjëherë, ngjitja në shkallë të larta e disa njerëzve që janë në shkallë më të ulëta, është njësoj si dalja e të varfërve dhe nevojtarëve përpara autoriteteve të larta të shtetit ose njerëzve të rëndësishëm për të kërkuar ndihmë prej tyre. Njerëzit me shikim të cekët e komentojnë këtë si ngritje e të vegjëlve në gradat e të mëdhenjve. Në përgjithësi, dalja përpara të mëdhenjve bëhet në kuadër të vizitimit të institucioneve të larta të shtetit dhe shikimi i tyre për një moment në sajë të disa ndërmjetësve bëhet me qëllim të shtimit dhe forcimit të respektit e rëndësisë së shtetit. Si është e mundur të bëhesh i njëjtë me autoritetet e

larta të shtetit në një kohë kaq të shkurtër? I madh e i vogël, të gjithë e dinë mirë se shërbëtorët hyjnë e dalin në dhomat e padronëve të tyre për shkak të punës që kanë. Por disa mendjelehtë pandehin se shërbëtorët janë të barabartë me padronët e tyre. Madje, injoranca e tyre arrin gjer aty sa mund të pa-



ndehin se edhe shërbyesit apo truprojat e sulltanit, të cilët qëndrojnë pranë tij, janë të barabartë me të. (V. II. Letra 99.)

Megjithatë, Imami mendon se këto pretendime që disa prej sufive i bëjnë në gjendje të dehur (emocioni), duhen interpretuar. Përndryshe, këta njerëz duhen gjykuar si mohues dhe të devijuar, gjë e cila nuk është e drejtë të bëhet nga një ehli kible. Kjo, sepse të gjithë dijetarët kanë rënë në konsensus se asnjë mysliman nuk mund të ngrihet, jo vetëm në gradën e pejgamberëve, por as në atë të sahabëve fisnikë. Pretendimet e sufive në fjalë janë si ajo pula e uritur që e pandeh veten në hambarin e drithit. Këtë gjendje, Imam Rabani e shpjegon kështu:

Nuk ka asnjë meritë më të madhe se të qenit shok i Pejgamberit (a.s.). Kushdo qoftë prej umetit, me devotshmërinë, adhurimet dhe asketizmin që mund të ketë bërë gjatë gjithë jetës, nuk mund të barazohet kurrë, qoftë edhe me një punë të vogël të sahabëve, të cilët u shfaqën për të mbështetur të Dërguarin e Allahut në kohën kur Islami ishte ende i dobët.

Në një hadith fisnik, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Nëse dikush prej jush dhuron ar qoftë edhe sa mali i Uhudit, nuk i afrohet as një "mudd" (njësi matëse 875 gr) elbi dhe as sa gjysma e saj që ka dhuruar një prej sahabëve të mi."*

Imam Rabani shprehet se grada e lartë e sahabëve fisnikë pranë Allahut, fshihet në shërbimin dhe sakrificën e pashembullt që ata bënë dhe se në veçanti Ebu Bekri (r.a.), qëndron në krye të të gjithëve. Super-


ioriteti i Ebu Bekrit (r.a.), qëndron në faktin se ai ishte nga të parët që e pranoi Islamin, ai dhuroi më shumë pasuri dhe mori përsipër detyrat më të vështira. Për këtë arsye, në lidhje me të u zbrit ky ajet fisnik: **"... Nuk janë të barabartë ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar para fitores me ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar më pas. Ata kanë shkallë më të lartë, mirëpo Allahu u premton të gjithëve më të mirën (Xhenetin)..."** (Hadid, 10)

Disa persona, duke marrë për bazë legjendat e shumta të hiperbolizuara në lidhje me personat e tjerë, bashkëkohës me Ebu Bekrin (r.a.), kanë nguruar për sa i përket superioritetit të tij. Këta persona nuk e kuptojnë që legjendat e shumta në lidhje me dikë, nuk mund të jenë shkak superioriteti ndaj të tjerëve. Përveç kësaj, Imami shprehet, se sahabët janë të parët e kësaj feje, ndërsa myslimanët që erdhën pas tyre, janë fryt i punës së tyre. Ata që kanë ardhur më vonë, përfitojnë nga drita dhe begatia e të parëve të tyre.

Imam Rabani, duke marrë si shembull Ebu Bekrin (r.a.), ndan me ne recetën e të qenit të parët në fe: "Sipas këtij varfanjaku, shkaku i superioritetit është mbështetja e fesë dhe sakrificimi i pasurisë dhe jetës për përhapjen e mësimëve të fesë. Për shkak se Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), ishte i pari në këtë çështje, padyshim që ishte edhe më superior ndaj të gjithëve... Pas Pejgamberit tonë (a.s.), prijësi i umetit u bë Ebu Bekri (r.a.). Shkaku i kësaj, ishte se Ebu Bekri (r.a.), kishte dhuruar shumë pasuri, kishte marrë pjesë në shumë luftëra të ashpra dhe ishte më i afti në çështjen e përdorimit në mënyrën e duhur të postit dhe në mbrojtjen e fesë nga prishjet dhe dëshimet".

Me këto fjalë Imami u jep një mësim të gjithë atyre që dëshirojnë të pasojnë rrugën e Ebu Bekrit (r.a.). Kerameti i vërtetë është mbështetja e Islamit në kohë të vështira, me qëllim që feja të mbahet në këmbë. Në fakt edhe të mëdhenjtë e kësaj rruge janë gjendur gjithmonë pranë fesë dhe institucioneve fetare në kohë të vështira. Ata kanë sakrifikuar pasurinë dhe jetën e tyre për të mbështetur kurset e Kuranit, medresetë dhe institucionet e tjera të edukimit fetar. Në këtë mënyrë, ata mbajtën gjallë trashëgiminë e Ebu Bekrit (r.a.), në shekullin që po jetojmë. Lum ata që i bashkohen këtij karvani fisnik!

1. Imam Rabani aludon për vetveten





RAPORTET BRENDIA FAMILJES

PROBLEM I KOHËS

“Ne e kemi obliguar njeriun të sillet mirë ndaj prindërve të vet...” (Ankebût, 8) - **“Asnjë prind nuk mund t’i dhurojë fëmijës së tij diçka më të çmuar se edukatën!”**¹

Familja është bashkësi e përbërë nga nëna, babai dhe fëmijët, por ka një zhvillim edhe më të madh se kaq. Ajo është bashkësi më e vogël sociale, në të cilën lind, rritet, zhvillohet njeriu dhe ku merr shkollën dhe edukatën e parë. Sado e vogël të jetë, rëndësinë e sajë në shoqëri e ka shumë të madhe. Bashkësi familjare është formuar qysh me ardhjen e parë të njeriut në këtë botë. Ajo është formuar si një dëshirë e Krijuesit, që njeriu i parë të jetë pronar i një familje e jo siç pretendojnë disa sociologë se është krijuar si rezultat instinktiv dhe i rastësishëm në këtë botë.² Kurani i ka kushtuar thelbit familjar një rëndësi të madhe, me qëllim që nderi dhe vlera e saj të mbrohet me çdo kusht. Allahu (xh.sh.), thotë: **“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë.”**³

Ne e falënderojmë në mënyrën më specifike Allahun e Madhërishëm, për këtë botë plot mrekulli, me shije e pamje të ndryshme, me stinët që ndërrojnë. Ai krijoi për ne gjithë këto mirësi të panumërta, kështu që ne i jemi shumë borxhli të zbatojmë atë që Ai na obligoi... Të gjithë njerëzit në këtë jetë kanë një program për të cilin punojnë. Si myslimanët, ashtu edhe të tjerët – jo myslimanët - vrapojnë dhe përpiqen të krijojnë projekte të ndryshme, në mënyrë që t’i arrijnë qëllimet e tyre. Por shtrohet pyetja: deri kur dhe deri ku në këtë mënyrë? Në çfarë niveli i kemi raportet me Krijuesin, për të vazhduar dhe zbritur në familje, me rrethin e ngushtë e kështu me radhë? Si janë raportet tona në lidhje me ata që na lindën, prindërit tanë, që na rritën, na ofruan kafshatën e gojës, përgjysmuan dhe ndërprejnë gjumin e tyre në mesnatë, braktisën shumë e shumë gjëra, vetëm e vetëm që fëmija i tyre të mos ndihet i vetmuar dhe të mos vajtojë...?

Mirësitë dhe zhvillimet që na rrethojnë, siç duket na e kanë zbehur dhe po vazhdojnë të dëmtojnë rrethin dhe

lidhjen tonë familjare. Gjithkush mundohet të arrijë diçka, por në anën tjetër është harruar se po shkatërron dashurinë shpirtërore dhe lidhjen prindërore. Sa shumë prindër vuajnë sot nga vetmia, ngaqë fëmija i tyre i braktisi, në mënyrë që të jetojë në një ambient “modern”, pa e pasur barrën e prindërve. Ata i dërgojnë nëpër qendra të ndryshme rehabilitimi, i lënë në mbikëqyrjen e spitaleve apo organizatave që merren me mbikëqyrjen e të moshuarve, ose, e kundërta e kësaj, sa e sa fëmijë sot jetojnë nëpër çerdhe dhe jetimore, ku prindi i tyre i ka braktisur, me arsye se ai fëmijë i lindur pa dëshirën e tyre, është i tepërt dhe pengon aktivitetin e nënës apo babait. Si rezultat i kësaj, në shumë vende të botës, e kohëve të fundit edhe tek ne, janë hapur qendra për mbikëqyrjen e këtyre dy kategorive njerëzore. E para: prindërit që braktisen nga fëmijët e tyre dhe e dyta: fëmijët që braktisen nga prindërit e tyre.

T’i qasemi kësaj problematike dhe dukurie negative nga këndi kuranor dhe porosinë e të Dërguarit, Muhammed Mustafa.

A) PRINDËRIT QË BRAKTISËN NGA FËMIJËT

I gjithë problemi qëndron se shumë fëmijë, pasi arrijnë një moshë dhe krijojnë një shoqëri, i harrojnë të gjitha shërbimet që i kanë bërë nëna dhe babai i tyre, kështu që arrijnë deri tek ajo pikë, sa të braktisin në mënyrë më të mjeruar prindërit e tyre. Për këtë shërbim kaq preciz dhe të palodhshëm që prindërit bënë për fëmijët e tyre, Allahu (xh.sh.), në Kuranin Fisnik thotë: **“Ne e urdhëruam njeriun t’u bëjë mirë prindërve të vet, ngase nëna e vet me mundim e barti dhe me vështirësi e lindi, e bartja e tij dhe gjidhënia zgjat tridhjetë muaj e ai vazhdon të jetojë, derisa të arrijë pjekurinë e vet dhe, kur t’i mbushë dyzet vjet, ai thotë: ‘Zoti im, më frymëzo mua të të falënderoj për të mirën që më dhurove mua dhe prindërve të mi, që të bëj vepra të mira që i pëlqen Ti dhe m’i bëj të mirë pasardhësit e mi. Unë pendohem tek Ti dhe jam me myslimanët”**.⁴ Si është e mundur që t’u kthejmë shpinën dhe të braktisim prindërit tanë në vetmi, kur me një mund të madh nëna na barti në barkun e saj për nëntë muaj me radhë, babai u kujdes në mënyrë maksimale për të qëndruar afër saj, që fëmija të zhvillohet sa më mirë dhe më lehtë. Nuk mbetën vetëm

1. Tirmidhî, Birr 33.

2. Prof. Dr. Ahmet Yaman, Islam Aile Hukuku, f. 12.

3. Rûm, 21.

4. Ahkâf, 15.

me kaq, por siç u vërejt edhe nga ajeti kuranor, shërbimi për fëmijën zgjati edhe dy vite të tëra me gji-dhënie, e më pas, deri në moshën dhjetë- vjeçare nëna pati detyrë parësore edukimin dhe zhvillimin e fëmijës së saj. Prindërit, nga këshilla dhe urdhri i Pejgamberit (a.s.), mundohen që deri në moshën shtatë vjeç ta mësojnë atë në praktikimin e namazit, që fëmija të mos jetë pa njohuri fetare.

Nëse pas këtij shërbimi dhe kujdesi që kanë obligim prindërit për fëmijët e tyre, djali apo vajza i braktis ata, i dërgon në qendra kujdesi për të moshuarit, paguan shërbëtorë që të merret me ta, atëherë ç'mund të themi, përveçse Allahu ua shtoftë dashurinë ndaj prindërve?

B) FËMIJËT QË BRAKTISEN NGA ANA E PRINDËRVE

Ekziston edhe aspekti tjetër i problemeve brenda në familje, ku në këtë rast viktimë janë fëmijët e mjerë. Siç duket, luksi dhe fitimi i pasurisë jo në mënyrë të lejuar, ka ndikuar që shumë nga çiftet e martuara kanë vendosur të mos lindin fëmijë. Mirëpo, kur kjo ndodh pa dëshirën e tyre, këta kërkojnë zgjidhje të ndryshme që të lirohen nga kujdesi për fëmijët e tyre. Atëherë, një pjesë e këtyre prindërve mundohet ta gjejë zgjidhjen në abortim, një pjesë tjetër në braktisjen e fëmijës në forma nga më çnjerëzoret. Që të gjitha këto metoda janë të ndaluara dhe haram. Por ekziston edhe një kategori tjetër që, pasi rritet fëmija, e dërgojnë nëpër çerdhe fëmijësh, që të mos e kenë obligim kujdesin ndaj tij. Kjo ndikon në shkëputjen e dashurisë së ndërsjelltë. As fëmija nuk rritet në mëshirën dhe dashurinë e një nëne e as nëna nuk arrin të ketë ndjenjën e duhur për fëmijën. A thua këto grupe njerëzish kanë frikë mirëmbajtjen e tyre? Jo, kjo nuk duhet të ndodhë. Për këtë, Allahu (xh. sh.), ka thënë: **“S’ka dyshim se Zoti yt është Ai që furnizon me bollëk atë që do dhe ia kufizon atij që do. Ai di hollësisht për robërit e vet dhe i vështron. Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve e mbytja e tyre është mëkat i madh”**.⁵ Në anën tjetër, nëse një fëmijë rritet në çerdhe, as ai e as prindërit nuk mund të kenë dashuri ndaj njëri-tjetrit. Transmetohet nga Aisheja (r.a.): “Erdhën disa njerëz (arabë) tek i Dërguari i Allahut (a.s.) e i thanë: ‘A i puthni ju fëmijët tuaj?’ Tha: ‘Po’. (Ata) Thanë: ‘Ne, pasha Allahun, nuk i puthim!’ I Dërguari i Allahut (a.s.) tha: ‘Ç’mund t’ju bëj, nëse

Allahu e ka shkëputur mëshirën nga zemrat tuaja”.

LIDHJA FAMILJARE PRIND – FËMIJË

“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë të mos adhuronit tjetër veç Tij, të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as of, as mos u bëj i vrazhdë ndaj tyre, po thuaju fjalë të mira (të buta respektuese)”.⁶

Të gjitha punët dhe veprat e mirë në Islam, kanë shpërblime nga më të ndryshmet e, po ashtu, kanë dënime edhe veprat e liga. Për të pasur shpërblime çdo vepër, kërkohet që në fillim të besohet Allahu (xh. sh.) dhe të kryhen urdhrat e Tij. Pa besim, asnjë punë nuk ka ndonjë shpërblim. Pas gjithë këtij kushti që ka vendosur Allahu (xh.sh.), menjëherë ka caktuar kusht të prerë respektimin e prindërve dhe bamirësitë e tjera, siç theksohen në ajet. Prandaj, respekti dhe mirësjellja ndaj prindërve janë domosdoshmëri për çdo person që i ka ata në jetë. E kur ata të ndërrojnë jetë, të bëjmë dua – lutje bamirësie që Allahu (xh. sh.), t’i mëshirojë. Feja jonë e bukur nuk ka lejuar asnjëherë kërcënimin e raporteve prind – fëmijë. Ata duhet t’i respektojmë në çdo cep të jetës, përveç rastit ku na ka ndaluar Allahu (xh.sh.): **“nëse ata të dy përpiqen të shtyjnë ty të më përshkruash Mua shok (zot tjetër) për çka ti nuk di asgjë, atëherë ti mos i respekto ata”**.⁷ Dhe më në fund, pas çdo respekti që u bëjmë prindërve, duhet bërë lutje bamirësie për ta, kur ata të jenë gjallë apo kur të ndërrojnë jetë. Të përkujtojmë se ata dhanë një mund të madh për ne, kur ne ishim të paaftë për asgjë, kur ne qanim ata ishin pranë nesh, na bartën në kraharor dhe na ofruan çdo mundësi që të na bëjnë të lumtur.

Të gjitha modelet e tjera familjare, që dalin jashtë kornizave dhe urdhrave kuranore, do të përballen me probleme të llojeve të ndryshme. Modeli familjar i shfaqur nëpër televizione, nuk mund të jetë model i myslimanëve. E huaja le të mbetet gjithmonë e huaj dhe asnjëherë të mos bëhet pronë e jona. Skenat familjare, që shfaqen në ato programe, nuk janë asgjë tjetër vetëm se një tradhti bashkëshortësh, një degjenerim familjesh dhe një luftë kundër çdo bashkësie familjare. Prandaj, nuk mendojmë se programe të tilla sjellin ndonjë të mirë për ne si myslimanë.

6. Isrâ, 23.

7. Ankebût, 8.



M. Sami Ramazanoglu



MOSANIMI NGA TIRANËT

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Dhe mos anoni nga ata që bëjnë të këqija, përndryshe do t’ju përcëllojë Zjarri. Ju nuk do të keni mbrojtës tjetër përveç Allahut dhe nuk do të ndihmoheni.” (Hud, 113)

Sipas Fahri Razit, Hazinit dhe Kazit, shprehja (*ue la terkenu ila*), nënkupton dashurinë në zemër duke anuar sadopak ose duke i pranuar padrejtësitë e tyre. Duke u nisur nga kjo, kuptimi i ajetit është:

“Nëse i doni me zemër tiranët dhe i pranoni punët e tyre mizore, do t’ju djegë zjarri i xhehenemit. Pra, mos ushqeni dashuri për ta, që të mos ju djegë zjarri. Nëse ju djeg, jo vetëm që nuk do të keni mik tjetër përveç Allahut që t’ju shpëtojë, por nuk mund të kërkoni ndihmë nga askush tjetër.” Ose: “Mos u bëni servilë të tyre dhe mos iu bindni urdhrave të tyre mizore.”

Tirania është e ndaluar/haram në të gjitha fetë. Tirania është e kundërta e drejtësisë, e cila është e pranuar në botëkuptimin njerëzor dhe i shërben rregullit të kësaj bote. Për shkak se aty ku gjendet tirania, ka shkatërrim të botës dhe popujve, ajo jo vetëm që refuzohet, por Allahu i Madhëruar ka ndaluar edhe animin nga ajo.

Hadithet fisnike:

Në Sunenin e Ebu Daudit shënohet një hadith i transmetuar nga Sehl ibn-i Muadh (r.a.), i cili thotë se Rasulullahu (a.s.), ka urdhëruar:

“Kush e mbron një besimtar nga dyfytirëshi, në Ditën e Kiametit, Allahu i Madhëruar do të dërgojë

një melek që ta ruajë trupin e atij besimtari nga zjarri i Xhehenemit.”

Në Kitab-i Teuhid, transmetohet nga Ibn-i Abbasi (r.a.), se Rasulullahu (a.s.), ka treguar këtë hadith kudi:

Allahu i Madhëruar ka urdhëruar: *“Për nder të Madhështisë dhe Lavdisë Sime, Unë patjetër do ta marr hakun e të shtypurit nga tiranët.”*

Në disa hadithe të tjera, Rasulullahu (a.s.), ka thënë:

“Kush ecën (përkrah) me tiranët, me të vërtetë që ka bërë gjynah. Allahu i Madhëruar ka thënë se «Unë i Madhëruari jam hakmarrës ndaj mizorëve.»”

“Kush shkon me tiranin, duke e ditur mirë se ai është tiran, padyshim që ka dalë nga Islami.” (Ramuz)

“Besimtari është vëlla i besimtarit dhe nuk i bën padrejtësi atij. Kush ia lehtëson një vështirësi vëllait të tij besimtar, edhe Allahu i Madhëruar do t’ia lehtësoj atij një vështirësi.”

“Kush ia largon një vështirësi vëllait mysliman, Allahu do t’i largojë atij një nga vështirësitë e Ditës së Kiametit. Po ashtu, kush e gëzon një mysliman, gëzon edhe Allahun Teala.” (Buhari-Muslim)

“Për sa kohë që besimtari është në ndihmë të vëllait të tij, edhe Allahu i madhëruar do të jetë në ndihmë të tij.” (Muslim)

TË QËNDROSH NË KËMBË

çfarëdo që të ndodhë

Bynjamin Sagman

Duke parë se në ç'pikë jemi, atëherë mund të themi se vetëm një arsye ekziston që myslimanët, të cilët kanë mbetur në këmbë duke mos u demoralizuar dhe duke mos u shtypur me gjithë represionin e madh ndaj tyre, duhet të marrin në konsideratë, ajo arsye është metoda e Profetit (a.s.)

Po t'u hedhim një sy betejave që janë zhvilluar në emër të monoteizmit gjatë historisë njerëzore, do të shihet se myslimanët kanë përfjetuar në çdo periudhë lloje të ndryshme problemesh dhe shqetësimesh. Përpara këtyre myslimanëve që përpqeshin dhe luftonin të përhapnin monoteizmin në vendet dhe rrethet brenda të cilave ata jetonin, u dëlnin përherë politeistët. Kjo situatë si në të kaluarën, ashtu edhe sot është e njëjta. E vetmja gjë që ndryshon është koha, sepse misioni për të cilin janë përgjegjës njerëzit është i njëjtë. Faraonët, Belam-ët, Ebu Xhehl-ët, Ebu Leheb-ët e çdo shekulli janë në krye të punës.

Le të marrim për shembull periudhën e profetit Muhamed (a.s.), në të cilën politeistët luanin llojlloj makinacionesh dhe në të cilën u shtuan shumë veprimtaritë tronditëse dhe shtypjet fizike ndaj myslimanëve. Menjëherë pasi u bënë myslimanë, sahabët ranë viktimë të torturave dhe shtypjeve psikologjike dhe situata e tyre ishte shumë e vështirë, pasi politeistët e shtonin çdo ditë e më tepër represionin ndaj tyre. Me të pranuar fenë islame, Ebu Bekri (r.a.), shkoi në Qabe dhe me zë të lartë i njoftoi ata që gjendeshin aty se ishte bërë mysliman. Të pranishmit, me të dëgjuar këtë gjë, filluan të sulmonin myslimanët. Po kështu, Habab bin Heret u bë theror i politikës së shtypjes, duke u hedhur në zjarr i gjallë. Shenjat e djegies në shpinën e Hababit, të cilin myslimanët u përpoqën të shërojnë, mbeti si simboli i monoteizmit në trupin e tij. Familja e Amarit, që qenë shehidët e parë në atë periudhë, Bilal-ët, Musab-ët, Ebu Dherr-ët... ndoshta gjaku i tyre që u derdh formoi tullat e para të ndërtesës islame. Mbi gjakun e tyre do të ndërtohej sistemi i drejtësisë që kërkonte Allahu...

Ne mund të japim edhe shembuj të tjerë, vetëm se e gjithë kjo situatë ka edhe aspekte të tjera, që janë po kaq të rëndësishme, sa janë dhunimet fizike dhe torturat. Paria politeiste e Kurejshëve, nga një anë përdorte dhunën ndaj myslimanëve të dobët dhe pa përkrahje, nga ana tjetër i bënin profetit Muhammed (a.s.), "propozime djallëzore". Ata i propozuan të bëhej kryetari i Kurejshëve, por i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk do ta pranonte këtë gjë. Po sikur ta pranonte këtë propozim, çfarë do të ndryshonte? A nuk ishte ky një avantazh për të? Ai do të bëhej lideri i tyre. Nga kjo pozitë ndoshta mund ta përhapte fenë islame edhe më lehtë. Ndoshta dhuna që zbatohet kundër myslimanëve do të merrte fund. Gjërat nuk ishin ashtu siç dukeshin. Në qoftë se Profeti (a.s.), do ta pranonte këtë propozim, ai nuk do të mund

t'u bënte ballë atyre me një qëndrim të vendosur dhe do ta braktiste lirinë prej myslimani. Së pari, në qoftë se ai do të bëhej prijësi i Kurejshëve, në këtë mënyrë do të lejonte edhe Kurejshët të ndërhynin në mënyrën e tij të luftës për tevhid. E dyta, Profeti i Allahut e dinte shumë mirë këtë gjë, prandaj e pati kthyer mbrapsht në mënyrë të prerë këtë propozim. Ai e dinte shumë mirë se lëshimi i parë që do të bënte, do t'u hapte rrugën edhe shumë lëshimeve të tjera që do të pasonin.

Kjo ngjarje na mëson se beteja e tevhidit nuk do të realizohet vetëm në kuptimin fizik dhe se koncepti i lirisë nuk do të mbetet i kufizuar vetëm me të. Nuk ka nevojë të kapesh për fyti me dikë në emër të lirisë, për të jetuar si mysliman. Në qoftë se mund të përdoret, atëherë kjo liri ekziston vetvetiu në çdo kohë dhe në çdo vend. Po të flasim tani për ditët tona, do të shohim se deri vonë nëpër vende të ndryshme është zbatuar dhuna ndaj myslimanëve. Në disa periudha, shtypja pati mbërritur deri në kulmin e saj, duke bërë që shumë myslimanë të bëhen pasivë. Po të shohim me kujdes, ngjarjet janë të njëjtat, e vetmja gjë që ndryshon është vetëm qëndrimi që mbajnë myslimanët. Shtypja e kohëve të fundit disa myslimanë i lëkund, ndërsa të tjerët i nxori jashtë fushës së lojës. Disa prej tyre u ngritën në këmbë, drejtuan trupin dhe nisën sërish të hedhin hapa të sigurt. Ata kuptuan se punët mund të zgjidheshin me edukim dhe dije dhe jo me mbajtje qëndrimesh politike, as me të bërtitura nëpër mitingje ose ndonjë rrugë tjetër të ngjashme me to. Nuk janë të paktë as myslimanët, që ende nuk kanë arritur ta shohin këtë imtësi...

Duke parë se në ç'pikë jemi, atëherë mund të themi se vetëm një arsye ekziston që myslimanët, të cilët kanë mbetur në këmbë duke mos u demoralizuar dhe duke mos u shtypur me gjithë represionin e madh ndaj tyre, duhet të marrin në konsideratë, ajo arsye është metoda e Profetit (a.s.), që do të thotë se myslimanët duhet të arrijnë të bëhen realistë, të mesëm dhe kurr nuk duhet të ndjekin pas ekstremet, thënë kjo me fjalët e Kuranit, myslimanët duhet të bëhen një ymet vasat (i mesëm)...

Do të shpëtojnë ata që dalin ballëhapur nga çdo lloj shtypjeje, Jusuf-ët që e shndërrojnë burgun në medrese, Bilal-ët që thërrasin me të madhe tevhidin edhe kur u është vendosur shkëmbi mbi ta, Ibrahim-ët që thonë edhe kur janë në zjarr: "Mua më mjafton vetëm Zoti!"

"Thuaju (o Muhamed):

*Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua,
që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet!"*

(Al' Imran, 31)

Ky ajet zbriti atëherë kur jahudijtë u shprehën "Ne jemi djemtë dhe të dashurit e Allahut", kur të krishterët thanë "Ne e adhurojmë Isain nga dashuria që kemi për Allahun" dhe kur mushrikët thanë "Ne adhurojmë idhujt për hatër të dashurisë që kemi për Zotin si dhe për hatër të besimit që kemi se ato do të na afrojnë kah Ai". Allahu i Lartmadhëruar i urdhëroi që t'u bindeshin Resulullahut, nëse janë të sinqertë në fjalët e tyre. T'i bindesh Resulullahut do të thotë të zbatosh ato që ai urdhëron, të largohesh nga ato gjëra që ai t'i ndalon dhe ta marrësh atë si shembull në çdo çështje. E kundërta e kësaj, që unë e dua Allahun, por nuk ia vë veshin urdhëresave të Tij, që nuk i dua ata që Ai do dhe ata që e duan, pra të Dërguarit e Tij, kjo do të thotë se nuk dëshiron t'i përngjasosh atyre dhe se nuk do askënd tjetër përveç vetes, e si përfundim do të thotë se nuk dëshiron të ecësh në rrugën e tevhidit.

Kur u shpall ky ajet, hipokriti Abdullah ibni Ubej tha:

"Muhamedi po pretendon se bindja dhe adhurimi ndaj tij është bindje dhe adhurim ndaj Zotit. Ai po kërkon që ta duam atë ashtu si të krishterët Isain."

Më pas, në lidhje me këtë u shpall ky ajet:

"Thuaju (o Muhamed): Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet!" (Al' Imran, 31)

Me këtë ajet Allahu i Lartmadhëruar na informoi se masa më e saktë e adhurimit dhe e bindjes ndaj Tij është i Dërguari i Tij. Sepse ata që njohin më së miri urdhëresat dhe ndalesat e Tij dhe që i zbatojnë ato më mirë, janë Pejgamberët. Ata e praktikuan pa asnjë mangësi rrugën e drejtë. Ata na e treguan në mënyrë të shkëlqyer se feja është rruga e të mesmes dhe e veprimit të matur. Pejgamberi i fundit e projektoi rrugën e ndritur të Islamit, vlefshmëria e të cilit do të zgjasë deri në Kiamet, duke e zbatuar atë në çdo sferë të jetës së tij. Ky stil jetese i përvijuar nga Resuli (a.s.) në planin individual dhe në atë shoqëror, fjalët, veprimet e tij, miratimet apo kundërshtimet që ai ka shprehur ndaj veprimeve të të tjerëve, janë emërtuar me termin sunnet. Prandaj, **të ruash Sunetin dhe çdo gjë që ka ardhur me të, do të thotë të ruash islam.**

Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.),

se Pejgamberi -*salall-llahu alejhi ve selem*-, ka thënë:

"I gjithë ummeti im ka për të hyrë në Xhenet, përveç atyre që nuk dëshirojnë."

Ai u pyet: -O i Dërguari i Allahut, po kush nuk dëshiron të hyjë në Xhenet?

Më i Dashuri i Allahut u shpreh: -*"Ata që do të më binden mua do të hyjnë në Xhenet, kurse ata që më kundërvihen do të thotë që nuk e dëshirojnë Xhenetin."*

Dy fjalë komenti

Ata që nuk dëshirojnë të hyjnë në xhenet mund të përmbliohen në dy grupe, ose mund të kuptohen në dy mënyra. Njëri grup përbëhet nga individë që nuk pranojnë ftesën e bërë nga **"ummeti davet"** (ummeti thirrës), pra refuzojnë ftesën që iu është bërë për të hyrë në islam dhe që emërtohen kafir. Kurse grupi i dytë, që emërtohet **"ummeti ixhabet"**, përbëhet nga individë që e kanë pranuar islamin. Këta janë njerëzit që duhet të jenë shembull në shoqëri. Në mesin e këtyre të fundit gjenden edhe ato që nuk kanë jetuar në përshtatje me mesazhin e Profetit dhe që nuk i kanë kryer obligimet fetare, dhe këta emërtohen si rebelë ose gjynahqarë.

Kafirët nuk do të hyjnë në xhenet. Kurse rebelët, pasi të vuajnë dënimin e gjynaheve të tyre në xhehenem, do të hyjnë në xhenet, ku do të qëndrojnë përjetësisht. Kjo do të thotë se gjynahi

nuk ta zhduk imanin, por mundet ta shpie-
rë njeriun në xhehenem. Por qëndrimi i
këtyre të fundit në xhehenem nuk do të
jetë i përhershëm si ai i kafirëve.

Sahabët u çuditën dhe deshën të më-
sonin nga Resulullahi se kush ishin ata
që nuk dëshirojnë të hyjnë në xhenet.
Resulullahu, (a.s.), u dha atyre një përgji-
gje të shkurtër, por shumë kuptimplotë.
Sipas përgjigjes së tij, ai që do t'i bindet
Pejgamberit do të hyjë në xhenet, kurse
ai që s'do të shprehë bindje ndaj Tij, do të
hyjë në xhehenem. Bindja ndaj Profetit
përfshin lidhjen e fortë me Kuranin dhe
Sunnetin, lidhje kjo që do ta shpjerë be-
simtarin në xhenet. Ndërsa kundërvënia
ndaj Profetit tregon mospranim të plotë
të Islamit dhe atëherë ky person bie në
kufër dhe hyn përgjithmon në xhehenem,
ndërsa kur personi e ka besuar në më-
nyrë të plotë islamin por e ka neglizhuar
praktikimin e tij, kjo e dërgon atë në xhe-
henem për të shlyer gjynahet e tij e për
të hyrë mandej në xhenet.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Bindja ndaj Resulullahut, (a.s.), të shpije në xhenet.

2. Rebelimi ndaj Pejgamberit, (a.s.), nëse shpreh mospranim të plotë të islamit, të shpie në xhehenem përjetësisht; nëse shpreh vetëm moszbatim të plotë të tij, atëherë kjo të shpie në xhehenem, por qëndrimi atje nuk do të jetë i përhershëm.



IMAM RABBANI

I nderuari Imam Rabbani thotë:

“Qëllimi i krijimit të njeriut është të kryejë adhurimet me të cilat është urdhëruar. Me adhurim nënkuptojmë arritjen e «njohjes së vërtetë», e cila është edhe e vërteta e besimit.” (Imam Rabbani, Mektubat, I, 369, nr: 97.)

[Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik, urdhëron:

“Xhindët dhe njerëzit nuk i kam krijuar për tjetër gjë, përveçse të më adhurojnë Mua.” (Dharijat, 56)

Ibn Abbasi (r.a.), shprehjen **“të më adhurojnë Mua”**, e ka komentuar si “të më njohin Mua”.

Për shembull, sexhdja, e cila në kushtet e kësaj bote është vendi ku robi është më afër Zotit, për një person që e sheh nga jashtë mund të duket vetëm si një lëvizje formale. Mirëpo, kuptimi që bart ajo është vendosja e ballit të besimtarit në tokë përpara Allahut, duke e pranuar me bindje dobësinë e vet në prani të Tij. Duke iu nënshtruar Atij dhe duke thënë me gjuhën e trupit: “Ti je Zoti im, unë jam robi Yt; Ti je Krijuesi im, unë jam krijesa Jote!”, ai deklaron se e njeh Zotin me gjithë shpirt.

Sahabët e Pejgamberit tonë (a.s.), zakonisht i ngrinin sytë nga qielli gjatë namazit, derisa u zbrit ajeti: **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlurur në namazin e tyre.”** (Mu’minun, 1-2) Pas zbritjes së këtij ajeti, sahabët fisnikë filluan t’i ulnin kokat e tyre (me përkushtim).¹ Kjo, sepse duke u thelluar në të

vërtetën e adhurimit të namazit, ata ndjenë dobësinë e tyre përballë fuqisë dhe madhësisë hyjnore dhe arritën të mësojnë të jenë robër të përlurur të Allahut.

Ky është qëllimi i adhurimit dhe devotshmërisë; arritja e njohjes së Allahut në sajë të këtyre ndjenjave; njohja e Allahut me zemër. Në këtë mënyrë, arrihet edhe besimi i vërtetë, pra besimi i kulluar dhe i pastruar prej dyshimeve dhe mëdyshjeve. Për rrjedhojë edhe zemrat tona do të vetëdijësohen ndaj faktit se në çdo moment gjendemi nën vëzhgimin e kamerave hyjnore.

Për një besimtar të vetëdijshëm dhe të urtë, në jetën

e tij nuk ka asnjë qëllim më të madh dhe asnjë gradë më të lartë se sa devotshmëria ndaj Allahut. Pejgamberit tonë (a.s.), iu dha e drejta e zgjedhjes për të qenë një “pejgamber sundimtar” apo thjesht një “pejgamber rob i Allahut” dhe ai zgjodhi të ishte thjesht një “pejgamber rob i Allahut”.² Me anë të kësaj zgjedhjeje ai ka treguar se lumturia dhe sundimi që të jep robëria

ndaj Allahut, është aq e lartë, aq e vlefshme dhe aq afatgjatë, saqë nuk mund të krahasohet me rehatinë dhe kënaqësinë që të jep sundimi në këtë botë.

Në fakt, edhe sikur e gjithë bota t’i jepej një njeriu të vetëm dhe ai të jetonte aty njëmijë vjet, nuk do të kishite asnjë dobi për të. Në fund të fundit, vendi ku do të shkojë ai, a nuk është një gropë e ngushtë në tokë? Mbi të gjitha, jeta e kësaj bote në krahasim me pafundësinë e botës tjetër, është veçse sa një pikë ujë nga oqeani.



1. -shih. Taberi, Tefsir, XIX, 8; Sujuti, Lubabu’n-Nukul, fq. 165.

2. -shih. Abdurrazzak, Musannef, III, 183; Hejthemi, IX, 192.



Nëse pyetjes “Çfarë është jeta?”, do t’i përgjigjeshim; “vetëm lagështira e tokës dhe ngurtësia e gurëve të varrit”, atëherë, çfarë do të ishte më e hidhur se humbja e një jete të shkurtër në një shkujdesje të tillë?..

Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t’u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes.” (Naziat, 46)

Për rrjedhojë, nuk mund të ketë një jetë më të mirë, sesa kur përpiqesh ta bësh jetën e shkurtër të kësaj bote kapitalin e lumturisë së botës tjetër. Dhe mënyra e kësaj, është të jemi gjithmonë në rrugën e devotshmërisë ndaj Allahut, me të cilën jemi urdhëruar.

Në lidhje me këtë të vërtetë, njerëzit e urtë kanë këshilluar:

“Kjo botë, është sa një çast. Prandaj përpiqu që edhe këtë çast të shkurtër ta kalosh me adhurime!.. (Imam Gazali, Mukashefetu’l-Kulub, fq. 166.)

Ndërsa Abdullah Dehlevi ka thënë:

“Jeta e kësaj bote është veç një ditë dhe këtë ditë duhet ta agjërojmë.”³ Me këtë, ai ka dashur të theksojë se në këtë jetë të përkohshme duhet të jetojmë me devotshmëri, duke e ruajtur veten nga haramet dhe gjërat e dyshimta dhe të gjitha përpjekjet tona t’ia kushtojmë devotshmërisë ndaj Allahut.

Nga ana tjetër, çdo adhurim është një ushqim shpirtëror që -nëse bëhet ashtu siç duhet- e afron robin tek Allah, forcon besimin e tij dhe duke ia pastruar zemrën nga mëdyshjet dhe dyshimet, e çon atë drejt paqes së vërtetë.

Besimi, i ngjan një burimi drite. Erërat e egos dhe

3. - Rauf Ahmed, Durru’l-Mearif, fq. 143.

shejtanit fryjnë gjatë gjithë jetës sa herë që të munden për ta shuar këtë dritë. Ndërsa adhurimet janë si një fener që e ruan dritën e besimit nga erërat negative. Për rrjedhojë, nëse adhurimet kryhen me qëllim të pastër dhe në mënyrë të pranueshme, edhe drita e besimit në zemër do të jetë e fortë dhe e dritshme.

Inderuari Sami Efendi, pjekurinë e zemrës së besimtarëve, të cilët arrijnë një besim të palëkundshëm në sajë të begatisë së adhurimeve dhe bindjes, e ka shpjeguar me këtë ngjasim:

“Besimtari që ndodhet në rrugën e drejtë, duhet të jetë i qëndrueshëm si një mal, sepse mali ka katër cilësi:

- 1) Nuk shkrihet nga nxehtësia,
- 2) Nuk ngrin nga të ftohtët,
- 3) Nuk rrëzohet nga erërat,
- 4) Nuk përmytet nga vërshimet e ujrave.”⁴

Pra, ai e ruan forcën e besimit pavarësisht nga kushtet negative.

Inderuari Imam Rabbani thotë:

“Në dashuri nuk ka vend për hile, sepse kush dashuron, ia ka dhënë zemrën të dashurit dhe nuk e kundërshton atë. Ai nuk anon kurrë nga kundërshtarët e të dashurit dhe nuk u jep asnjë mundësi atyre.”⁵

Besimi në Allahun është një dashuri e thellë shpirtërore. Ndërsa dashuria, është vepra e zemrës. Çdo organ ka vullnet, por zemra nuk ka. Asgjë nuk mund ta detyrojë atë të dashurojë dikë dhe po ashtu, askush nuk mund ta detyrojë të urrejë diçka.

Për rrjedhojë, besimtari i vërtetë, zemrën që është edhe vendi i besimit, e ruan nga gjërat që nuk i pëlqejnë Allahut të Madhëruar dhe nuk anon nga ato. Kjo, sepse

4. - M. Sami Efendi, Tefsiri i sureve Junus dhe Hud, fq. 145.

5. - Imam Rabbani, Mektubat, I, 514, nr. 165.

Jeta e kësaj bote
në krahasim me
pafundësinë e botës
tjetër, është veçse sa një
pikë ujë nga oqeani.
Nëse pyetjes “Çfarë
është jeta?”, do t’i
përgjigjeshim; “vetëm
lagështira e tokës dhe
ngurtësia e gurëve të
varrit”, atëherë, çfarë
do të ishte më e hidhur
se humbja e një jete
të shkurtër në një
shkujdesje të tillë?..

të thuash se e do Allahun dhe të anosh nga ato që nuk i pëlqen Ai, nuk përputhet me besimin e vërtetë.

Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë:

*"Njeriu është së bashku me atë që do."*⁶ Nisur nga kjo, ne duhet të mendojmë e të pyesim veten se sa është zemra jonë me Allahun. Sa është me Rasulallahun (a.s.)? Sa është me ata që i do Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.)? Përkundër kësaj, sa është zemra jonë së bashku me dëshirat e egos? Sa anon ajo nga armiqtë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), tundimet e gjynaheve dhe kurthet e shejtanit?

Në një dashuri të vërtetë, i dashuruari dashuron edhe të dashurit e të dashurit të tij dhe i urren ata që nuk i do ai. Kush e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.), i do edhe virtytet e bukura, si bujarinë, mirësjelljen, turpin, butësinë, mëshirën dhe faljen. Po ashtu, ai i urren edhe cilësitë e këqija, si paturpësinë, të keqen, korracinë, padrejtësinë dhe tiraninë. Kjo, sepse një dashuri e vërtetë, buron nga bashkimi i atij që dashuron me atë që dashurohet. Në një dashuri të vërtetë, veçoritë e atij që dashurohet, kalojnë edhe tek ai që dashuron. Madje, dashuria shtohet edhe më tepër, kur ai që dashurohet i sheh veçoritë e veta tek ai që dashuron.

Për shembull, morali shembullor i Pejgamberit tonë (a.s.), është shfaqur në nivelin më të lartë tek Ebu Bekri (r.a.). Kjo, sepse sahabiu që e deshi më shumë Pejgamberin tonë (a.s.), ishte Ebu Bekri (r.a.). Kur shohim jetën e Ebu Bekrit (r.a.), shohim moralin e të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Pra, nuk mjafton të thuash: "Unë e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij." Nëse i duam, atëherë sa është mëshira dhe butësia jonë; në ç'nivel është morali ynë? Sa prej cilësive të Pejgamberit tonë (a.s.), gjenden tek ne? A mund të shpëtojmë prej egoizmit? A kemi shpirt altruist, i cili shqetësohet për hallet e umetit? A pasqyrohet dashuria jonë në gjendjen dhe veprat tona? Apo mos dashuria jonë është thjesht një pretendim i thatë që mbetet veç në fjalë?

Po ashtu, nuk mjafton të thuash: "Unë e dua Kuranin". Sa pasqyrohet morali i Kuranit tek ne? Sa veprojme me ligjet e Kuranit? Sa ua mësojmë fëmijëve tanë Kuranin, kulturën dhe moralin e tij? Sa e mendojmë faktin se në

Ditën e Kiametit Kurani do të jetë ndërmjetësues për ne ose në të kundërtën -për shkak të neglizhimit- do të ankohet ndaj nesh? Ja pra, këto lloj pyetjesh duhet t'ia bëjmë vazhdimisht vetes sonë...

Peshorja e një dashurie të vërtetë, është sakrifica. Fjalët e thata që nuk vërtetohen me sakrifica, nuk shprehin asnjë kuptim. I nderuari Mevlana i këshillon me këtë shprehje njerëzit e shkujdesur që pretendojnë dashuri dhe qëndrojnë shumë larg realitetit të saj:

"Mos u bëni palaço të fjalëve!"

Njeriu, edhe nëse largohet pak prej vendlindjes së tij, fillon ta ndjejë menjëherë mallin për ajrin, ujin dhe tokën e saj. Madje, edhe nëse vendlindja e tij është shkretëtirë, ai ndjen mall për të, sepse zemra e tij është e lidhur me çdo veçori të vendlindjes së tij. Kjo pra është dashuria e vërtetë.

Përsëri, i nderuari Mevlana, në veprën e tij të famshme "Mesnevi", na tregon një ndodhi:

Mexhnuni, i cili bridhte nëpër shkretëtira për shkak të dashurisë ndaj Lejlës, po ledhatonte me mëshirë dhe puthte nga sytë një qen të jargavitur dhe me qime të rëna. Ata që e shihnin e qortonin Mexhnunin për shkak të kësaj dashurie të madhe që tregonte ndaj qenit. Mirëpo, ai thoshte:

"Nëse do ta shihnit me syrin tim, do ta kuptonit pse unë silllem kështu me të. Ai është qeni i fshatit të Lejlës. Mes gjithë këtyre fshatrave, ai zgjodhi fshatin e Lejlës për të jetuar dhe për të bërë roje. E si të mos e dua atë!.."

Shkurtimisht, çdo cilësi që e pëlqen Allahu dhe i Dërguari i Tij, duhet të pasqyrohet edhe në moralin dhe sjelljet tona. Për këtë arsye edhe të dashurit e Allahut kanë ndjerë një ëmbëlsi shpirtërore të papërshekrueshme në zbatimin e Kuranit dhe Sunetit në çdo çështje të jetës, si ngrënia, pirja, qëndrimi, etj.

Nga ana tjetër, për shkak se dashuria e vërtetë kërkon që të duhen ata që do edhe i dashuri dhe të mos duhen ata që nuk i do i dashuri, atëherë, nëse e duam Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.), dashurinë dhe urrejtjen për hir të Allahut duhet ta kthejmë në cilësinë kryesore të karakterit dhe personalitetit tonë. Pra, duhet t'i duam ata që e meritojnë dhe t'i urrejmë armiqtë e Allahut, të Pejgamberit, të Islamit dhe myslimanëve.

Një nga shembujt më të gjallë të këtij fakti, është

Nuk mjafton të thuash:
"Unë e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij" Nëse i duam, atëherë sa është mëshira dhe butësia jonë; në ç'nivel është morali ynë? Sa prej cilësive të Pejgamberit tonë (a.s.), gjenden tek ne? A mund të shpëtojmë prej egoizmit? A kemi shpirt altruist, i cili shqetësohet për hallet e umetit? A pasqyrohet dashuria jonë në gjendjen dhe veprat tona? Apo mos dashuria jonë është thjesht një pretendim i thatë që mbetet veç në fjalë?

6. - Buhari, Edeb, 96.

edhe mallkimi nga ana e Allahut të Madhëruar në suren Tebbet, i Ebu Xhehlit, për shkak të ashpërsisë dhe këmbënguljes së tij në mohim, megjithëse ai ishte edhe xhaxhai i Pejgamberit tonë (a.s.).

Për rrjedhojë, ne duhet ta ruajmë veten nga lavdërimi i armiqve të Allahut dhe të Pejgamberit (a.s.), madje edhe nga shikimi më i vogël në formë admirimi. Kjo, sepse këto shikime e shtojnë rëndësinë e tyre dhe bëhen shkak i dënimit të Allahut.

Në lidhje me qëndrimin që duhet treguar në shfaqjen e urrejtjes për hir të Allahut, po japim si shembull këtë hadith fisnik:

"Dyfytyrëshit mos i thoni «zotëri». Nëse e pranoni atë për zotëri, do të bëheni shkak i dënimit të Zotit tuaj, i Cili është Aziz dhe Xhelil." (Ebu Daud, Edeb, 83; Ahmed bin Hanbel, V, 346.)

I nderuari Imam Rabbani, thotë:

"Vëllai im! Nëse nuk tregohet dobësi në dy çështje, atëherë s'ka asnjë problem. E para; në ndjekjen e hapave të Pejgamberit tonë (a.s.), i cili erdhi me shariat (ligjin e Allahut) dhe e dyta, në sinqeritetin dhe dashurinë ndaj atij që të mëson rrugën e drejtë (udhëzimin). Sa të jenë këto të dyja, nuk ka asnjë problem, edhe sikur të bien mijëra errësira. Mirëpo, -Allahu na ruajttë- nëse shfaqet ndonjë mangësi në këto të dyja, njeriu do humbasë e do shkatërrohet, edhe nëse bën vazhdimisht dhikir, sepse dhikri i tij është thjesht një "istidraxh"⁷ dhe fundi i tij është shumë i hidhur. Prandaj, duhet t'i lutemi e përgjërohemi me gjithë shpirt Allahut të Madhëruar dhe të kërkojmë prej Tij të na bëjë të qëndrueshëm në këto dy çështje, sepse këto janë çështjet më të rëndësishme dhe kapitali kryesor për arritjen e shpëtimit.⁸

[Besimtari duhet të përpiket të ecë në gjurmët e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe trashëgimtarëve të tij, që janë dijetarët dhe njerëzit e urtë. Nëse vepron kështu, ai do të kalojë i sigurt edhe në rrugët më të errëta, duke arritur derën e lumturisë së përrjeshme. Në të kundërtën, një njeri pa udhëzues, është si një anije me timon të thyer, e cila shkon në çdo anë që e çon era, por kurrë nuk e gjen dot rrugën që të çon në vendin e dëshiruar. Mbi të gjitha, ai nuk mund t'i shpëtojë as shkatërrimit në ndonjë vorbull të panjohur.

7. - **Istidraxh:** Është gjendja e njerëzve të devijuar, të cilëve Allahu i Madhëruar u fal mirësi të shumta, me qëllim që ata të kujtojnë se janë në rrugë të mirë dhe t'i shtojnë edhe më tepër gjynahet e veta. Përveç kësaj, istidraxhi mund të shfaqet edhe në formë të ngjashme me mrekullitë, që i bëjnë mohuesit, gjynahqarët e mëdhenj dhe disa persona që pretendojnë se gjoja janë evlija. Kjo gjë e rrit së tepërmi egon dhe jo vetëm që nuk të afron tek Allahu, por të largon edhe më tepër nga Ai.

8. - Imam Rabbani, Mektubat, II, 551, nr: 30.

Nisur nga kjo, besimtari asnjëherë nuk duhet ta konsiderojë veten se është në rregull me gjithçka. Ai gjithmonë duhet ta shohë gjendjen e tij në pasqyrën e rrugës së drejtë dhe të përpiket të korrigojë gabimet e tij. Ndërsa pasqyra e rrugës së drejtë, ku duhet të shihet e të korrigojë vetveten, është Pejgamberi ynë (a.s.), i cili ishte një Kuran i gjallë dhe dijetarët që i udhëzojnë njerëzit në rrugën e drejtë dhe të cilët nuk ndahen asnjë grimcë nga rruga e ndritur e Pejgamberit (a.s.).

Ashtu siç nuk mund ta kurojë dot veten i sëmuri duke lexuar librat e mjekësisë, ashtu edhe njeriu nuk mund ta nënshtrojë egon e tij dhe nuk mund të shpëtojë prej sëmundjeve të egos, si mendjemadhësia, krekosja dhe pëlqimi i vetes, vetëm duke lexuar rreshtat e librave. Madje, kur sëmuren, edhe vetë doktorët shkojnë tek një doktor tjetër për t'u kuruar. Po ashtu, asnjë gjykatës nuk mund të gjykojë një çështje që ka lidhje me vet atë, por duhet të dalë përpara një gjykatësi tjetër.

Nisur nga kjo, për të arritur pjekurinë shpirtërore, është e domosdoshme të marrësh dituri dhe udhëzime nga njerëz të ditur e të devotshëm. Rëndësinë e kësaj çështjeje, i nderuari Mevlana e shpreh me këto fjalë:

"Si mund ta gdhendë një thikë bishtin e saj, pa ndihmën e një thike tjetër? Shko dhe tregojta plagët e tua një kirurgu të shpirtit, sepse ti nuk mund ta kurosh vetveten..."

"Shëndetin e ndjenjave dhe mendimeve të kësaj bote mësoji nga doktori. Ndërsa shëndetin e ndjenjave të larta që e ngrenë njeriun në pafundësi, mësoji nga një dijetar i devotshëm."

Duke u bazuar në hadithin e Pejgamberit tonë (a.s.): *"Besimtari, është pasqyra e besimtarit."*⁹, mund të themi se dijetarët e devotshëm janë një pasqyrë shumë e pastër për ne dhe shpirti ynë e sheh thelbin e vetes dhe ekzistencës në këtë pasqyrë të shndritshme. Ata që janë të privuar nga një pasqyrë e tillë, jo vetëm që nuk i kuptojnë gabimet e veta, por nuk arrijnë as të zgjohen nga injoranca që i bën ta pandehin mjerimin lumturi.

Nga ana tjetër, në ditët tona, disa të paditur që kanë rënë në një greminë të tillë injorance, duke i përcjmar fjalët dhe sunetin e Pejgamberit tonë (a.s.), po tregojnë dobësi të mëdha në lidhje me sproven e besnikërisë, respektit dhe dorëzimit ndaj tij. Gjithashtu, këta njerëz të ulët flasin keq edhe për të dashurit e Allahut, të cilët ecin në gjurmët e Pejgamberit (a.s.). Padyshim se kjo gjendje është një verbëri e thellë shpirtërore. Sjellja e keqe ndaj të dashurve të Allahut, është një nga arsytet

9. - Buhari, Edebu'l-Mufred, nr. 238; Ebu Daud, Edeb, 49/4918.

që e shkaktojnë më së shumti zemërimin hyjnor.

Allahu i Madhëruar u shpall luftë atyre që i veprojnë këto dy gjynahe:

E para është kamata, në lidhje me të cilën në Kuran thuhet:

"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe hiqni dorë nga kamata, nëse jeni besimtarë të vërtetë. Nëse nuk e bëni këtë, atëherë ju është shpallur luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij..." (Bekare, 278-279)

Ndërsa e dyta, është lëndimi i robërve të dashur të Allahut, në çfarëdo lloj forme qoftë. Në lidhje me këtë, në një hadith fisnik thuhet:

"Kush armiqësohet me një prej robërve të Mi të dashur, unë do t'i shpall luftë atij..." (Buhari, Rikak, 38.)

Nuk duhet harruar se gjatë gjithë historisë nuk ekziston asnjë genie që të ketë luftuar me Allahun dhe të ketë fituar. Nisur nga kjo, shfaqja e sjelljeve të këqija ndaj robërve të dashur të Allahut, do të shkaktonte zemërimin hyjnor.

Imam Rabbani thotë:

"Pëlqimi i vetvetes dhe i punëve që bën, i djeg punët e mira, siç djeg zjarri drutë. Pëlqimi i vetvetes lind kur njeriu e mbivlerëson punën e tij. Për të shpëtuar prej kësaj, është e nevojshme që gjithmonë të kemi parasysh gabimet e të metat tona, ndërsa punët e mira t'i shohim të mangëta e të pamjaftueshme. Madje, njeriu duhet të turpërohet nëse punët e mira dhe bamirësitë që ai realizon bëhen publike..."¹⁰

Qëllimi i punëve të mira duhet të jetë vetëm kënaqësia e Allahut. Njeriu duhet të falënderojë Zotin, i Cili i ka dhënë mundësi të bëjë vepra të mira. Nëse ai fillon e lavdërohet për punët e mira që bën, egoja e tij ndjen krenari dhe e ndërron qëllimin e punës, gjë e cila e shkatërron edhe shpërblimin e saj. Kjo, sepse besimi në një Zot të vetëm nuk pranon ortakëri.

Në këtë aspekt, një besimtar duhet të ruhet nga vendosja e emrit të vet në ndonjë bamirësi që bën, si xhami, kurs Kurani, etj. Mirëpo, nëse të afërmit e tij e vendosin pasi ai të këtë ndërruar jetë, kjo nuk përbën ndonjë problem. Përkundrazi, bëhet shkak që ai të kujtohet me mëshirë në lutjet e njerëzve. Pra, vendosja e emrit kur ai është ende gjallë, nuk është e drejtë, sepse kjo do ta cenonte shumë sinqeritetin e tij.

Në fakt, kur njeriu bën një punë të mirë, -sado që të përpiqet- ai e ka shumë të vështirë ta kryejë atë të pastruar plotësisht nga të metat e dukshme dhe të pa-

dukshme. Prandaj, sado punë të mëdha të bëjë robi, ai nuk duhet ta mbivlerësojë punën e tij, por duke pranuar dobësinë e vet, duhet t'i lutet Allahut të Madhëruar që ta pranojë atë. Nuk duhet harruar asnjëherë se ashtu si lutjet/duatë, edhe punët e mira kanë nevojë për pranimin e Allahut.

Në sytë e besimtarëve të urtë, pjekuria shpirtërore, e cila tregohet në ofrimin e punëve të mira tek Allahu, është po aq e rëndësishme sa edhe vetë puna e mirë. Që një punë të jetë vetëm për hir të Allahut, në qëllimin e saj nuk duhet të përzihet dëshira për të marrë komplimente edhe nga të tjerët. Për këtë arsye, punët e mira duhet të bëhen larg syve të njerëzve me sa të jetë e mundur.

Siç njoftohemi edhe në një hadith fisnik, në Ditën e Kiametit, ku nuk do të ketë hije tjetër (përveç hijes së arshit të Allahut), Allahu i Madhëruar do të strehojë nën hijen e arshit madhështor shtatë kategori njerëzish, njëra prej të cilave është kategoria e njerëzve që japin sadaka në mënyrë aq të fshehtë, sa që dora e majtë nuk e di se çfarë jep e djathta.¹¹

Mirëpo, nëse jemi të detyruar ose bëhet fjalë për ndonjë dobi në nxitjen/frymëzimin e të tjerëve për të dhënë sadaka, lejohet që të jepet edhe haptas. Megjithatë edhe në këtë rast, zemra duhet ruajtur nga mburrja dhe mendjemadhësia, me qëllim që të mos na dëmtohet sinqeriteti i punës sonë.

Përveç këtyre, ne duhet të ruhem jo vetëm nga lavdërimet e të tjerëve, por edhe nga lavdërimet e vetvetes. Dhe ilaçi që mund ta bëjë egon tonë të heshtë në këto raste, është të mos harrohen kurrë të metat dhe gabimet e saj të fshehta. Përndryshe, egoja fillon të pëlqejë vetveten dhe në këtë mënyrë nuk mund t'i shpëtojme dot shkatërrimit.

Allahu i Madhëruar i bëftë qëllimet dhe veprat tona të përshtatshme me kënaqësinë e Tij. Allahu na ndihmoftë që të bëjmë sa më shumë punë të mira me të cilat Ai është i kënaqur, na faltë mirësi dhe moral të bukur. Allahu na udhëzoftë në rrugën e drejtë dhe na ruajtë të gjithëve prej fitneve në çështjet e fesë sonë, gjë e cila e shkatërron edhe jetën tonë të përtëjme.

Amin!..



10. - Kishmi, Berekat, fq. 217.

11. -shih. Buhari, Ezan 36, Rikak 24; Muslim, Zekat, 91.

Konturet e Islamit

Alli Byjyçapar

Askush nuk mund ta mohojë ndikimin që kemi nga kulturat e kohës që jetojmë. Që treqind vjet jetojmë një periudhë të koklavitur, ku nuk po arrijmë në asnjëfarë mënyre të mbërrimë të vërtetat që bartim në veten tonë.

Nëse nuk ekziston rruga, nuk ke ku të mbërrish!

Jetojmë në një pjesë gjeografike ngjitur me atë të kulturës evropiane dhe vazhdojmë jetën tonë duke krijuar marrëdhënie të ndryshme me ata popuj që gjenden aty. Nuk mund të thuhet se nuk e njohim traditën hebraike dhe atë të krishterë. Ashtu sikurse kemi pasur betejet e ndërsjella, kemi edhe marrëdhënien tonë kulturë-qytetërim, e cila vijon natyrshëm ende sot.

Nuk mund të themi se kemi qenë shumë të suksesshëm lidhur me deshifrimin e qytetërimit evropian nga aspekti intelektual. Që nga dështimi ynë në Vjenë dhe deri sot, sikur s'kemi arritur të mëkëmbemi. Gjithnjë patëm zbrapsje, gjithnjë. Gjithmonë mbetëm duke bërë autokritikë, ndërkohë që qytetërimi evropian mori trajta të ndryshme dhe vazhdoi rrugën e vet.

Përse Evropa është përpara?

Ne duhet ta deshifrojmë këtë mendësi, e cila ka shprehur aftësinë e përdorimit në mënyrë të frytshme të mundësive materiale.

Ne e përdorëm gabim parimin e formimit të fushave specifike të ndarjes në pjesë, të çështjes së disiplinës, të cilat krijohen në fazat e para të përparimit material. I ndamë, i copëtuam, i analizuam edhe detajet më të vogla, por nuk arritëm në asnjë mënyrë të kishim aftësinë e të shikuarit si e tërë.

E copëtuam jetën!

Arritëm në atë fazë, sa të mos mendonim se duheshin ruajtur veçoritë themelore që përbëjnë njeriun si model i njeriut të përsosur (kamil). Allahu krijoi fizikun e njeriut të parë nga dheu dhe uji, kurse për ta bërë të gjallë i dha shpirt.

Po mirë, vallë ç'dimë rreth shpirtit?

Të fshehtat që dalin nga përfundimet që kanë arritur nga studimet që janë bërë prej shekujsh mbi njohjen e shpirtit, bëjnë që njeriu të shqetësohet.

Përballë nesh qëndron qasja e tevhidit, e cila është ideja më e domosdoshme për ne sot. Kjo rrugë hyjnore, që na shpie drejt unitetit dhe bashkimit, është zgjidhja e problemeve.

Nuk mund të ketë injorancë më të thellë sesa të mos dish se kujt i përket ideja. Kemi nevojë për dritën e Islamit, që të vlerësojmë kulturën dhe qytetërimin që janë formuar në gjeografinë ku jetojmë.

Kemi bërë zgjedhje të ndryshme si popull. Po vërejmë se vlerat perëndimore nuk përputhen me gjeografinë e Anadollit. Të gjithë kemi mbyllur veshët përballë një jehone të tillë, sapo na është bërë e ditur.

Përse ndodh kështu?

Dua të radhis në këtë mënyrë shkaqet: injoranca, dëshirat e kota, sublimimi që u bëhet ndjenjave të rëndomta, skepticizmi, kthimi i shpinës ndaj urtësisë, arroganca, traditat, imitimi, dhuna – trysnia, pasuria, djallëzitetë e shejtanit, interesat e ngushta.

Sprova është shumë e vështirë!

Le të mos harrojmë se feja është për botën tonë.

Përmes adhurimit që i bëjmë Allahut i japim formë jetës, të cilën e kemi të formuar me konceptet farz, vaxhip, sunet, mustehab, mubah, haram, mekruh, mufsid etj. Vetëm kështu mund të arrijmë në lumturinë e vërtetë.



Xhafer Durmush

Shpërdorimi më i keq

Israf (*shpërdorim*), në aspektin leksikor do të thotë të kalosh kufijtë; pra, ta teprosh. Ndërsa kuptimi i përgjithshëm i israf-it shpreh: "daljen jashtë parametrave në besim, fjalë dhe sjellje, të cilat feja, logjika dhe tradita i konsideron të papërshtatshme; madje ajo shpreh edhe shpërdorimin e pasurisë dhe të mundësive për qëllime që nuk janë të lejuara ose legjitime." (*Enciklopedia e Islamit - Fondacioni i Komunitetit Mysliman i Turqisë, artikulli Israf - Shkapërderdhja, Xhengiz Kallek, vëll. 23, f. 179*)

Islami, i cili e thërret njeriun të jetë i matur në çdo kohë dhe në çdo situatë, i urdhëron ithtarët e vet që jo vetëm të ruhen nga koprracia, por të mos bëhen prej shpërdoruesve. Në të vërtetë, Zoti ynë thotë: **"O bijtë e Ademit! Vishuni bukur-përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë."** (*A'râf, 31*) dhe i udhëzon rrobërit e Tij të dashur, ta ndjekin këtë rrugë: **"dhe ata (robërit e Mi) që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar; por i përmbahen rrugës së mesme..."** (*Furkan, 67*)

Në Kuranin e Madhërishëm shikojmë se koncepti i shpërdorimit është përmendur në katër forma të ndryshme.

1- Në disa ajete, shpërdorimi është i lidhur me termat "politeizëm", "mosbesim" dhe "zullum-padrejtësi", sepse shpërdorimi, në aspektin fetar është devijim nga besimi monoteist, i cili është realiteti themelor. Ato nuk parashtrajnë vetëm akuza të pabaza kundër Islamit dhe myslimanëve; por edhe arrogancë, kokëfortësi, sarkazëm-ironi, vrazhdësi dhe sjellje të qëndrimeve agresive dhe shkatërruese rreth Allahut të Lartësuar dhe në çështjet e tjera fetare. (*Shik. A'râf, 81; Junus, 83;*

Shuara, 151-152; Jasin, 19)

2- Mëkatet e një personi ndaj vetes së tij, duke rënë në devijim e duke anuar nga e keqja, janë rebelim. Për shembull edhe thirrja: **"Thuaj: 'O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, ...'"** (*Zumer, 53*) ka këtë kuptim. Ndërsa Profeti ynë (*alejhi selam*), duke përshkruar gjendjen e një personi që e kaloi gjithë jetën e tij duke kryer mëkate, përmend shprehjen "israf-shpërdorim". Imam Neveviu këtë e shpjegon kështu: "Të shkosh përtej kufijve të ligjshëm, duke e tepruar në rebelim-mosbindje".

3- Në disa ajete, (*israf*) shpërdorimi është përmendur me kuptimin e kundërshtimit dhe të tejkalimit të dispozitave fetare, si për shembull: të konsiderosh të ndaluar-haram mirësitë të cilat janë hallall-të lejuara në fe (*En'âm, 141. A'râf, 8*) dhe të vrasësh një person të pafajshëm. (*Isrâ, 33*).

4- Ndërsa në një numër tjetër të ajeteve, është theksuar me këtë koncept, nënçmimi i shpenzimeve të panevojshme që bën një person ndaj pasurisë dhe mundësive që zotëron ose që ka në përgjegjësi.

Fjala *israf*, e cila është trajtuar gjerë e gjatë në Kuranin e Madhërishëm, me kalimin e kohës ka pësuar ngushtim semantik (*kuptimor*) dhe zakonisht i është referuar kuptimit të teprimit në shpenzimet personale. Ne mendojmë se do të jetë e dobishme përmendja këtu e përkufizimeve të vetëpërmbajtjes, shpërdorimit dhe shkapërderdhjes:

Vetëpërmbajtje, është të shpenzosh sasinë e nevojshme në kohën dhe vendin e duhur, me kusht që të mos jetë as më shumë e as më pak se sa mundësia e ofruar. **Shpërdorim**, konsiderohet shpenzimi i tepërt, në lidhje

me diçka për të cilën kemi nevojë, por që mund ta përbushim pa shpenzim të tepruar. Ndërsa **shkapërderdhje**, është të shpenzosh diçka pa qenë nevoja.

Feja jonë na urdhëron t'i shpenzojmë mundësitë që kemi atje ku do të fitojmë kënaqësinë e Allahut. Për këtë arsye, ashtu siç janë ndaluar me argumente të qarta dhe të prera shpenzimet, si alkooli, bixhozi, prostitucioni dhe korrupsioni, të cilat do ta çojnë individin dhe për rrjedhim edhe shoqërinë në shkatërrim; edhe konsumimi që stimulon pasionet e njerëzve, që e nxit shoqërinë për xhelozitë dhe që kanë një tundim krenarie, nuk është konsideruar e hijshme për të njëjtat arsye. Edhe sendet që janë të lejuara fetarisht të konsumohen, me të njëjtat pretekste, janë konsideruar të ndaluara dhe të papëlqyeshme, nëse shpenzohen më tepër se nevoja e kërkesave ditore. Sepse, të qenët mesatar, është parimi themelor që ka ndërmarrë Islami madje edhe në adhurime. Për këtë arsye, nuk konsiderohet e hijshme që personi të thellohet në adhurime deri në masën e braktisjes së përgjegjësisë, zbulurimi jashtë mase i xhamive dhe i mesxhideve, si dhe harxhimi me tepri në varreza. (*Enciklopedia e Islamit - Fondacioni i Komunitetit Mysliman i Turqisë, artikulli Israf - Shkapërderdhja*, Xhengiz Kallek, vëll. 23, f. 179)

Profeti (a.s.), në një hadith që e transmeton Ebu Isa Mugire bin Shu'be (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) thotë: "Allahu nuk i pëlqen të bëni thashetheme, të bëni pyetje të shumta dhe ta shpërdoroni pasurinë!" (*Buhari, Edeb-Edukata*, 6)

Ndërsa **Imam Gazali** (Allahu e mëshiroftë) thotë: "Të harxhosh pasurinë dhe mundësitë që ke në dorë atje ku ka nevojë feja dhe traditat është bujari, rënia poshtë këtyre vlerave është koprraci, ndërsa shpenzimet përtej kësaj konsiderohen shpërdorim-shkapërderdhje."

Përkufizimi më i shkurtër i *israfit*, me siguri është ai që e cilëson atë si "zullum-padrejtësi". Megjithatë, nëse do ta kategorizonim shpërdorimin, me siguri që do të ishte shpërdorimi i kohës, i cili është shpërdorimi më i keq dhe që nuk mund të kompesohet. Sepse shpërdorimi i kotë i kohës është zanafilla e të gjitha rrugëve që në fund të shpien tek shpërdorimi.

Feja jonë, na i parashtron periudhat e kohës, si shkallë që e çojnë njeriun në përsosmëri, të cilat janë të përhapura me intervale të caktuara në një ditë, javë, muaj dhe vit. Dhe kërkon ta vlerësojmë kohën, që është kapitali kryesor dhe t'i vlerësojmë ato si mundësi të arta për ta shfrytëzuar atë sa më mirë. Ndërsa shpërdorimi i kohës në mënyrën e jetës, është përmendur si shkallë që do ta shpie njeriun në marrëzi. Disa ditë dhe netë formojnë themelin e aplikimeve që do të hapin derën e shpërdorimit që do të bëhet në fusha të tjera.

Islami, për të cilin epoka jonë ka etje, nuk përqendrohet te konsumimi i tepërt i qenies njerëzore, por tek orientimi i saj drejt virtytit. Ndërsa, të qenët i virtytshëm mund të arrihet duke u ruajtur nga çdo shpërdorim apo shkapërderdhje.

LEJO / MENDO



KUJDES NDAJ PËRLYERJES SË DITURIVE

Objekti kryesor i Islamit është ta sjellë njerëzimin drejt përsosmërisë. Rruga që duhet të ndiqet gjatë ecjes drejt këtij synimi, është "ta njohësh çdo gjë ashtu siç është" dhe të jesh i vetëdijshëm se nga ke ardhur dhe ku do të shkosh; si dhe ta njohësh Allahun duke u nisur nga veprat, faktet dhe cilësitë e Tij. Dituria dhe mësimi i saj është i rëndësishëm në fenë tonë, e cila ka filluar me urdhrin e revelatës së parë "lexo".

Në **Ihja'u Ulumi'd-Din** (*Ringjallja e Diturisë Fetare*), bëhet e ditur se disa dituri si magjia, hajmalia dhe astrologjia dëmtojnë jo vetëm zotëruesin e saj, por edhe të tjerët. Sipas opinionit tonë, duhet t'u shtojmë edhe "kotësitë aktuale" shembujve që mësohen në veprat klasike. Mendjet dhe zemrat e njerëzve tanë duhet t'i mbrojmë nga kotësitat që pushtojnë orët më të çmueshme të tyre. Disa dituri janë shndërruar në gjëra më të dëmshme se injoranca.



Bindja dhe kryengritja

Durak Pasmaz

Bindje (itaat) është nënshtrimi ndaj sistemit në tërësi që ka vendosur Allahu. E kundërta e saj është kryengritja.

Nënshtrimi është teslimijeti. Në këtë kuptim, gjithçka çfarë është lënë e lirë, e gjithë bota makro dhe mikro, përveç vullnetit të njeriut i cili është lënë i lirë për arsye të sprovës që do kalojë, gjithçka tjetër është vendosur mbi një nënshtrim të përgjithshëm që ka vendosur Ai. **“A nuk e sheh ti se, në të vërtetë, Allahut i përuken në sexhde ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, edhe Dielli, edhe Hëna, edhe yjet, edhe malet, edhe drurët, edhe kafshët dhe shumë nga njerëzit (myslimanët)? Por ka shumë njerëz (mohues), që meritojnë dënimin. E atë që e poshtëron Allahu, askush nuk mund ta bëjë të nderuar. Allahu, me të vërtetë, bën çfarë të dëshirojë.”** (Haxhxi, 18) **“A mos kërkojnë ata diçka tjetër përveç fesë së Allahut, ndërkohë që Atij i përuken të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, me hir a me pahir dhe tek Ai do të kthehen të gjithë?”** (Al'Imran, 83) Harmonia dhe rendi në gjithësi është si pasojë e këtij nënshtrimi të përgjithshëm. Gjithçka ecën brenda një programi të caktuar, ashtu sikurse edhe atomet që gjenden në sistemin e diellit lëvizin brenda një projektoreje të caktuar dhe as që e prishin ndonjëherë këtë rregull. Dita dhe nata, stinët, yjet dhe bimët, kafshët dhe shpendët, që të gjitha lëvizin sipas Sunetullahut, pra brenda një programi hyjnor të caktuar, thuajse pasqyrojnë një rend të orkestrimit hyjnor.

I vetmi përjashtim në mesin e gjithë këtij nënshtrimi është vullneti i njeriut. Dhënia e lirisë mes nënshtrimit dhe kryengritjes, është bërë me shkak sprovën. Pasi aty ku nuk ka mundësi të lirisë së vullnetit nuk mund të bëhet fjalë për sprovë. **“Natyrisht që Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës.”** (Insan, 3)

Në shumë ajete të Kuranit Famëlartë urdhërohet nënshtrim ndaj Allahut dhe të Dëguarit të Tij. Formula: “Aty ku ka kryengritje ndaj Krijuesit, aty nuk mund të ketë bindje ndaj krijesave të Tij”, është një parim i përgjithshëm i patjetërsueshëm.

“Ne e kemi urdhëruar njeriun, që të sillet mirë me prindërit e vet dhe, nëse ata të nxisin ty që të më shoqërosh Mua (në adhurim) atë, për të cilin ti nuk di asgjë, atëherë mos i dëgjo ata. Tek Unë do të ktheheni të gjithë e do t'ju lajmëroj për gjithçka që keni bërë.” (Ankebut, 8)

Atëherë kur Ebu Bekri u zgjodh kalif, në ligjëratën që mbajti gjatë të xhumasë, tha: “Për sa kohë që unë u bindem Allahut dhe të Dëguarit të Tij, edhe ju m'u bindni mua. Atëherë kur të veprojnë kundërshtim me Allahun dhe të Dëguarin, ju nuk duhet të më ndjekni mua.” (Ibn Hisham, Sire, 4/311.)

Bindja ndaj udhëheqësit është shprehje e korrektesisë ndaj Allahut dhe të Dëguarit të Tij. Por nëse shikohet ndonjë devijim i caktuar, atëherë nuk bëhet fjalë më për bindje a nënshtrim ndaj drejtuesve. Ubade bin Samit (r.a.), ka thënë: “Ne dhamë fjalën se do t'i bindeshim Resulullahut, edhe kur të dëshironim edhe kur të mos dëshironim, që nuk do të ngatërrohemi me udhëheqësit tanë, që do të themi të vërtetën kudo

qofshim dhe që do ta zbatojmë dhe që nuk do të kemi frikë mospëlqimin e atij që ka refuzuar rrugën e Allahut.” (Buhariu, Texhridi Sarih, Nr. i Hadithit: 2203.) Raviu i këtij hadithi, Ubade, ishte një nga ata që e dinte Kuranin përmendsh. Atij i ishte dhënë detyrë që t’ua mësonte Kuranin njerëzve të Suffes. Omeri e pati dërguar atë në Siri që t’i mësonte ata. Fillimisht shkoi në Hama, pastaj në Palestinë. Në një çështje që nuk e pëlqeu, Muavija i qe kundërvënë dhe i pati drejtuar fjalë të rënda. Pas kësaj, Samit bin Ubade pati thënë:

- Kurrë nuk do të banoj në një vend ku je edhe ti!

Pastaj u largua për në Medine, Omeri e pyeti: “Cili është shkaku i ardhjes tënde në Medine?” Ai ndërkohë i tregoi për atë çfarë kishte ndodhur. Pas kësaj, Omeri i drejtohet:

- Kthehu në vendin tënd! Allahu nuk e pëlqen atë vend ku nuk gjendesh ti apo ndonjë i ngjashëm me ty.

Kurse Muavijes i shkroi një letër, në të cilën thuhej:

“Ti nuk ke të drejtë urdhërimi ndaj Ubades!”

Ajo çfarë kërkohet në Islam është bindja ndaj udhëheqësit dhe mosdalja kundër tij. Mirëpo, kjo bindje bëhet deri atëherë kur nuk shikohet ndonjë veprim që bie ndesh me parimet islame.

Resulullahu (a.s.), në një tjetër hadith ka thënë: “Do të vijë një klasë sunduesish mbi ju. Punët që janë në përputhshmëri me fenë aproveni, kurse ato që janë në kundërshtim me fenë mos i pranoni, por kritikoni. Kush nuk i pranon veprat që bien në kundërshtim me fenë do të mbrohet nga gjynahu. Kush do t’i kritikojë, kush do të bëhet pengesë për ata, do të shpëtojë. Mirëpo, kush është i kënaqur me çdo veprim të tyre, ai është prej kryengritësve.” (Muslimi, Iman, 63.)

E kundërta e bindjes nuk është medoemos kryengritja apo kundërvënia. E rëndësishme është të shikosh si gabim gabimin e bërë, të kritikosh siç duhet, të përpikësh ta përmirësosh. Të mos jesh pjesë e sipërmarrjeve të gabuara që ndërmarrin drejtuesit, të mos pëlqesh shpirtërisht dhe të mos u bindesh dëshirave të tyre është në një farë mënyre qëndrueshmëri. Ai që nuk ka fuqi ta ndryshojë me dorë, ai që nuk ka fuqi ta ndryshojë me gjuhë, le të mos jetë dakord shpirtërisht.

Në mbajtjen qëndrim ndaj drejtuesve të padrejtë dhe zullumqarë duhet të jesh mjaft i kujdesshëm. Nuk duhet rënë në gabimin “në vend që të heqësh vetullën, të nxjerrësh syrin”. Kryengritja fizike ndaj drejtimit lejohet vetëm pasi të jenë provuar të gjitha mënyrat e tjera, pasi të jenë konsumuar të gjitha rrugëzgjidhjet e tjera. Përndryshe, këto veprime bëhen shkak për fitne dhe masakra të mëdha.

E rëndësishme është që nuk duhen vënë në krye njerëz zullumqarë dhe gjynahqarë. E rëndësishme është të dorëzohet në duart e profesionistëve ky amanet:

“Allahu ju urdhëron që amanetet t’ua ktheni atyre që u përkasin dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni drejt.” (Nisa, 58)

Ai që e ka të dukshëm femohimin, ata që çojnë fenë dhe popullin drejt shkatërrimit, nuk është e lejuar të jenë drejtues në një shoqëri islame. Sipas Imam Shafut, të shkarkosh nga detyra një drejtues që bën gjynah në mënyrë të dukshme dhe këmbëngul në atë gjynah, është një detyrë fetare. Myslimani është i detyruar të thotë të vërtetën kudo qoftë dhe në çfarëdo konditash qoftë. Pasi, ai që hesht në raste padrejtësie është një shejtan i heshtur. Mirëpo edhe mënyra se si kundërvihesh, si kritikon ndryshon sipas gjendjes. Nganjëherë rezistenca pasive është më ndikuese se rezistenca aktive. Veprime si të mos duartrokasësh zullumqarin, të kursesh buzëqeshjen, t’i sjellësh shpinën, mund të jenë veprime më me efekt. Ajo çfarë është e shëmtuar dhe që nuk i shkon kurrë një besimtari të denjë është të mbështesë një zullumqar për interesat e kësaj bote, të mos nxjerrësh zë në raste zullumesh, të mos bëjë asnjëfarë reaksioni, qoftë edhe shpirtëror. Sipas asaj çfarë përcjell Taberani, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Kush ecën bashkë me një njeri mizor, duke e ditur se ai është i tillë, ai njeri është larguar nga Islami.” (Keshful-Hafa, Nr. i Hadithit: 2627.) “Kush ndihmon një mizor, Allahu bën që ai mizor t’i bëhet atij bela.” (Keshful-Hafa, Nr. Hadithit: 2380.)

Padrejtësia e zullumqarit nuk duhet fshehur, përkundrazi duhet shfaqur. Kështu, bëhet shkak që edhe njerëzit të marrin masa ndaj atij zullumi, si dhe bëhet shkak që mizori të përmirësojë veprimet e të ndryshojë. Ata që bëjnë të gabojë edhe më shumë një mizor janë njerëzit servilë që e rrethojnë. Shembull për ne janë sahabët, të cilët i patën thënë Omerit: “Nëse do të vep-rosh gabim, do ta korrigojmë gabimin tënd me shpata”. Njerëz të tillë janë mëshirë në mesin e drejtuesve, janë garanci për të mos devijuar në gabime. Gjithmonë duhet të mbajmë parasysh këtë fjalë të Resulullahut (a.s.): “Nëse ymeti im, humbet forcën për t’i thënë mizorit ‘O mizor!’ ai do të jetë i privuar nga mbrojtja hyjnore.” (Ahmed bin Hanbel, Musned, 2/190.)

Mosqëndrimi karshi mizorëve, gjynahqarëve dhe hipokritëve, dhe mbi të gjitha nderimi i tyre, e bën njeriun të pandershëm. Resulullahu (a.s.), ka thënë: “Kurrë mos u thoni hipokritëve “zotëri!”. Nëse ata bëhen zotërinjtë tuaj, atëherë meritoni dënimin e Allahut.” (Sujutiu, Fet’hul-Kebir, 3/333.)

Sjellja që i shkon besimtarit është të jetë pranë së vërtetës dhe popullit dhe kundër zullumit dhe zullumqarit. Kur është pyetur Pejgamberi (a.s.): “Cili xhihad është më i virtytshëm?”, ai është përgjigjur: “Fjala e vërtetë që thuhet përballë udhëheqësit mizor.”

Shpirti

OSE JETA

Edison Çeraj

Një prej temave më kyçe për të cilat kemi më shumë nevojë sot, në një kohë kaq të ngarkuar me turravrape të dendura pas të ashtuquajturit zhvillim të qëndrueshëm ose thjesht dashuria pa kushte (nis në mengjes e përfundon në darkë vonë) për mirëqenien, është pa dyshim edhe çështja e shpirtit. Natyrisht jo vetëm për shpirtin si të tillë, – megjithëse kësaj here do ndalemi pak tek ai – por për transhendencën në tërësi apo më thjesht, për botën e padukshme si e tillë. Vihet re gjithandej se në këtë drejtim (në fakt, i vetmi, pasi është e ardhmja e njeriut) flitet dhe diskutohet përherë e më pak. Edhe atëherë kur diskutohet, flitet në një formë skematike, pothuaj si në fushën e inxhinierisë!

Më e keqja është se pre e kësaj harresë me pasoja tronditëse për ecurinë e një shoqërie kanë rënë edhe shumë nga prijësit fetarë, të cilët gjejnë kohë t'i kokolepsin njerëzit me lloj-lloj xhinglash, me imtësi krejtësisht të panevojshme, me muhabete dylekëshe në lidhje me politikën e të tjera çudanëri kësodore.

Më poshtë kemi shkëputur një pjesë të një libri në proces botimi¹, ku trajtohet çështja e shpirtit, pjesë

1. *Islami nëpërmjet haditheve*, studim i një grupi autorësh nën përku-desjen e Dijanetit të Turqisë, që do botohet në shqipe nga Logos-A.

të cilën e kemi reduktuar dhe përshtatur për t'i dhënë trajtën e një eseje.

Na tregon Abdullah ibn Mesudi:

“Isha me Profetin (paqja qoftë mbi të) në një arë. Ai ecte duke u mbajtur me një shkop. Duke ecur u takua me disa hebrej, ku disa prej tyre thanë mes vedi: ‘Pyesni atë për shpirtin’. Disa të tjerë thanë: ‘Mos e pyesni, se ndoshta na jep një përgjigje që nuk do na pëlqejë!’ Pastaj iu afruan Profetit (paqja qoftë mbi të) dhe thanë: ‘O Ebu Kasim², na fol pak për shpirtin!’ Profeti (paqja qoftë mbi të) nguroi pak. Unë vura re se në atë moment po pranonte Zbulesën; kështu që u tërhoqa pak prapa sa të përfundonte zbritja e Zbulesës. Si përfundim, Profeti (paqja qoftë mbi të) lexoi ajetin (Isra, 85): **‘Të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, ndërsa ju nuk u është dhënë veçse pak dije’**³”

Përcillet nga Ebu Hurejra, se Profeti (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “Njerëzit janë si mineralet: ata që ishin të mirë në periudhën e padijes, janë të mirë edhe në Islam, mjaft që ta kuptojnë siç duhet Islamin. Kurse shpirtirat janë si ushtri të organizuara: ato që janë identike pajtohen, ndërsa ato që nuk janë identike nuk pajtohen

2. Një prej emrave të Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të!), që do të thotë “babai i Kasimit”.

3. Buhari, *I'tisam*, 3.

dhe ndahen.”⁴

Ebu Hurejra rrëfen: “Kur del shpirti i besimtarit, atë e takojnë dy engjëj dhe e bartin në lartësi. Banorët e qiellit thonë: “Po na vjen një shpirt i mirë nga toka. Allahu të mëshiroftë ty dhe trupin që ke bartur!” Pastaj e marrin dhe e çojnë te Allahu, dhe Allahu urdhëron: “Dërgojeni andej kufirit (*sidretu-l-munteha*). Ndërsa kur del shpirti i jobesimtarit, banorët e qiellit thonë: “Po vjen një shpirt i keq nga toka. Këtë dërgojeni në fund të kufirit (në xhehenem)! – u thuhet.”⁵

Përcillet nga i ati i Abdurrahman ibn Ka'b el-Ensarit, Ka'b ibn Maliku, se Profeti i Zotit (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “Shpirti i besimtarit, deri sa të kthehet në trupin e tij, që do rringjallet në Ditën e Gjykimit, është si një zog që do ushqehet nga pemët e xhenetit.”⁶

Janë disa pyetje thelbësore të cilat e mundojnë vazhdimisht mendjen e njeriut. Këto pyetje janë bërë në çdo periudhë të historisë njerëzore, duke u shoqëruar me polemika dhe me përgjigje të ndryshme. Një nga këto pyetje thelbësore, që është diskutuar si në qarqet fetare ashtu edhe ato filozofike, në të gjitha periudhat dhe kulturat, është ekzistenca e shpirtit dhe trajta e tij.

Problemi i shpirtit, që edhe sot e kësaj dite është një e panjohur për njeriun, i është parashtruar si pyetje edhe Profetit (paqja qoftë mbi të) të fundit, para më se katërmëdhjetë shekujsh.

Na rrëfen njëri nga shokët e tij të afërt, Abdullah ibn Mesudi, se një ditë të nxehtë në Medinë po ecnim me Profetin (paqja qoftë mbi të). Pasi ecëm pak, i Dërguari (paqja qoftë mbi të) u lodh dhe u mbështet në një shkop nga dega e hurmës. Aty u takua me disa hebrenj, të cilët thanë mes vedit: “Pyeteni atë për shpirtin.” Disa të tjerë thanë: “Jo. Mos e pyesni, se ndoshta na jep ndonjë përgjigje që nuk na pëlqen!” Pastaj u çuan nga vendi dhe erdhën te Profeti (paqja qoftë mbi të), dhe thanë: “O Ebu Kasim, na fol pak për shpirtin!” Kështu, Profeti (paqja qoftë mbi të) ngurroi ca. Unë vura re se në atë çast po pranonte Zbulesën, prandaj dhe u tërhoqa pak më prapa, gjer sa të përfundonte zbritja. Në fund, Profeti (paqja qoftë mbi të) lexoi ajetin: “**Të pyesin për shpirtin; ti thuaju se shpirti është një çështje që i përket vetëm Zotit tim; ndërsa ju nuk u është dhënë veçse pak dije**”⁷

Në një përcjellje tjetër nga Abdullah ibn Abasi, thuhet se çështjen e shpirtit Profetit (paqja qoftë mbi të) ia kanë shtruar paganët e Mekës, të nxitur nga hebrenjtë e Medinës.

4. Muslim, *Birr*, 160; Buhari, *Enbija*, 2.

5. Muslim, *Xhenneh*, 75.

6. Ibn Maxhe, *Zuhd*, 32; Nesai, *Xhenaiz*, 117.

7. Buhari, *I'tisam*, 3; Buhari, *Tewhid*, 28-29; Buhari, *Ilm*, 47; Muslim, *Sifat-l-munafikun*, 32-33; Tirmidhi, *Tefsiru-l-Kur'an*, 17.

8. Isra, 85.

Sipas tij, paganët e Mekës kërkonin shtigje si e si ta sfidonin e ta zinin mat Profetin (paqja qoftë mbi të), dhe kësaj i drejtuan për ndihmë edhe hebrenjtë të Medinës. Këta të fundit u thanë kurejshëve që ta pyesnin për thelbin e shpirtit. Paganët shkuan dhe e pyetën Profetin (paqja qoftë mbi të) për shpirtin, dhe me këtë rast zbriti ajeti “**Të pyesin për shpirtin...**”⁹

Përgjigja që ka dhënë Zoti për shpirtin nëpërmjet Zbulesës e bën të dorës së dytë çështjen se ku dhe prej kujt iu bë kjo pyetje Profetit (paqja qoftë mbi të). Në ajetin e mësipërm, Zoti u ka treguar edhe hebrenjtë, – që e mbanin veten si shumë të ditur – se nuk kanë shumë të dhëna në lidhje me shpirtin. Pikërisht për këtë, përgjigja në trajtën “...**shpirti është çështje e Allahut**”, është shumë kuptimplote.

Shpirti si çështje e Allahut, edhe nëpër vargjet e tjera të Kuranit (në shumicën e tyre shpirti përmendet si çështje e Zotit) tregon qartë se qëllimi i hebrenjtë dhe i idhujtarëve në lidhje me të ka të bëjë me Zbulesën. Për pasojë, në një ajet tjetër thuhet: “**Urdhri i Allahut do të arrijë patjetër, prandaj dhe mos e shpejtoni! I lavdëruar qoftë Ai dhe i lartësuar mbi gjithçka që i shoqërojnë (në adhurim)! Me vullnetin e Tij Ai i dërgon engjëjt (Xhebrailin) me shpallje tek ai që do nga robërit e Tij (duke u thënë): “Paralajmëroni se s’ka të adhuruar me të drejtë veç Meje, prandaj të më kini drojë!”**”¹⁰ Ndërsa në një ajet tjetër lexojmë: “**Dhe kështu, Ne të kemi dërguar ty shpallje me urdhrin dhe vullnetin Tonë.**”¹¹ Krahas kësaj, edhe kryengjelli, Xhebraili, është emërtuar si *er-Ruh*¹² dhe *er-Ruhu-l-emin*¹³. Thirrja e Isait (paqja qoftë mbi të) është përfunduar me *Ruhu-l-kuds*-in.¹⁴ Për rrjedhojë, shihet qartë se Kurani e ka përmendur shpirtin në një kuptim të gjerë, dhe në të shumtën e rasteve ka përfshirë edhe fjalën hyjnore.

Aq sa është i rëndësishëm shpirti për gjallërinë e trupit, po aq e rëndësishme e me vlerë thelbësore për shpëtimin, prosperitetin dhe lumturinë e njerëzimit është edhe Zbulesa. Kështu, te ajeti i mëposhtëm, porositi hyjnore janë paraqitur si burime të jetës: “**O besimtarë, bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyt midis njeriut dhe zemrës së tij, dhe tek Ai do mblidheni të gjithë!**”¹⁵ Ndërlidhja kuptimore midis shpirtit dhe çështjes/Zbulesës mund të verifikohet edhe me kuptimin gjuhësor të fjalës *ruh* – “shpirt”. Në lidhje me erërat, – *rija* në arabishte – fjalë që rrjedh nga e njëjta rrënjë me fjalën *ruh*, Zoti thotë: “**Allahu**

9. Tirmidhi, *Tefsiru-l-Kur'an*, 17.

10. Nahl, 1-2.

11. Shuara, 52.

12. Nahl, 102; Nebe', 38.

13. Shuara, 93.

14. Bakare, 87.

15. Enfal, 24.

është Ai që i dërgon erërat, të cilat lëvizin retë. Ne i drejtojmë ato në viset e vdekura dhe, nëpërmjet tyre gjallërojmë tokën, që ishte e shkretë. Kështu do jetë edhe ringjallja.¹⁶

Gjithashtu përdorimi, i frazës “një shpirt nga Allahu”¹⁷ për Isain (paqja qoftë mbi të), është në lidhje¹⁸ të drejtë me ringjalljen e të vdekurve.¹⁹ Zoti Fuqplotë, duke shtjelluar krijimin e njeriut, e lidh shpirtin me Vetën, duke nënkuptuar se përmes tij i ka dhënë gjallëri njeriut dhe e ka fiksuar: **“Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një njeri nga balta e thatë, e marrë nga balta e zehtë pa formë. Kur t’i jap formën dhe t’i fryj prej shpirtit Tim, ju përlujni atij në sexhde!”**²⁰ Kështu, kuptohet qartë që shpirti është eliksiri që i jep gjallëri lëndës/trupit.

Termi *ruh* – “shpirt” në Kuran është përdorur edhe me domethënien e Zbulesës, edhe me atë të engjëllit (Xhebrail) apo të shpirtit të njeriut. Por, sido që të jetë dhe në cilëndo trajtë të jetë përdorur, prapsepapë, domethënien thelbësore të tij nuk e di askush tjetër përveç Zotit Fuqplotë. Krahas përdorimit të shpeshtë në Kuran, shpirti është edhe një çështje e rëndësishme që është diskutuar gjatë. Koncepti i shpirtit nuk është kuptuar asnjëherë në tërësi, por ka një të vërtetë që shpirti është realitet njerëzor, historik dhe gjuhësor.

Lidhja midis shpirtit dhe trupit, pa dyshim që është një nga çështjet që e ka tërhequr më shumë arsyen e njeriut. Shpirti i njeriut në këtë drejtim ka një rëndësi të veçantë. Si gjatë historisë ashtu edhe sot, krahas atyre që e kanë mohuar shpirtin e njeriut dhe janë përqendruar te përmasa biologjike, ka pasur edhe të atillë që e kanë mohuar përmasën fizike dhe kanë konsideruar se thelbi i njeriut është shpirti. Madje në mesjetë, femra është konsideruar si një krijesë e veçantë dhe është diskutuar se a ka apo jo shpirt!²¹ Në traditën islame është polemizuar më fort në lidhje me thelbin e shpirtit, se a është i ndarë nga trupi apo është pjesë përbërëse e tij; se është i përkohshëm apo i përhershëm; pozita e tij pas vdekjes etj.

Si gjatë historisë, ashtu edhe sot, në botën perëndimore dhe atë islame, janë bërë përpjekje për të kuptuar dhe për ta bërë të kuptimtë botën e padukshme të njeriut, pikërisht shpirtin. Por, edhe pse nuk kanë pasur ndonjë sukses të madh, përpjekjet vazhdojnë edhe sot e kësaj dite.

Krahas kësaj, duke u nisur nga disa ajete të Kuranit dhe nga disa hadithe të Profetit (paqja qoftë mbi të),

16. Fatir, 9.

17. Nisa, 171.

18. Isfahani, *Mufredat*, përkthimi në turqisht, f. 648.

19. Maide, 110.

20. Hixhr, 28-29.

21. Mjafton të lexohet qoftë edhe një doracak me natyrë antropologjike apo edhe historike mbi mesjetën për ta vënë re këtë.

mund të flitet për disa të vërteta të thjeshta rreth shpirtit. Në disa raste, i Dërguari i Allahut, në vend të njeriut ka përdorur termin *nesemeh*²² – “krijesë me shpirt”.²³ Ky përdorimi nga ana e Profetit (paqja qoftë mbi të) tregon se përmasa shpirtërore e njeriut është parësore. Madje në një hadith, një zog të gjallë, Profeti (paqja qoftë mbi të) e ka cilësuar si “kafshë që ka shpirt”.²⁴ Si rrjedhojë, është e qartë se Islami i pranon gjallesat si të përbëra nga shpirti dhe trupi.

Përveç cilësimit të shpirtit si lëvizjedhësi i trupit dhe gjallëruesi i organizmit, Profeti (paqja qoftë mbi të) e ka përkufizuar atë edhe si “thelb që drejton sjelljet e njeriut”. Këtë realitet njerëzor ai (paqja qoftë mbi të) e ka shprehur si vijon: **“Shpirtrat janë si ushtri të organizuara: ato që janë identike, pajtohen; ndërsa ato që nuk janë identike, nuk pajtohen dhe ndahen.”**²⁵ Kështu, nga hadithet e Profetit (paqja qoftë mbi të) kuptojmë që shpirti është burimi i sjelljeve, i aftësive dhe animeve të njerëzve; dhe se dukuritë e tij janë të ndryshme të gjithë njerëzit. Pra, karakteristikat e strukturës shpirtërore që në lindje, u mundësojnë njerëzve me karaktere të ndryshme, të cilët jetojnë në grupe të caktuara, të pajtohen dhe solidarizohen me njëri-tjetrin. Domethënë, të mirët me të mirët dhe të këqijtë me të këqijtë.

Hadithi i mësipërm na bën me dije se shpirti përbën botën e brendshme të njeriut, karakteristikat e sjelljeve dhe aftësitë e tij. Zoti na mëson: **“Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre, u tha: “A nuk jam Unë Zoti juaj?” Ata u përgjigjën: “Po, dëshmojmë se Ti je.” Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Gjykimit se këtë nuk e dinim.”**²⁶

Vargu i mësipërm dëfton në trajtë alegorike të vërtetën se njeriu posedon një shpirt i cili është njohur me ekzistencën dhe njëshmërinë e Zotit qysh në lindje, dhe se në Ditën e Llogarisë nuk do ketë mundësi të strehohet te arsyetimi se ky besim ka qenë i huaj për të. Kjo çështje, në traditën islame është e njohur si *bezm-i elest* – “diskursi parazanafilor”. Disa nga dijetarët islamë²⁷ janë të mendimit se ky varg mbështet idenë se shpirtrat janë të krijuar para trupave. Sidoqoftë, “premtimi që është dhënë në botën shpirtërore” është përmasa e përhapur e këtij botëkuptimi. Krahas kësaj, mes myslimanëve ka pasur edhe dijetarë që kanë pohuar se shpirtrat dhe trupat janë krijuar në të njëjtën kohë.

22. Abdurrezzak, *Musannef*, I, 52.

23. Ibn Ethiri, *Garibu-l-hadith*, V, 49; LA49/4414 Ibn Mandhur, *Lisanu-l-arab*, II, 4414.

24. Muslim, *Sajid*, 59.

25. Muslim, *Birr*, 160; B3336 Buhari, *Enbija*, 2.

26. Araf, 172.

27. Ibn Ebu Shejbe, *Musannef*, Ewail, 1.

Nëse shpirti përfytyrohet si një frymë që mban gjallë trupin, atëherë vdekja është marrja e këtij shpirti me urdhërin e Zotit. Njëpër burimet e hadithit, ka më shumë të dhëna për gjendjen e shpirtit pas vdekjes. Kur vdiq Ebu Selemja, Profeti i Zotit që ai që ia mbylli sytë, dhe tha: *"Syri ndjek shpirtin në çastin kur merret nga Zoti!"*, dhe u lut për të: *"O Zot i botëve, zgjeroja varrin dhe ndriçoje për të!"*²⁸

Nëse merret parasysh fakti se me vdekjen, trupi i njeriut do kalbet e do shpërbëhet, atëherë e vërteta është se kjo lutje e Profetit (paqja qoftë mbi të) ka të bëjë me lumturinë dhe rehatinë shpirtërore të njeriut. Gjendjen pas vdekjes së një besimtarit vepërmirë dhe të një tjetri që ka bërë vepra të këqia, Profeti i Zotit e ka simbolizuar si më poshtë:

*"Pranë atij që është në shtratin e vdekjes afrohen engjëjt. Nëse ai që vdes është i mirë, atëherë engjëjt thonë: "O shpirt i bukur në trup të bukur, ndaju prej trupit duke merituar lëvdatën dhe bëhu i lumtur me mëshirën dhe faljen e Zotit që nuk të është hidhëruar!" Pastaj ai shpirt ngrihet në qiell dhe dera e qiellit është e hapur për të. Më pas pyetet: "Kush është ky?" Engjëjt që e kanë dërguar deri në qiell, thonë: "Është filani." Pastaj i thuhet: "Përshëndetje për shpirtin e mirë! Ai ishte në një trup të bukur. Hyr këtu me merita e lavde dhe bëhu i lumtur me mëshirën dhe faljen e Zotit, që nuk të është hidhëruar!" Pastaj, deri sa të dërgohet në qiellin ku do takohet me Zotin, fjalët e mësipërme i përsëriten vazhdueshëm. Ndërsa përkundër këtij njeriu të mirë, nëse në shtratin e vdekjes është një njeri i keq, atëherë engjëlli i thotë: "O shpirt i ndyrë në trup të ndyrë, dil që andej! Dil si i qortuar dhe merre lajmin e keq për dënimet me ujë të nxehtë e me qelb të banorëve të xhehenemit, dhe me mënyra të tjera dënimi!" Këto fjalë i përsëriten deri sa të dalë nga trupi. Pastaj ai shpirt dërgohet në qiell. Por, dera e qiellit nuk hapet për të, dhe e pyesin se kush është. Përgjigjen se është filani. Për shpirtin e lig nuk ka rehati; ai ishte në një trup të lig. Kthehu prap si i qortuar! Për ty nuk do hapen asnjëherë dyert e qiellit. Si pasojë, ai shpirt kthehet nga qielli në tokë dhe hyn në varr, aty ku është edhe trupi i tij."*²⁹

Pra, ndryshimi midis të mirit dhe të ligut pas vdekjes, sipas bisedës që na rrëfen Profeti (paqja qoftë mbi të), është si ndryshimi midis qiellit të gjerë dhe varrit të

ngushtë. Për shpirtat e pastër dhe të mirë ka liri dhe lumturi të pafund, ndërsa për të ligët ka vetëm jetë burgu. Në një hadith tjetër, Profeti (paqja qoftë mbi të) ka thënë se *"varri mund të jetë një kopsht nga kopshtet e xhenetit, ose një gropë nga gropat e xhehenemit"*³⁰, duke na bërë me dije se për njerëzit e mirë me fund të lumtur³¹, të cilëve që në çastin e vdekjes u është treguar për vazhden e jetës së tyre pas vdekjes, do ketë freski shpirtërore, ndërsa ata që kanë bërë vepra të liga do ngushtohen dhe do ndjejnë një torturë të madhe shpirtërore, ngjashëm me atë që është arrestuar dhe mbahet në paraburgim.

Gjendjen shpirtërore të besimtarit gjatë këtij procesi, Profeti i Zotit e ka sqaruar me një hadith tjetër me fjalët: *"Shpirti i besimtarit, gjer sa të kthehet në trupin e tij, që do ringjallet në Ditën e Gjykimit, është si një zog që do ushqehet nga pemët e xhenetit!"*³²

Këtë lajm të Profetit (paqja qoftë mbi të) na e ka përcjellë një shok i tij që ka qenë poet, Ka'b ibn Malliku, dhe këtu është shprehur edhe fakti se pas ringjalljes së trupave, shpirtat do kthehen përsëri aty ku ishin, pra nëpër trupa. Kjo çështje është e rëndësishme për nga aspekti i mbledhjes së njerëzve para Zotit për të dhënë llogari.

Nëse do liheshin mënjanë shpjegimet e ajeteve dhe të haditheve në lidhje me shpirtin, atëherë do kishim shumë pak mundësi që të flisnim për gjendjen e shpirtit para krijimit të njeriut dhe për gjendjen e tij pas vdekjes së trupit. Pjesa më e madhe e teksteve në këtë drejtim janë të paargumentuara. Si pasojë, shpirti do vazhdojë të mbetet si një anë e veçantë dhe e panjohur e njeriut. Megjithatë, mosnjohja e shpirtit nga ana e njeriut nuk do të thotë se ai nuk ekziston. Për fat të keq, sot njeriu është reduktuar vetëm në një mjet që prodhon dhe konsumon dhe në praktikë, shpirti i tij nuk merret aspak në konsideratë. Botëkuptimi shoqëror bashkëkohor përpiket ta kufizojë njeriun në kuadër të lëndores dhe ta identifikojë me përmasën trupore të tij, dhe kurrsesi nuk do që të merret me kërkesat shpirtërore të njeriut dhe me mënyrën si mund të përmbusheshin ato.

Si përfundim, ajo që vlen të theksohet është se dijetarët islamë e shumë të tjerë në përgjithësi janë angazhuar më tepër për shtjellimin e të ardhmes së shpirtit, sesa për të kaluarën e tij.

Nëse do liheshin mënjanë shpjegimet e ajeteve dhe të haditheve në lidhje me shpirtin, atëherë do kishim shumë pak mundësi që të flisnim për gjendjen e shpirtit para krijimit të njeriut dhe për gjendjen e tij pas vdekjes së trupit.

28. Muslim, *Xhenaiz*, 7.

29. Ibn Maxhe, *Zuhd*, 31; Ibn Hanbel, II, 364; Muslim, *Xheneh*, 75.

30. Tirmidhi, *Sifatu-l-kijameh*, 26.

31. Tirmidhi, *Xhenaiz*, 70.

32. Ibn Maxhe, *Zuhd*, 32; Nesai, *Xhenaiz*, 117; "Muvatta'", *Xhenaiz*, 16.



BASHKËSHORTJA E OSMANIT (R.A.)

Naile binti Ferafisa

Mustafa Erish

Naile binti Ferafisa, (r.a.), ishte një zonjë sahabë fatlume, e cila u martua me Osmanin (r.a.), pas vdekjes së dy vajzave të bekuara të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Bashkëshortja besnike dhe sakrifikuese e Osmanit (r.a.), nuk u largua nga ai edhe kur u martirizua nga kryengritësit mizorë të cilët i rrethuan shtëpinë...

Ajo ishte një zonjë hatibe dhe elokvente, që i këshilloi dhe u rezistoi atyre të cilët kishin hyrë në shtëpinë e Osmanit (r.a.) dhe që ishin tërbuar për ta vvarë... Një zonjë heroinë dhe trimëshë, që hu-

mbi gishtërinjtë e saj duke luftuar plot guxim kundër sulmeve dhe shpatave të mizorëve...

Ajo ishte një zonjë e respektuar dhe e vlerësuar në popull, e zgjuar, inteligjente, zemërbutë dhe një fatlume me shpirt prej poeteje...

I përkiste fisit Beni Kelb. Të jatin e kishte të krishterë. Emri i tij ishte Ferafisa bin el-Ahvas. Ai ishte një njeri inteligjent dhe zotëri, që respektohej nga populli i tij. Një baba i cili përpiqej që fëmijët e tij të ishin të drejtë, të moralshëm, të ditur dhe të kulturuar.

Naile binti Ferafisa (r.a.), u rrit në një ambient të

krishterë. Por ajo ishte një njeri me shpirt poeti, lexuese dhe studiuese. Ajo filloi të mblidhte të dhëna rreth fesë dhe pejgamberit të fundit. Të dhënat që kishte mësuar rreth moralit të lartë të Islamit, ia ndriçuan botën shpirtërore të saj. Pas një kohe të shkurtër, vendosi të bëhej myslimane. Bashkë me dy motrat e saj, pranuan Islamin, thanë shehadetin dhe u nderuan me fenë e fundit që solli Muhamedi (a.s.).

Edhe pse babai i tyre vazhdonte të ishte i krishterë, ai kurrë nuk u doli kundër vajzave të tij që ishin bërë myslimane. Madje, dy prej vajzave të tij u dha leje të martoheshin me burra myslimanë.

Vajza e parë, Hindi (r.a.), u martua me prefektin e Kufës, Sad ibn Asin (r.a.). Ndërsa vajza e dytë, Nailja (r.a.), u martua me dhëndrrin e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem dhe halifen e tretë të myslimanëve, Osmanin (r.a.).

Martesa e Naile binti Ferafisas (r.a.), u realizua kështu:

Sad ibn Asi (r.a.), ishte prefekti i Kufas para hilafetit të Osmanit (r.a.). Kur ishte në këtë detyrë, u martua me vajzën e Ferafisas, Hindin. Pasi Osmani, (r.a.), e dëgjoi këtë, menjëherë i shkroi Sad ibn Asit (r.a.), një letër të veçantë.

Në këtë letër i kërkoi shpjegime, duke i thënë: "Me sa kam dëgjuar, je martuar me një grua nga fisi Beni Kelb. Më jep të dhëna në lidhje me fisin dhe karakterin e saj." Edhe ai iu përgjigj duke ia shpjeguar në një letër:

"Vajza që kam marrë është vajza e Ferafisa bin el-Ahvasit. Ajo është një vajzë e rritur në shtëpi të krishterë, por më pas është bërë myslimane, është e ditur, e sjellshme dhe e zgjuar. Është e drejtë dhe ka moral të përsosur."

Pasi Osmani, (r.a.), e mori letrën dhe e lexoi, përsëri i shkroi një letër Sad ibn Asit (r.a.). I shprehu kërkesën që kishte në zemër dhe i tha:

"Nëse ka motër, martoje me mua!" Në këtë mënyrë, e bëri përgjegjës të saj.

Sad ibn Asi, (r.a.), i shkroi një letër vjehrrit të tij dhe i tregoi për kërkesën e Osmanit (r.a.). Babai i saj, pa hezituar aspak, caktoi përgjegjës për martesën e vajzës së tij, Nailës, vëllain e saj Dabin.

Nailja (r.a.), ishte e re. Kur e dëgjoi se do martohej me një të moshuar si Osmani (r.a.), u mendua pak. Por fakti se ai ishte një njeri fisnik, i ndershëm dhe i përgëzuar me xhenet, u bë shkak që Nailja (r.a.), të

jepte përgjigje pozitive për këtë martesë.

Pasi u përshëndet me familjen, bashkë me vëllain e saj Dabin, i cili ishte bërë edhe ky mysliman, shkuan te shtëpia e Osmanit (r.a.), në Medinetu'l-Munevvere.

Osmani, (r.a.), e uli bashkëshorten e tij të re, Nailën, (r.a.), në një vend të lartë dhe bisedoi me të. Ai (r.a.), mbeti i kënaqur nga fjalët dhe sjelljet e saj përgjatë bisedës që zhvilluan.

Nailja (r.a.), ishte një bashkëshorte besnike dhe sakrifkuese. Ajo nuk la asgjë mangut në respektin dhe shërbimin ndaj bashkëshortit të saj. Në ditët e periudhës së mbushur me përçarje, ishte mbështetësja më e madhe e bashkëshortit të saj.

Ditën kur Osmani, (r.a.), u rrethua dhe mbeti i mbyllur në shtëpi, nuk u largua prej tij. Kur pa se tradhtarët e tërbuar kishin hyrë me shpata për të vrrarë bashkëshortin e saj, i doli përpara dhe u përpoq ta mbronte. Shpatat që drejtoheshin nga ai, u përpoq t'i ndalonte me dorë. Në këtë potere të madhe, një shpatë i preu gishtat.

Ajo ishte një bashkëshorte besnike dhe trimëreshë.

Nailja (r.a.), e transmeton kështu këtë çast të rrethimit:

"Ditën kur shtëpia e Osmanit (r.a.), u rrethua, ai ishte agjërueshëm. Kur erdhi koha e iftarit, kërkoi ujë. Kryengritësit i thanë duke u tallur: 'Pak më poshtë ka një pus.' Ata i treguan një pus në të cilin ishte hedhur papastërti dhe mbante erë të keqe. Atë natë e kaloi pa ngrënë dhe pa pirë asgjë. Kur zbardhi dita, erdhën fqinjët. Edhe prej tyre kërkoi ujë. Menjëherë vrapuan dhe i sollën ujë. Në ato momente, ai kishte rënë në një gjumë të lehtë. Kur erdhi uji, e zgjuan. Përgjatë kohës në gjumë, kishte parë një ëndërr. Ai tregon:

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, më pa nga ky tavan, më zgjati një kovë plot me ujë dhe më tha:

-O Osman! Urdhëro, pi!

Unë piva derisa e shova etjen. Uji nuk pakësohej, përkundrazi, sa më shumë të pija, aq më shumë shtohet. Pastaj më tha:

-O Osman! Një grup prej popullit tënd do të të sulmojë. Nëse do luftosh me ta, do të fitosh. Nëse nuk u reziston, nuk lufton dhe i lë të lirë, do të bësh iftar pranë nesh. (Ali el-Muttaki, nr: 36295.)

Osmani, (r.a.), iu nënshtrua kaderit dhe u dorëzua.

Kryengritësit hynë brenda dhe e martirizuan njeriun që ishte shembull në edukatë dhe turp.

E njëjta çështje, transmetohet kështu në një variant tjetër:

Bashkëshortja e Osmanit (r.a.), Naile binti Ferafisa (r.a.), transmeton:

Emiru'l-mu'minin, Osmani (r.a.), kishte fjetur pak. Kur u ngrit nga gjumi, tha:

-Populli im do më vrasë.

Unë i thashë:

-Kurrë. Inshallah nuk do ta arrijnë kurrë këtë gjë. Inshallah nuk do ta bëjnë dot atë që dëshirojnë. Me të vërtetë, populli yt do të të ruajë dhe do të të mbrojë.

Osmani (r.a.), përsëri tha:

-Në ëndërr kam parë të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve selem, Ebu Bekrin dhe Umerin, (r.a.)ma.

Më thanë:

-Këtë mbrëmje hape iftarin pranë nesh." (Ahmed bin Hanbel, I, 73.)

Naile binti Ferafisa (r.a.), ishte një grua elokuate. Të folurit e kishte të fortë dhe ndikues. Kur u rrethua shtëpia e Osmanit (r.a.), u tha kryengritësve:

-A doni ta vrisni atë? Unë po ju them këtë, pastaj veproni si të doni.

Ai e kalon të gjithë natën me një rekat dhe në atë rekat e bën hatme Kuranin. Ua kujtoi atyre virytin e tij dhe faktin se ishte një mik i Kuranit. (Hejsemi, IX, 94; Ebu Nuajm, Hilje, I, 57.)

Ajo ishte një grua e fortë, besnike dhe trimëreshë. Nuk e humbi fuqinë e saj edhe kur Osmani, (r.a.), u martirizua. Kryengritësve ua kujtoi përsëri të njëjtat gjëra dhe u tha:

-Ju e vratë atë. Për Zotin! Ai e kalonte të gjithë natën duke e bërë hatme Kuranin në një rekat. (Ibn Sa'd, III, 76.)

Me këtë fjalë po vërtetonte se bashkëshorti i saj ishte njeri me edukatë, ishte i turpshëm, mik i Kuranit dhe njeri me viryete. Ajo përpiquej të ngushëllonte veten dhe të gjente prehje duke përmendur moralin e lartë të tij.

Nailja, (r.a.), përjetoi një ditë shumë të dhimbshme dhe shokun e saj të jetës nuk e la vetëm deri në fund.

Ne nuk kemi shumë të dhëna rreth jetës së saj. Në literaturën islame nuk përmendet se ku dhe kur ka ndërruar jetë.

Allahu qoftë i kënaqur prej saj!

Allahu Teala e bëftë prej banorëve të xhenetit dhe na mundësoftë që të përfitojmë nga besnikëria e saj! Amin!



SPROVA E TË MOSHUARVE SPROVA E TË RINJVE

Jeta është si perdet, ku pas çdo njëres ndodhet një etapë tjetër e jetës sonë, deri sa arrijmë te perdja e fundit, të cilën mund ta quajmë si dhoma e pritjes për në botën e amëshuar. Pleqëria është periudha e fundit e jetës së njeriut, e cilësuar e dobët e plogësht, pas së cilës fshihet vdekja. Moshat e thyera kanë nevojë për respekt, nderim e përkujdesje, që të mos e ndiejnë veten të braktisur. Ky përkujdes duhet të ekzistojë jo vetëm tek familjarët e tyre, por edhe në shoqërinë tonë në përgjithësi.

Ne nuk e kuptojmë se çfarë mirësish e begatish humbasim duke i shtyrë jashtë jetës sonë të moshuarit. Jemi të humbur që në momentin kur pandehim se nuk kemi nevojë për përvojat e tyre, të cilat mund të shërbejnë si pishtarë drite në rrugën tonë të jetës. Gjyshi apo gjyshja ishin dikur kujdestarë të shtëpisë dhe të nipave të tyre, duke ndihmuar fëmijët e tyre, të cilët ishin të zënë me punë. Ata jepnin kontributin e tyre të çmuar në formimin e një familjeje të lumtur, por me kalimin e kohës filluam të humbasim traditat e vyera dhe të moshuarit i nxorëm jashtë jetës sonë, duke i vendosur nëpër azile. Prindërit tanë, që na rritën me aq mundim, i hodhëm jashtë. Ky fenomen shumë negativ po përhapet gjithnjë e më shumë në mesin tonë, duke sjellë me vete një tip egoist, që nuk mendon aspak për të tjerët. Zembrës egoiste, dhoma e gjerë i duket

e ngushtë. Gjendja vjen gjithnjë duke u përkeqësuar. Nëse dikur nuk i strehohim dot në dhomë, tani nuk i strehohim dot as në zemër.

Për t'i bërë të lumtur të moshuarit, mjafton një buzëqeshje, një fjalë e mirë apo një dhuratë e vogël.

Ne duhet të jemi të vetëdijshëm se prania e të moshuarve në shtëpitë tona nuk është fatkeqësi, por një begati e madhe. Pejgameri (a.s.), na informon se prania e tyre është një mburojë e fortë kundër fatkeqësive: **"Nëse nuk do të ishin foshnjat, të moshuarit dhe kafshët, do t'ju godisnin fatkeqësitë pa pushim."** Kapërcimi me durim dhe mirëkuptim i një sërë shqetësimeve që vijnë prej tyre, bëhet shkak për hapjen e deryve të mirësisë dhe lumturisë.

Braktisja në vetmi e të moshuarve ka sjellë një frikë nga plakja, sepse shqetësohemi nga përfundimi i njëjtë. Dhe për të mos pasur të njëjtin përfundim si ata, përdorim të gjitha mënyrat për të mos u plakur. Produktet kozmetike, që gjoja ngadalësojnë plakjen, shiten me të njëjtin ritëm si ushqimet jetësore të njeriut. Operacionet plastike kanë arritur kulmin e zhvillimit. E gjitha kjo vjen si pasojë e lënies pas dore të anës shpirtërore. Të parët tanë e pranorin me pjekuri procesin e plakjes. Ngaqë ndaj të moshuarve tregohej respekt dhe dashuri, plakja nuk konsiderohej si fundi i jetës. Ata përjetonin prestigjin e të jetuarit pranë fëmijëve dhe nipave.

Është për t'i vlerësuar të parët tanë, të cilët me gjithë vështirësitë për të siguruar jetesën, nuk e braktisën për asnjë moment adhurimin ndaj Allahut të lartësuar, fëmijët i konsideruan si emanet dhe bënë të gjitha përpjekjet për t'i edukuar me frymën hyjnore. Ngaqë nuk e shpenzuan kot jetën, u plaken të qetë duke falënderuar Allahun, që u bëri të mundur ta adhurojnë me dashuri.

Sa mirë për të parët tanë, që e kanë lidhur zemrën me Krijuesin... Dhe sa mirë për atë rini që di vlerën e të moshuarve, duke treguar respekt e dashuri!

PËRSE JEMI NË KËTË GJENDJE?

Sami Byjykkajnak

Popujt myslimanë po përjetojnë një përçarje të madhe. Nën një rrethim madhështor shekullarist, pothuajse po lajnë hesapet me fenë e tyre. Zemra bëhet copë-copë kur vihet re se myslimanët janë pala që humb në këtë larje hesapesh. Ndërkohë që myslimanët nuk duhet të ishin pala që humbet.

Përse kanë humbur myslimanët?

Përgjigja e kësaj pyetjeje është kjo:

Mungesa e pjekurisë së përfaqësimit...

Pasi myslimanët neglizhuan pjekurinë e përfaqësimit, arritën në një gjendje saqë humbën edhe fenë e tyre, sepse, nëse te popujt që njihen si myslimanë ka probleme të ndarjes sociale dhe si rezultat i kësaj ka vëllezër që shtypen, nëse i pasuri është tepër i pasur dhe i varfri është tepër i varfër, nëse morali merret nëpër këmbë dhe njerëzit nuk janë të sigurt nga njëri-tjetri, nëse faqet e treta të gazetave, të cilat japin lajmet e tragjediave sociale, janë të mbushura me lajme që zemra nuk i përballon dhe mendja e ka të vështirë për t'i pranuar, nëse njerëzit janë hipokritë, domethënë, e brendshmjia e tyre nuk përputhet me të jashtmen, nëse ata që pohojnë se punojnë për Islam në nuk janë të sigurt nga njëri-tjetri, nëse familjet janë të ndara nga njëra-tjetra dhe individët nuk mund ta ndajnë të njëjtën jetë etj., do të thotë se është humbur profili i

myslimanit që është formuar në kohën e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Do të thotë se pjekuria e përfaqësimit është çuar dëm.

Mirë, por si kemi ardhur në këtë pikë?

Në këtë pikë kemi ardhur kur fenë tonë ua kemi dorëzuar jomyslimanëve...

Po, kaq e qartë është përgjigja e kësaj pyetjeje!

Koha kur myslimanët hynë nën administrimin e jomyslimanëve, është koha kur feja e tyre u ekzekutua. Është koha kur nacionalizmi kaloi para bashkimit të umetit. Është koha kur myslimanët janë individualizuar dhe ndarë në xhemate. Është koha kur myslimanët janë dhënë pas kësaj bote dhe e kanë harruar botën tjetër. Është koha kur është ekzekutuar Islami.

Synimi i këtij ndryshimi historik, faktikisht ishte ky:

Myslimanizmi le të ngelet si një emër paraprak, kjo është e mjaftueshme. Ndërsa përmbajtja, përshtirshmëria, veprat dhe ndëshkimet ligjore lërinë në një anë...

Ja, kjo është koha kur jemi shkatërruar. Kjo është koha kur janë nëpërkëmbur vlerat. Kjo është koha kur pjekuria e përfaqësimit të myslimanizmit ka rënë për tokë. Kjo është koha kur myslimanët janë përçarë dhe po mbyten në dallgët e kësaj përçarjeje.

Mirë, po përse myslimanët e toleruan këtë projekt të ndryshimit të historisë?

Myslimanët e ngrinë trashëgiminë e tyre. Një fe plot aksion dhe dinamizëm në jetë si Islami, e sollën në gjendje të palëvizshme dhe statike. Shembujt më të bukur në trashëgiminë historike i ngrinë dhe i panë si vepra historike. Si rezultat, një sëmundje që e shfaq fenë islame sikur ajo të mos kishte një vizion si studimin, zhvillimin dhe përparimin, e ka rrethuar organizmin nga të gjitha anët. Në vend që myslimanët ta mjekonin vetë këtë sëmundje, ia dorëzuan mjekëve jomyslimanë. Ndërsa mjekët jomyslimanë, në vend që ta mjekonin këtë sëmundje, bënë çdo gjë që kishin mundësi, në mënyrë që kjo sëmundje të mos shërohej asnjëherë. Për shkak të kësaj, myslimanizmi i lënë në duart e mjekëve jomyslimanë, erdhi në ditët e sotshme në këtë gjendje që e shohim të gjithë.

Jomyslimanët u sollën përpara myslimanëve projekte që i joshin epshet e pasionet dhe që e tërbojnë nefsin. Myslimani i sotëm, që ka ngelur ndërmjet nefsit dhe myslimanizmit, nuk heq dorë as nga nefsi dhe as nga myslimanizmi. Në këtë mënyrë, në pah del një myslimanizëm që lë shumë për të dëshiruar.

Myslimanizmi i sotëm është një myslimanizëm i shndërruar në një gjendje të mjeruar.

Pak ibadet, pak vepra dhe pak besim...

Përderisa gjendja të vazhdojë me këtë ecuri, për brezat e mbërthyer ndërmjet vetes dhe myslimanizmit dhe që po rriten me teknologjinë e re, do të jetë shumë e vështirë arritja e një përmirësimi me frymë islame, i cili mund t'ua shërojë zemrat.

A mund të dalë në pah një brez i fortë mysliman nga një lojë, programin e së cilës nuk e keni bërë ju, nga një film që skenarin nuk ia keni shkruar ju dhe nga një sistem jete të cilin nuk e keni formuar ju?

Kësaj pyetjeje nuk mund t'i jepet përgjigja "po". Nën këtë lloj rrethimi, për shembull, në një ambient në të cilin vazhdimisht njerëzit flirtojnë me njëri-tjetrin dhe në të cilin flirtimi tregohet si joshës, nuk mund ta shpjegojë se përzjerja e vajzave me djemtë nuk është e lejuar. Madje, mund të shikoni edhe djem të rinj që i njihni për fetarë duke ndarë të njëjtin mjedis me vajzat dhe duke u argëtuar me to.

Madje, është e vështirë të gjeni një djalë të ri fetar që nuk ka të dashur. Madje, mund të përballeni edhe me një përgjigje vetëmbrojtëse dhe të palogjikshme si: "Çfarë të keqeje ka? Po bisedojmë për Islamin!"

Ju u thoni: "Meqë keni për të bërë mbledhje apo shëtitje, i organizoni burrat veçmas dhe gratë veçmas." Ata menjëherë u kthejnë këtë përgjigje:

"Në cilin shekull ke ngelur?" Edhe një herë duhet ta nënvizojmë se ata që japin këtë përgjigje janë të rinjtë

që pohojnë se janë myslimanë dhe fetarë.

Të moshuarve me abdest, namaz dhe mjekër u thoni:

"Mos bashkëpunoni me bankat që japin kredi me kamatë. Ka edhe institucione alternativë. Ka institucione që thonë se bashkëpunojnë pa kamatë. Prandaj shkoni te ata!" Por ata e bëjnë të ligjshëm bashkëpunimin me ata që japin kredi me kamatë duke thënë:

"Edhe ajo është bankë edhe kjo është bankë. Çfarë ndryshimi ka?"

Edhe këta dy shembuj të thjeshtë mjaftojnë për ta shtruar para syve se në ç'gjendje të keqe është lëshuar myslimanizmi...

IMAZH

Myslimanët janë shumë të qetë... Zoti na ruajtë, por po përjetohet një "rehati" që i ka verbuar dhe larguar krejt nga besimi. Nëse mund ta shprehim kështu, nuk ia dinë vlerën besimit. Për këtë arsye, sundon mendimi "ç'më duhet mua?" Të thuash se e ardhmja do të jetë e mirë në një periudhë kohe kur po i humbim dhe po i çojmë dëm mirësitë tona, është një lloj mashtrimi i vetvetes. Për këtë arsye, duhet t'i rikthehemi besimit. Allahu Teala ka bërë një thirrje për ata që besojnë. Kur ta lexojmë këtë thirrje, duhet të pyesin: "Përse po na thërret Allahu?" Në këto ditët e sotme, kjo ftesë apo ky urdhër ka një kuptim të madh. Allahu i Lartësuar i fton ata që kanë besuar për të besuar:

"O ju që keni besuar! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë. Kushdo që mohon Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë." (Nisa, 136)

Edhe i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, kërkon ta rinovojmë besimin. (Ahmed b. Hanbel, Musned, 2/359.)

Domethënë se kur myslimani është në gjendje të vështirë, ka ardhur koha për ta rinovuar besimin e tij. Edhe kjo periudhë kohe në të cilën po jetojmë, është njëra prej këtyre kohëve të tilla. Nisur nga kjo, ne duhet ta rinovojmë besimin tonë dhe ta kontrollojmë. Ne duhet ta kontrollojmë besimin që kemi ndaj Allahut (xh.sh.), besimin që kemi ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe besimin që kemi ndaj Kuranit Fisnik. Ne duhet t'i sjellim në rendin e ditës vlerat prej të cilave jemi larguar, që i kemi humbur dhe që ua kemi humbur të tjerëve dhe të përpiqemi e të luftojmë për t'u shkruar te Zoti prej "garibëve", të cilët i ka përgëzuar i Dërguari i Allahut (a.s.).

"Përgëzime për "garibët"! Ata janë njerëzit të cilët i rregullojnë gjërat që i prishin njerëzit e tjerë." (Ahmed b. Hanbel, Musned, 4/73.)

PASOJAT E GRINDJES

Prof. dr. M. Jashar Kandemir

Allahu Teala ka mbjellë në zemrën tonë farat e dashurisë, ka vendosur ndjenjat e vëllazërisë, zemrën tonë e ka bërë qendër të dhembshurisë e mëshirës dhe e ka lartësuar atë duke e stolisur me mirëkuptim dhe tolerancë.

Allahu ka kërkuar që këtë vend të bukur ta mbajmë larg furtunave shkatërruese të ndarjeve, zënkave, urrejtjeve, përçarjeve, prishjeve, kontradiktave, ndërprerjeve të lidhjeve me njëri-tjetrin, refuzimeve reciproke dhe paragjyqimeve. Po ashtu, duke na kujtuar se në çfarë gjendjeje mund të na sjellin ato furtuna, ka thënë:

“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t’ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit.” (Enfal, 46)

Allahu Teala njofton se për ata që përçahen dhe grinden me njëri-tjetrin, do të ketë ndëshkim të madh:

“Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këta do të ketë dënim të madh.” (Al' Imran, 105)

Në luftën e Uhudit, kur myslimanët u grindën me njëri-tjetrin në çështjen e bindjes ndaj të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u ndëshkuan. Në lidhje me këtë fakt Allahu i Madhëruar thotë:

“Vërtet Allahu e plotësoi premtimin e Vet, kur ju me vullnetin e Tij e thyet armikun. Por, kur ju u frikësuat, u grindët midis jush dhe kundërshtuat (Profetin), pasi Ai ju tregoi atë që pëlqenit, (Allahu e tërhoqi ndihmën e Vet). Disa nga ju dëshirojnë këtë botë, ndërsa të tjerë nga ju dëshirojnë botën tjetër. Pastaj Ai, për t’ju provuar, bëri që të zbrapseni para armikut dhe pastaj, sigurisht që jua fali atë gabim. Allahu ka mirësi të madhe për besimtarët.”

“Kur ju morët malin dhe nuk i vinit vesh askujt, të Dërguarin e kishit prapa e ju thërriste, Allahu ju dënoi me dëshpërim pas dëshpërimit, që të mos pikëlloheni as për atë që ju doli duarsh, as për atë që ju goditi. Allahu di gjithçka që punoni ju.” (Al' Imran, 152-153)

Siç mund t’ju kujtohet, i Dërguari i Allahut, (a.s.), pati vendosur një njësi harkëtarësh prej pesëdhjetë vetash në një shteg. Pastaj i pati urdhëruar: “Mos u largoni nga këtu, edhe nëse e mposhtim armikun!” Siç shprehet në ajetin fisnik të mësipërm, një pjesë prej harkëtarëve shkuan pas plaçkës së luftës, nuk ua vunë veshin paralajmërimeve të shokëve të tyre dhe e kundërshtuan urdhrin e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Prandaj, Allahu Teala i ndëshkoi ata.

NJË VEND SA NJË KAMXHIK

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, gjithmonë ka folur për pasojat e tmerrshme të grindjes me njëri-tjetrin. Përsëri një ditë mbajti një fjalim me të njëjtin qëllim. Fjalimin e filloi duke thënë:

“Unë do të shkoj në Ahiret para jush dhe do të përgatitem për ju. Vendi ku do të takohemi, do të jetë pranë burimit të Keutherit.”

Pastaj vazhdoi:

“Unë e shoh burimin e Keutherit prej nga ky vend në të cilin gjendem.”

Në këtë mënyrë, dha sihariqin se nuk do të ndahej përjetësisht me umetin dhe se atje do të takohej me të. Pas këtij sihariqi, tha edhe diçka tjetër që i tronditi zemrat:

“Unë nuk kam frikë se ju do t’i bëni shirk Allahut Teala, por kam frikë se do të grindeni me njëri-tjetrin për shkak të lakmisë së kësaj bote.”

Po, i Dërguari i Allahut, (a.s.), u shpreh se ka frikë mos e vrasim njëri-tjetrin për shkak të lakmisë së kësaj bote dhe mos shkatërrohem si popujt e tjerë para nesh. (Buhari, Megazi 17; Muslim, Fedail 31.)

U shpreh se shqetësohej mos grindemi dhe biem në konflikt me njëri-tjetrin për interesa të kësaj bote. (Buhari, Xhenaiz 71, Rikak 7, 53; Muslim, Fedail 30.)

Siç e patë, të dashur vëllezër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), frikësohet mos grindemi duke lakmuar këtë botë. Ai shqetësohet mos e përvetësojmë pasurinë e kësaj bote të pavlefshme, duke e ekzagjeruar atë në sytë tanë dhe mos vrasim njëri-tjetrin, duke thënë: “Kjo pasuri e kësaj bote nuk do të jetë e jotja, por e imja.”

Ndërkohë, përpara nesh ka një mirësi të përhershme që quhet xhenet...

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), e zgjaste dorën e tij, mund t’i arrinte bistakët e rrushit të xhenetit. Xheneti ishte aq afër Tij. Faktikisht, me këtë sjellje të Tij na tregonte se sa afër është xheneti. Ai (a.s.), tha:

“Një vend sa një kamxhik në xhenet, është më i vlefshëm se kjo botë dhe çdo gjë që ka në të.” (Buhari, Bed’u’l-Halk 8, Rikak 2.)

Sa të bën të mendosh faktin se kjo botë joshëse, që pothuajse na magjeps, na i merr mendtë dhe na bën të vritemi me njëri-tjetrin, në të vërtetë nuk ka vlerë as sa një pëllëmbë tokë e xhenetit.

Le të mendojmë edhe një herë:

Me të vërtetë, përse grindemi?

Ç’është ajo gjë e vlefshme që na bën ta lëndojmë, ta brengosim dhe ta fyejmë njëri-tjetrin?

NJË JETË PA GRINDJE

Allahu Teala dhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), dëshirojnë që myslimanët të bëjnë një jetë të qetë, pa grindje dhe pa zhurmë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë: “Mos u grind dhe mos u tall me vëllain tënd mysliman!” (Tirmidhi, Birr 58.)

Pejgamberi, (a.s.), njofton se atij që nuk grindet me atë që ka përballë, sado që të ketë të drejtë, do t’i jepet një shtëpi në qoshe të xhenetit. (Ebu Davud, Edeb 7; Tirmidhi, Birr 58.)

Siç e dini, Allahu Teala i jep shumë vlerë agjërimit. Atij që mban agjërime për hir të kënaqësisë së Tij, i premton shpërblim pa masë. Si kundërvlerë për këtë, nga agjëruesi kërkon që të mos thotë fjalë të shëmtuara dhe të mos grindet me asnjë. Edhe nëse ndonjëri e imponon për t’u grindur apo e ofendon, e këshillon

të mos veprojnë dhe të thotë: "Unë jam agjërueshëm." (Buhari, Saum 2, 9; Muslim, Sijam 163-165.)

Kur të veprojmë në këtë mënyrë, do ta zbukurojmë jetën tonë dhe dynjanë do ta kthejmë në xhenet, sepse, siç na ka njoftuar i Dërguari i Allahut, (a.s.), ajo mirësi që e bën xhenetin xhenet, është se aty ka një jetë pa grindje dhe pa zhurmë. Pejgamberi (a.s.), e shpreh këtë kështu:

"Zemrat e banorëve të xhenetit do të mbartin të njëjtat ndjenja si zemra e një njeriu... Për këtë arsye, nuk do të ketë mosmarrëveshje ndërmjet tyre dhe nuk do të ndodhë ndonjë grindje..." (Buhari, Bed'u'l-Halk 8, Enbija 1; Muslim, Xhenet 17.)

PYLLI DHE SËPATA

Asnjë forcë nuk mund të na shkatërrojë ne përveç nesh. Asnjë armik nuk mund të na mposhtë. Ne jemi ata që mund ta shkatërrojmë veten tonë, ashtu si sëpata e cila shkatërron pyllin, edhe pse bishtin e ka prej tij.

Shkaku që po flas kaq prerazi është lajmi që i Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka dhënë duke hapur perden e gajbit me mirësinë e Allahut Teala.

Një ditë, sahabëve të tij u tha:

"Allahu Teala ma shfaqti tokën përpara syve. Unë e pashë të gjithë botën me lindjen dhe perëndimin e saj. Sundimi i umetit tim patjetër do të arrijë deri te ato vende që më janë treguar.

Mua m'u dhanë dy thesare, njëri i kuq dhe tjetri i bardhë. (Domethënë, më janë shfaqur përpara thesaret e Persisë dhe të Bizantit. Umeti im do t'i çlirojë ato vende)."

Unë iu luta Allahut të mos e shkatërrojë umetin tim me ndonjë krizë të përgjithshme dhe të mos u lëshojë ndonjë armik që t'i shfarosë. Pastaj, Zoti më tha:

"O Muhamed! Nëse Unë jap një urdhër, ai nuk kthehet.

Unë të premtoj se ata nuk do t'i shkatërroj me ndonjë krizë të përgjithshme dhe se nuk do t'i shfaros duke u lëshuar ndonjë armik.

Përderisa ata të mos e shkatërrojnë dhe të mos e marrin njëri-tjetrin për rob, nuk do të lejoj të shkatërrohen, edhe nëse të gjithë njerëzit mbi tokë mblidhen dhe i sulmojnë." (Muslim, Fiten 19; Ebu Davud, fiten 1; Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 278, 284.)

Domethënë se e keqja mund të na vijë vetëm prej nesh. Përderisa të mos grindemi dhe të mos e shkatërrojmë njëri-tjetrin, Allahu Teala do të na mbrojë.

PASOJAT E GRINDJES

Shikoni se çfarë mund të na ndodhë, nëse grindemi dhe zihemi me njëri-tjetrin:

E humbim fuqinë, e humbim guximin dhe biem në pesimizëm.

Fillojmë të mos e duam dhe për pasojë ta urrejmë njëri-tjetrin.

Shfaqen përçarje ndërmjet nesh.

Si rezultat i kësaj, derdhim gjakun tonë dhe humbasim jetën.

Shkatërrohemi në këtë botë. Ndërsa në botën tjetër marrim ndëshkimin hyjnor.

Së fundi, ne humbasim. Ndërsa djalli dhe armiqtë tanë, festojnë.

Më e keqja, Zoti do të na urrejë, sepse s'i kemi zbatuar urdhrat e tij.

Allahu Teala na ruajtë nga grindjet dhe nga pasojat tragjike të tyre.

Amin!



Po kërkoj njeri!

Dr. Halls Ç. Demirxhan

Kur shohim ngjarjet e krimeve që ditët e sotme po zënë tepër vend nëpër media, përballemi jo me krime të kryera për shkak të dobësisë njerëzore, si mospërmbajtja në momentet e zemërimit apo mposhtja nga zemërimi i madh, por me krime çnjerëzore që më së shumti mund t'i bëjnë njerëz psikopatë.

Psikopatia është njëra prej anomalive më të rrezikshme të personalitetit. Qendra e empatisë në trurin e njerëzve psikopatë është e prishur. Ata nuk kanë aftësi për të dashur. Ata nuk ndjejnë fajësi dhe nuk pendohen për asgjë që kanë bërë. Ndryshe nga anomali të tjera personale, ata nuk kanë asnjë lloj shqetësimi të brendshëm në lidhje me veten e tyre, domethënë, nuk kanë ndërgjegje.

Kur shohim shkaqet e shtimit të këtyre njerëzve, të cilët përkufizohen kështu në shoqëri, vërejmë se ata janë për fat të keq, luksi, mundësitë teknike, programet negative të televizioneve dhe internetit që kanë hyrë në jetë në mënyrë të paekuilibruar, pa rregull, pa edukatë dhe në një formë të padëshiruar, të cilat shkaktojnë një zbrazëti të madhe shpirtërore.

Dhuna, vuajtjet dhe derdhja e lotëve që nuk mungojnë në telenovelat që jepen nëpër televizione dhe tipat e njerëzve që shfaqen nëpër programet magazinë apo paparaci, për fat të keq reklamohen si model ideal i njeriut. Ndërsa nëpër reklama që përdoren shumë shpesh, gdhendet baza e shoqërisë duke shfaqur skena me përmbajtje erotike.

Përgjatë gjithë këtyre viteve që autoritetet nuk janë ndjerë pothuajse fare apo nën emrin e modernizimit dhe demokratizimit është përhapur një strukturë familjeje më e lirë dhe e shthurur.

Disiplina nëpër shkolla ka pësuar rënie drastike dhe edukimi pothuajse ia ka lënë vendin plotësisht mësimi mekanik.

Kalimi nga një shoqëri me familje të gjerë në një shoqëri me familje të vogël, që na e ka imponuar jeta e qytetit, nxori në pah individë më të vetmuar.

Ngjarjet e tilla tmerruese anashkalohen vetëm duke i kundërshtuar me fjalë për shkak të zbutjes dhe ndryshimit

të moralit dhe virtyteve shoqërore.

Këtyre u shtohet edhe sistemi i drejtësisë, i cili nuk i parandalon këto lloj ngjarjesh tmerruese dhe vonohet për t'i gjykuar...

Kjo zbrazëti shpirtërore, i bëri njerëzit më interesaxhi dhe i vrau ndjenjat e ndërgjegjes si dhembshurinë dhe mëshirën.

Prandaj, duke u shtuar njerëzit që u kanë vdekur ndjenjat e tilla në shoqëri, u shtuan edhe psikopatët edhe krimet që bëjnë ata.

Ndërsa Allahu e ka krijuar shejtanin dhe atë që i bindet atij te ne, pra nefsën, për t'i sprovuar robërit e Tij dhe për të shfaqur se kush i bindet ndërgjegjes së vet. Ka një të vërtetë që edhe djalli i mallkuar e di: ai është shumë i pafuqishëm dhe i dobët kundrejt njerëzve të sinqertë dhe të ndërgjegjshëm. Ata asnjëherë nuk ndikohen nga shejtani. Asnjë dredhi e tij nuk mund të influencojë te ata, sepse ndërgjegjja e udhëzon njeriun, i tregon rrugën, e heton, e merr në llogari, e kontrollon, e përgatit për vdekjen para se të vijë vdekja dhe e përgatit për mahsherin para se të vij mahsheri.

Edhe në ajetin fisnik thuhet:

“...Në të vërtetë, djalli nuk ka kurrfarë pushteti mbi ata që besojnë dhe mbështeten tek Zoti i tyre. Pushteti i djallit është vetëm mbi ata, që i binden atij dhe adhurojnë zotat e tjerë veç Allahut.” (Nahl, 99-100)

Përfundimisht, në këtë botë të egër, në të cilën interesi po i paraprin ndërgjegjes, duhet të veprojmë siç ka thënë Mevlana:

“Po kërkoj njeri! Edhe nëse do ta kem të vështirë për ta gjetur, përsëri nuk e humbas shpresën. Po kërkoj njerëz të devotshëm për ta shuar sadopak mallëngjimin tim dhe sepse ndjej kënaqësi të madhe nga ky kërkim.”

Allahu Teala na e mundësoftë të gjithëve të bëhemi prej robërve të devotshëm dhe prej atyre që qëndrojnë me robërit e Tij të devotshëm! Amin!..



Zot na ruajt NGA PËRÇARJA

Zoti ynë thotë në Kuranin famëlartë: **“...dhe mos u zini, dhe mos u grindni, sepse do të dështoni, do të dobësohet forca juaj, por duroni, se Zoti i do durimtarët.”** (Enfal, 46)

Të gjithë ne i përfjetojmë në një formë a në një tjetër xhevahiret, që ka zbritur Allahu (xh.xh.), në këtë fe madhështore, në këtë Islam madhështor. Islami është fe e logjikës, fe e arsyes, fe e shpirtit dhe e trupit, fe e gjithçkaje që na rrethon, fe e qetësisë, fe e lidhjeve të mira me familjen, me njerëzit, e lidhjeve të mira me Allahun (xh.sh.), fe që plotëson me të vërtetë kërkesën dhe nevojën e mendjes, madje e kalon edhe atë.

Muhamedi (a.s.), ka thënë një hadith të çuditshëm, i cili në pamje të parë duket pa kuptim. Ai (a.s.), thotë: *“Në qoftë se në enën e dikujt prej jush bie një mizë, një insekt, atëherë mos e derdh ujin, por zhyte mizën dhe nxirre atë, se në njërin anë të flatrave të saj ka sëmundje e në anën tjetër ka ilaç.”*

Shokët e profetit Muhamed (a.s.), e besuan këtë hadith, sepse e dinin sinqeritetin dhe besnikërinë e tij, e besuan dhe myslimanët më pas, por kur ra besimi, kur u dobësuan myslimanët, filluan ta shikojnë me dyshim këtë thënie të Profetit (a.s.). Si vallë të bjerë miza në enën tonë dhe ne të mos e nxjerrim, por ta zhysem në të? Armiqtë e Islamit e shfrytëzuan këtë hadith, duke thënë: *“Kjo është fe e papastërtisë.”* Kjo gjë u bë sprovë. Dikush duroi dhe dikush ra në këtë sprovë.

Por shkenca bashkëkohore, që ka hyrë në thellësi të dhe hollësi të më të mëdha, tregoi për vërtetësinë e fjalëve të profetit Muhamed (a.s.). Shkencëtarët thonë se kur miza i turret një ambienti ujor, flatra që afrohet është ajo që ka mikrobe, se mikrobet duan ujë, ndërsa tek flatra tjetër ka antimikrobe.

Me të vërtetë në pamje të parë të duket fe që nuk mjaftohet me një të hyrë të mizës, por duhet ta zhytësh edhe njëherë e pastaj ta nxjerrësh, ndërsa në realitet ajo është mrekullia vetë. Në qoftë se nuk do ta derdhësh ujin, ngaqë mund të jetë vështirë për t’u gjetur ose mund të jetë me pakicë, bëje këtë veprim, sepse është fjala e Profetit (a.s.). Është fjala e atij, i cili nuk gënjen, sepse flet me emrin e Allahut (xh.sh.). Islami është fe madhështore, fe e zbritur nga Allahu (xh.sh.), për njerëzit, fe e përkryer që udhëzon njerëzit.

Po ne, a jemi në nivelin e kësaj feje? A jemi pasqyrimi real i kësaj feje? A jemi imazhi i vërtetë i kësaj feje madhështore? Për fat të keq, shpeshherë myslimanët ftojnë kundër kësaj feje. Shembulli i këtyre myslimanëve është tamam si një makinë e re, që nuk ka asnjë defekt, që është mjaft e bukur, por keqpërdoret nga një shofer, që nuk e di vlerën e saj. Shoferi e shkatërron, e keqpërdor makinën dhe në fund fare njerëzit e shajnë makinën. Po çfarë faji ka makina? Fajin e ka shoferi, që e drejton gabim këtë makinë, fajin e kemi ne që e drejtojmë gabim këtë fe, e interpretojmë jo ashtu siç do Allahu (xh.sh.).

Dua të pyes: *“A jemi ne myslimanët e Shqipërisë,*

1. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (3320)

ata që vënë kokën në sexhde, imazhi real përpara myslimanëve të tjerë dhe përpara jomyslimanëve?" Kam frikë se shpeshherë ne bëhemi sprovë për të tjerët. Madje disa myslimanë arrijnë deri në atë pikë, sa kur të tjerët i shohin, thonë: "Shyqyr që s'jemi myslimanë. Shiko se çfarë po bëhet! Myslimanët po hanë njëri-tjetrin, po përçahen, konflikti mes tyre sa vjen e shtohet". Sot sprova më e madhe për ne dhe për të tjerët është **PËRÇARJA**. Prandaj Zoti i gjithësisë e fton profetin Muhamed (a.s.) dhe ne bashkë të lutemi me një dua (lutje): "**O Zot, mos na bëj sprovë për jobesimtarët!**" (Mumtehine, 5)

Trishtohesh kur shikon myslimanë, që nuk i japin dorën njëri – tjetrit, që nuk flasin me njëri – tjetrin vetëm për faktin se tjetri ka mendim të ndryshëm. Ky është hendeku më i madh, është sprova më e madhe. Prandaj nuk kemi për ta lënë këtë fe të ngrejë krye, pa u bashkuar me njëri-tjetrin, pa e parë njëri-tjetrin në sy.

Ne na bashkojnë shumë gjëra e na ndajnë shumë pak gjëra. Profeti Muhamed (a.s.), ai që e dinte rrezikun e përçarjes, ishte shumë i ndjeshëm. Ishte shumë kurioz të dinte hollësisht se si i kanë besimtarët lidhjet me njëri-tjetrin dhe nuk falte aspak, nuk toleronte aspak, kur ata tentonin të përçaheshin njëri me tjetrin.

Profeti Muhamed (a.s.), bashkoi dy fise të mëdha, Ausin dhe Hazrexhin, të cilët kishin luftuar me njëri-tjetrin për 400 vjet me radhë. Kishin rënë me mijëra e mijëra njerëz në këto luftëra, por deshi Zoti i gjithësisë që këto fise u bënë myslimanë dhe u bashkuan në dorën e profetit Muhamed (a.s.).

Në një nga betejat, ku merrnin pjesë myslimanët e Mekës dhe të Medinës, dy shërbëtorë, njëri nga fisi Aus dhe tjetri nga fisi Hazrexh u grindën me njëri-tjetrin. Ata ishin dy vëllezër myslimanë, dy sahabë të profetit Muhamed (a.s.), por në grindje e sipër njëri i kërkoi ndihmë fisit të tij e po ashtu bëri edhe tjetri. Sapo e mori vesh këtë lajm, profeti Muhamed (a.s.), u fut si vetëtimë mes tyre dhe tha: "*Kini frikë Allahun (xh.sh.). A vazhdoni ende me slloganet e xhahilijetit dhe të injorancës e unë jam akoma gjallë? Lëri këto sllogane, lëri këto parime se atyre iu vjen*

erë e keqe."²

Në një situatë të tillë ku gjendemi sot, unë ju ftoj që t'i kthehemi Allahut (xh.sh.). Të kemi frikë Zotin e gjithësisë, të kemi turp prej Allahut (xh.sh.), të kemi turp prej kësaj feje, se me të vërtetë po ia ulim vlerën asaj. U drejtohem të parëve të mi, atyre që flasin në emrin tim dhe në emrin tuaj, të kenë frikë Zotin e gjithësisë, t'i japin dorën njëri-tjetrit, të na afrojnë e të mos na shtyjnë. Jemi njerëzit për të cilët do të përgjigjen përpara Allahut (xh.sh.). Ftoj veten time dhe ju, që të mos shkaktojmë përçarje, se kjo me të vërtetë është punë e shejtanit, punë e atij që kënaqet kur i shikon myslimanët larg njëri-tjetrit. Le ta lusim Zotin e gjithësisë në sexhde me këtë lutje: "O Zot, na nxirr nga kjo situatë! O Zot, mos na bëj sprovë për jobesimtarët! Mos na bëj armiq të njëri-tjetrit, po afroji zemrat tona".

Desha t'ju kujtoj vetëm me një moment, ditën e fundit të jetës së Muhamedit (a.s.).

Ditën e fundit të jetës së tij, profeti Muhamed (a.s.), s'mundi të dilte në xhami. Megjithatë, ai hapi perden e dhomës së tij dhe i pa besimtarët duke falur namazin e sabahut nën udhëheqjen e Ebu Bekrit (r.a.). I pa të gjithë të bashkuar, në një drejtim, në një saf për krahu njëri-tjetrit, vëllezër para Zotit të gjithësisë, të lidhur përpara Allahut (xh.sh.). Profeti (a.s.), buzëqeshi dhe myslimanët gati sa nuk e prishën namazin nga gëzimi që po shihnin profetin e Zotit. Por Profeti (a.s.), u bëri me dorë që të vazhdonin. Atë ditë profeti Muhamed (a.s.), dha shpirt dhe ndërroi jetë i lumtur, me zemër të gëzuar, me fytyrë të bardhë përpara Zotit, sepse i la myslimanët si vëllezër të njëri – tjetrit, duke u falur përpara madhësisë së Allahut (xh.sh.).

E lus Zotin e gjithësisë që mëshira e tij të na përfshijë të gjithëve. E lus Allahun (xh.sh.), që me të vërtetë ta kemi frikë madhësitë e Tij dhe në këto situata më shumë se kurrë t'i drejtohem Allahut (xh.sh.), me përgjërëm, që t'i bashkojë zemrat tona, të na afrojnë tek njëri-tjetri, ta shikojmë njëri-tjetrin si vëllezër me të cilët do të dalim përpara Tij.



2. **Hadith i vërtetë.** Myslimi (2584)

VAKSINË PËR EBOLËN

Faza e parë e një prove klinike për një vaksinë premtuese për Ebolën po kryet në Mali, që është në kufi me Guinenë, epiqendra e epidemisë së virusit vdekjeprurës.

Vaksina, e krijuar nga hulumtues në Institutin Kombëtar Amerikan të Shëndetësisë dhe kompania farmaceutike britanike GlaxoSmithKline, ishte 100% e efektshme në mbrojtjen e majmunëve ndaj ekspozimit vdekjeprurës ndaj Ebolës në provat para-klinike.

Vaksina stimulon sistemin imunitar duke përdorur një proteinë jo-infektive të Ebolës që mbartet nga një virus i padëmshëm i të ftohtit.

Tre punonjës të shëndetësisë në Mali e kanë marrë vaksinën tre ditët e fundit, thotë studiuesi Myron Levine, drejtor i Qendrës për Zhvillimin e Vaksinave në Universitetin e Merilendit. Ai po ndihmon në kryerjen e provave klinike në Mali.

“Jam marr me zhvillimin e vaksinave për 44 vjet. Deri tani nuk kam pare asgjë të lëvizë kaq shpejt”.

Nuk ka asnjë rast të Ebolës të raportuar në Mali, që Levine thotë se ka sigurim të mirë në kufi. Por Ebola vazhdon të përhapet pa kontroll në Guine, Liberi dhe Sierra Leone.

Ashtu si vakcina kundër lisë, ajo kundër Ebolës mund të parandalojë potencialisht sëmundjen tek ata që ekspozohen ndaj virusit vdekjeprurës, përfshi punonjësit e kujdesit shëndetësor.

Levine thotë se miratimi regulator mund të pasojë së shpejti provat e suksesshme klinike.

“Të gjithë duan të shohin licencimin e vaksinës së Ebolës - po përpiqemi për të marrë licencën sa më shpejt përse kohë që të dhënat të tregojnë se ajo është e sigurt, imunogjene dhe mbrojtëse”.


GlaxoSmithKline po prodhon dhjetra-mijëra doza të vaksinës, që Levine thotë se mund të administrohet sapo ilaçi të marrë miratimin e rregullatorëve në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë. Ai thotë se për shkak të kufizimeve në furnizime, shpërndarja e vaksinës do të jetë fillimisht e targetuar.

Përveç Malit, provat e vaksinës eksperimentale po kryen gjithashtu në Britani.

Levine thotë se dy njerëz të tjerë e morën vaksinën të premtën në Mali. 15 të tjerë do të vaksinohen më pas, nëse gjithçka shkon sipas planit.



NOBELI NË MJEKËSI I JEPET STUDIUESVE TË TRURIT



Shkencëtari amerikano-britanik John O'Keefe dhe norvegjezët May-Britt Moser dhe Edvard Moser kanë fituar Çmimin Nobel për zbulimet e tyre në lidhje me sistemin neurologjik të orientimit.

Komisioni i Çmimeve Nobel në Institutin Karolinska të Suedisë tha sot se laureatët kanë zbuluar enigmën e operacioneve të trurit për t'u orientuar në mjedis.

O'Keefe zbuloi në 1971 mekanizmin që përdor truri

për të regjistruar pika orientimi dhe mënyrën se si në trurin e miut aktivizoheshin disa qeliza kur ishte në një anë të dhomës dhe se si kur kalonte në anën tjetër, aktivizoheshin qeliza të tjera.

Në 2005, çifti norvegjez Moser zbuloi një qelizë

në trurin e miut që krijon një sistem koordinatash, të ngjashëm me sistemin GPS që përdorin njerëzit për orientim në hapësirë.

Studimet e fundit kanë treguar se qeliza me funksione të ngjashme ekzistojnë edhe në trurin e njeriut.

SPECI I KUQ, SËMUNDJET QË SHËRON



Te specat e kuq djegës, gjenden në sasi shumë të mëdha kapsaicina (përbërësi kryesor i aktivitetit farmakologjik) flavonoide, vajra esenciale, karotenoidë, celulozë, kalcium dhe hekur. Përmbajtja e lartë e vitaminës C (deri në 340 mg/100 gr) është më e madh se të gjitha frutat apo perimet e tjera, ndërsa gjenden edhe sasi të konsiderueshme vitaminash A, K, dhe B. Jo më kot studiuesit kanë nisur ta quajnë ari i kuq i tavolinës.

Speci djegës është krejtësisht i këshillueshëm në kurën parandaluese të infarktit dhe sëmundjeve kardiovaskulare. Është parë se përdorimi i vazhdueshëm i tij ul nivelin e kolesterolit në gjak, ndihmon zemrën, dhe ndihmon punën e arterieve të gjakut. Farat e specit djegës përmbajnë shumë acide që eliminojnë nga arteriet kolesterolin e tepërt dhe trigliceridet. Kapsaicina vepron edhe te metabolizmi i yndyrave duke përshpejtuar dhe penguar akumulimin e tyre. Një studim i fundit nga "Chinese University" i Hong-Kongut e konfirmon plotësisht këtë. Kërkuesit ushqyen kavjet me një dietë të pasur me ushqime të yndyrshme. Grupi që përveç ushqimit kishte konsumuar edhe specat të kuq djegës kishte nivele më të ulëta të kolesterolit të keq në gjak. U vërtetua se kapsaicina ka një efekt pozitiv edhe te pacientët e prekur nga diabeti, sepse përmirëson aktivitetin e insulinës. Për të pasur një efekt mbrojtës në nivel kardiovaskular nuk është e nevojshme

të konsumosh sasi të madhe, por ta konsumosh atë në mënyrë të vazhdueshme.

Studimi i vetive anti-kancerogjene të specit djegës ka nisur shumë kohë më parë me dietën Moerman të eksperimentuar në Holandë që prej 1930-s. Pacientëve iu dhanë ushqime të cilat përmbanin vitamina si jodi, si acidi citrik, vitaminat e grupit B, hekur, vitamina A, vitamina E, vitamina C. Dieta bazohet në teorinë që këto elemente duke riekulibruar metabolizmin janë në gjendje të parandalojnë tumoret. Kohët e fundit kërkuesit e Cedars-Sinai Medical Center të Los Angeles në SHBA kanë studiuar efektin e kapsaicina në laborator dhe kanë mundur të tregojnë se ky princip aktiv ndihmon në parandalimin e shumë llojeve të kancerit, sidomos atij në prostatë, atij të mushkërive dhe zorrës së trashë.

Speci i kuq djegës përdoret edhe kundër depresionit. Është vërtetuar se ndikon pozitivisht tek humori e kështu edhe te depresioni. Gjithëashtu speci i kuq djegës ndihmon në rënien nga pesha. Studimet janë botuar në revistën shkencore "Human Nutrition" me titullin "efektet e ushqimeve pikante mbi metabolizmin". Në një përfundim të tillë ka arritur edhe një grup kërkuesish i Universitetit të Tasmanisë. Sipas këtyre studiuesve, kapsaicina që përmban speci djegës ul konsumin e kalorive deri në 15 për qind. Kështu, nëse një pjatë me makarona zakonisht ka 350 kalori, nëse shtohet spec djegës kjo shifër shkon në 300.





SI DEGJENEROI NDESHJA SERBI-SHQIPËRI

Ishte mëse e qartë që ndeshja Serbi-Shqipëri do të ishte më shumë se sa një ndeshje futboll. Ndalmi absurd i pjesëmarrjes së tifozërisë shqiptare në Beograd, kërcënimet për arrestimet e çdo shqiptari pranë stadiumit të Beogradit, sorollatja e delegacionit shqiptar në aeroport apo edhe prania e vazhdueshme e forcave të shumta policore rreth hotelit të kombëtares shqiptare ishin tregues i qartë i asaj që pritej të ndodhte. Por përmasat e asaj që ndodhi ishin përtej çdo parashikimi.

Gjatë gjithë pjesës së parë në stadium dëgjoheshin vetëm thirrje antishqiptare, ndeshja u ndërpre pasi në minutën e 41' mbi stadiumin "Partizan" të Beogradit u shfaq një dron i telekomanduar në distancë, në të cilin valëvitej një flamur ku pasqyrohej Shqipëria e madhe, Ismail Qemali, Isa Boletini dhe fjala Autoktonë. Tifozët serbë filluan të ulërinin, ndërsa të dyja ekipet pritnin që droni të zbriste në fushë. Sherri në fushë nisi kur mesfushori serb, Mitroviç, u përpoq të zhubloste flamurin në atë moment, drejt tij u vërsulën Taulant Xhaka dhe Andi Lila të cilët tentuan të merrnin flamurin nga duart. Të njëjtën gjë bënë edhe Bekim Balaj, por ngjarja precipiton në një zënkë të mirëfilltë.

Lojtarët Serbë, bankina, tifozët që zbritën në fushë dhe rojet e sigurisë u vërsulën mbi lojtarët shqiptarë. Lojtarët shqiptarë u goditën edhe me stola.

Gjyqtari Atkinson bën shenjë që ndeshja të ndërpritet. Kuqezinjtë vrapojnë drejt dhomave të zhveshjes, duke shmangur sendet që vërshonin nga tribunat, ndërsa në tribunë fillon një luftë e mirëfilltë mes forcave të rendit dhe ultrasve, ku nuk mungon as përdorimi i shklopinjve të gomës e gazit lotsjellës.

Policia e ka të vështirë të vendosë rendin në stadium, por pas rreth 30 minutash arrin të zbrazë një pjesë të tribunave pas portës. Zyrtarët serbë tentojnë në çdo mënyrë që të kthejnë skuadrat në fushë, duke i kërkuar delegatit të UEFA-s se ndeshja mund të vazhdonte në kushtet normale. Por vazhdimi i thirrjeve ultranacionaliste nga tribunat, goditjet që kishin marrë lojtarët shqiptarë, si dhe rishikimi i pamjeve filmike nga delegati i UEFA-s, bëri të qartë se kjo ndeshje nuk përmbushte më asnjë kusht për të vazhduar në rrethana normale. As paralajmërimi nëpërmjet qendrës së zërit për masa ndëshkimore ndaj ekipit serb, nuk e qetësoi situatën në stadium. Ndërkohë, në dhomat e zhveshjeve, delegati i UEFA-s dhe gjyqtarët mbledhën kapitenët e të dyja ekipeve, duke kërkuar edhe opinionin e tyre. Kapiteni Cana, i mbështetur edhe nga ai serb, Ivanoviç, bëri të qartë se përfaqësuesja shqiptare e kishte të pamundur të vazhdonte në kushte të tilla këtë sfidë. Ndaj delegati i UEFA-s nuk e kishte të vështirë të jepte urdhrin për braktisjen e ndeshjes, për t'ia lënë gjithçka në dorë Komisionit Disiplinor të UEFA-s.

Skuadra serbe doli në stadium, duke përshëndetur tifozët e vet, e pritur përsëri me vërsullime, ndërsa delegacioni shqiptar qëndroi për rreth tri orë në ambientet e brendshme të stadiumit, i rrethuar nga forca të shumta policore dhe ushtrisë serbe që i frikësoheshin një mësymje të ultrasve në ambientet e brendshme. Vetëm pasi u boshatisën tribunat dhe u larguan ultrasit nga rruga që çonte kombëtaren shqiptare drejt aeroportit, në orën 00:30 pas mesnatës, u mundësua largimi i tyre nga stadiumi.

TEKNOLOGJIA E DIODËS QË PËRHAP DRITË



Këtë vit, Çmimi Nobel për Fizikën ju dha shpikësve të diodës që emeton dritë, e njohur ndryshe si LED dhe që tani përdoret në mbarë botën. Megjithatë, sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë dhe Bankës Botërore, më shumë se 1 miliard njerëz në botë nuk kanë energji elektrike. Pas përdimit të diellit, shumica prej tyre përdorin dritën e kandilit apo llambave me vajguri. Një kompani në Holandë po mundohet ta ndryshojë këtë situatë duke u bazuar pikërisht tek teknologjia LED.

Një nga temat e diskutimit në takimin e fundit të Bankës Botërore ishte energjia e ripërtëritshme në botë. Po ashtu, temë diskutimi ishte edhe mungesa e energjisë elektrike në vendet e varfra si për gatim ashtu edhe për ndriçim. Por në horizont po shfaqen disa teknologji të reja me kosto të ulët që mund të ndihmojnë në kapërcimin e situatës.

Kur bie nata, shumë fëmijë në pjesët rurale të Haitit, Ruandës apo në këtë kamp refugjatësh në Siri, lexojnë apo bëjnë detyrat nën dritën e kandilit apo llambës me vajguri. Shpesh herë, ato shkaktojnë zjarr ndërsa tymrat toksike shkaktojnë probleme tek rrugët e frymëmarrjes.

Drita portative elektrike është më e sigurt, më e shëndetshme dhe tani më pak e kushtueshme. Camille van Gestel drejton kompaninë holandeze WakaWaka.

“Është hera e parë që drita artificiale apo solare LED është më pak e kushtueshme se vajguri.”

LED është shkurtimisht për diodë që transmeton dritë, burim i sigurt dhe efikas drite që përhap ndriçim

të bardhë të fortë.

Van Gestel thotë se WakaWaka, që nënkupton dritë që shkëlqen në gjuhën swahili, sot për sot në botë është burimi më efikas me energji diellore dhe karikuesi i telefonave. Pas karikimit të plotë, ajo jep ndriçim deri në 16 orë. Financiarisht është e përbalueshme dhe bateria ka jetëgjatësi të madhe. Mund të vihet në çdo sipërfaqe të rrafshët, të varet në tavan apo të vihet mbi një shishe qelqi. Van Gestel thotë se kjo teknologji është për njerëzit më të varfër.

“Synimi kryesor janë shtresa më e varfër që jetojnë me më pak se dy dollarë në ditë.”

Van Gestel thotë se kompania e tij vepron si çdo biznes tjetër, por fitimet kryesore nga produktet e tjera i përdor për të bërë pajisjet ndriçuese WakaWaka për njerëzit e varfër. Ai thotë se nisma mbështetet nga organizata ndërkombëtare joqeveritare.

“Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit ishte një prej të parëve që çoi në Siri pajisjet WakaWaka, për të ofruar ndriçim dhe elektricitet për refugjatët dhe tani kjo pajisje është më e vlerësuar përveç ushqimit.”

Gjatë dy viteve të fundit, kompania ka shpërndarë rreth 300 mijë pajisje në vende si Siria, Haiti, Ruanda, Indonezia dhe Filipinet. Kompania synon që deri në vitin 2030 të shpërndajë pajisje për 1.2 miliard njerëz.

